

PRUSIANIZMI & SOCIALIZMI



OSWALD
SPENGLER

OSWALD SPENGLER

PRUSIANIZMI

DHE

SOCIALIZMI

Përktheu: Klajdi Bylyku

Redaktoi: Juxhin Halo

© Botimet BRERORE

brerore@outlook.com

2023

Pasqyra e Lëndës

- 1. Revolucioni.....9**

- 2. Socializmi si mënyrë jetese.....41**

- 3. Prusianët dhe anglezët.....47**

- 4. Marksi.....124**

- 5. Internacionalja.....150**

Hyrje

Kjo ese mbështetet mbi shënimet e vëllimit të dytë të veprës “*Rënia e Perëndimit*”. Së paku pjesërisht, shënimet përfshijnë fazën zanafillore të zhvillimit të së gjithë tezës së paraqitur në atë vepër.¹

Fjala “socializëm” emërton çështjen më të ndezur, në mos edhe më të thellë, të debatit aktual. Të gjithë po e përdorin. Të gjithë mendojnë se ajo nënkupton diçka ndryshe. Në këtë term-slogan universal gjithsecili injekton çfarëdo që ia ka ënda, apo urren, i frikësohet apo dëshiron. E megjithatë, askush nuk është i vetëdijshëm rreth shtrirjes dhe kufizimeve të funksionit historik të kësaj fjale. Çfarë është socializmi, një sistem instinktiv apo i planifikuar? A është ai një qëllim i njerëzimit, apo thjesht një gjendje e përkohshme? Apo mos ndoshta fjala i referohet thjesht kërkesave të bëra nga një klasë e caktuar e shoqërisë? A janë Marksizmi dhe Socializmi e njejta gjë?

Njerëzit që kanë për qëllim që ta ndryshojnë këtë fjalë, vazhdimisht gabojnë duke mos bërë dallimin midis asaj që *duhet* të jetë dhe asaj që *është*. Vërtet i rrallë është vështrimi që mund të përshkojë përtej rrëmujës dhe rrjedhës së ngjarjeve bashkëkohore.

Mua ende më duhet të gjej dikë që e ka kuptuar me të vërtetë këtë Revolucionin Gjerman, që e ka rrokur

¹ Shih Osvald Spengler, *Rënia e Perëndimit*.

kuptimin apo e ka parashikuar kohëzgjatjen e tij. Çastet po ngatërrohen me epokat, viti që vjen me shekullin që do të vijë, kapriçot me idetë, librat me qeniet njerëzore.

Marksistët tanë e tregojnë forcën vetëm kur janë duke u shembur; por kur vjen puna për të menduar apo vepruar konkretisht, ata shfaqen të pafuqishëm. Përmes veprimeve të tyre ata së paku janë duke pohuar se ati i tyre nuk ishte një krijues, por vetëm një kritik.

Trashëgimia e tij konsiston vetëm në një përmbledhje të disa ideve abstrakte, domethënëse dhe kuptimplota vetëm për botën e lexuesve të vetizoluar brenda mureve të bibliotekave.

“Proletariati” i tij është një koncept i kulluar letrar, i formësuar dhe i mbajtur gjallë nga fjala e shkruar. Ai ishte i vërtetë vetëm për aq kohë sa e mohonte dhe jo e shprehte gjendjen aktuale të gjërave në një kohë të caktuar.

Sot ne po fillojmë të kuptojmë se Marksi ishte vetëm njerku i socializmit. Ky i fundit përmban elementë që janë më të vjetër, më të fortë dhe më themelore sesa kritika e tij ndaj shoqërisë.

Elementë të tillë ekzistonin pa të dhe vazhduan të zhvilloheshin gjithashtu pa të, në të vërtetë në kundërshtim me qëndrimet e tij. Por ato nuk mund të gjenden të shkruara nëpër libra; ato janë të pranishme në gjak dhe vetëm ky i fundit mund të vendosë të ardhmen.

Por nëse socializmi nuk është Marksizëm, atëherë çfarë është? Përgjigja mund të gjendet në këto faqe. Disa njerëz tashmë e kanë një ide se çfarë është ai, por janë

përfshirë me një zell aq të madh në “pikëpamjet,” qëllimet dhe projektet politike saqë askush nuk ka guxuar të jetë i sigurtë. Kur jemi përballur me situata ku na është dashur të marrim vendime, ne i kemi braktisur pozicionet e mëparshme të sigurisë dhe kemi përqafuar qëndrime më të buta, më pak radikale dhe më të vjetëruara, duke iu kërkuar ndihmë Rusoit, Adam Smithit dhe të ngjashmëve me ta.

Ne ndërmarrim hapa kundër Marksit, e megjithatë në çdo hap që hedhim përmendim po emrin e tij. Ndërkohë koha për formësimin dhe modelimin e ideologjive ka kaluar. Ne të vonshmit e qytetërimin përëndimor jemi bërë skeptikë. Ne refuzojmë të keqduhëzohemi akoma dhe më shumë nga sistemet ideologjike. Këto të fundit janë diçka që i përkasin shekullit të kaluar. Ne nuk duam më ide dhe parime, gjithë sa duam është vetja jonë.

Për rrjedhojë ne përballemi me detyrën për ta çliruar socializmin gjerman nga Marksit. Them socializmin *gjerman*, sepse nuk ka të dytë veç tij. Edhe kjo, gjithashtu, është një ndër të vërtetat që nuk fshihen më. Ndoshta askush nuk e ka përmendur më përpara, por ne gjermanët jemi socialistë, ndërsa të tjerët nuk kanë mundësi të jenë të tillë.

Ajo çfarë jam duke përshkruar këtu nuk është thjesht një tjetër lëvizje pajtuese, as një tërheqje dhe as një shmangie, por një *Caktim*. Atij nuk mund t'i shpëtojmë duke mbyllur njërin sy, duke e mohuar, duke e luftuar apo duke ia mbathur prej tij; të tilla veprime thjesht do të ishin mënyra të ndryshme të përmbushjes së tij. *Ducunt*

*volentem fata, nolentem trahunt.*² Shpirti i Prusisë së vjetër dhe qëndrimit socialist, që në momentin që po flasim janë të përfshirë në një urrejtje vëllazërore dhe një vetëbesim për ta luftuar njëri-tjetrin, në të vërtetë janë një gjë e vetme.

Ky është një fakt i pakundërshtueshëm i historisë dhe jo thjesht një trillim letrar. Elementët që përbëjnë historinë janë gjaku, raca – e cila është e krijuar nga ide që nuk shprehen kurrë – dhe ai lloj të menduari që koordinon energjitë e trupit dhe mendjes.

Historia i tejkalon të gjithë idealet, doktrinat dhe formulimet e thjeshta logjike.

Për arritjen e çlirimit të socializmit gjerman nga Marksi, po mbështetem tek ata të rinj që janë mjaftueshëm të arsyeshëm për t'i injoruar dërdëllisjet dhe intrigat e padobishme politike, që janë të aftë të kuptojnë atë çfarë është e fuqishme dhe e pamposhtme në natyrën tonë dhe që janë të përgatitur për të shkuar përpara, pavarësisht gjithçkaje me të cilën mund të përballen. I drejtohem rinisë gjermane, në të cilën shpirti i etërve ka marrë forma jetike, gjë që atyre iu mundëson përmbushjen e një

Caktimi, që ata e ndiejnë thellë brenda tyre, një Caktim mishërim i të cilit *janë* vetë ata. Ata duhet të jenë të gatshëm që të pranojnë detyrime mbi supe, pavarësisht vështirësive dhe varfërisë; duhet të zotërojnë një krenari romake të të qenit në një shërbim vetëmohues, të

² **Fati shpie përpara ata që kanë vullnet dhe zvarrit ata që nuk e kanë atë.** (Shënim i përkthyesit)

karakterizohen nga modestie në ushtrimin e autoritetit dhe të kenë vullnetin për të marrë përsipër detyra me gatishmërinë më të plotë dhe pa asnjë përjashtim dhe jo të kërkojnë nga të tjerët përmbushjen e të drejtave që gëzojnë. Nëse këto kushte përmbushen, indivin me totalitetin ka për ta bashkuar një sens i heshtur vetëdijësimi. Një vetëdije e tillë potenciale është pasuria jonë më e madhe dhe më e shenjtë. Kjo është ajo çfarë kemi trashëguar nga shekujt e shqetësuar dhe ajo që na dallon nga popujt e tjerë, neve, popullin e parë dhe të fundit të kulturës sonë. Janë pikërisht këta përfaqësues të rinisë gjermane të cilëve u drejtohem. Shpresoj që ata ta kuptojnë se çfarë e ardhmja pret prej tyre, ashtu siç shpresoj që të ndihen krenarë teksa e pranojnë një sfidë të tillë.

I.Revolucioni

1

Asnjë popull i historisë nuk ka pasur një zhvillim më tragjik sesa ai i popullit tonë. Në kohën e krizave të mëdha, që të gjithë popujt e tjerë kanë luftuar ose për fitore ose për një qetësim të përkohshëm të situatës, ndërsa përpara nesh mundësitë kanë qenë gjithmonë dy, ose fitore ose asgjësim.

Le t'i hedhim një sy historisë sonë ushtarake nga Kolin dhe Hochkirch, te Jena dhe Luftrat e Çlirimit, kur në tokën franceze u bënë përpjekje për të fituar kundër aleatëve të Prusisë nga ana e Napoleonit, përmes propozimit të një ndarjeje; të vështrojmë pak momentin dëshpërues në Nikolsburg kur Bismarku po mendonte vetëvrasjen; të kujtojmë Sedanin, i cili thuhet se asgjësoi një sulm të përgjithshëm të ushtrive të vendosura në kufijtë tanë, duke penguar kështu shpalljen e luftës nga ana e Italisë; për ta mbyllur me fatin e frikshme të luftrave që kanë goditur të gjithë planetin tonë, rrufetë e para të të cilave sapo i lamë pas krahëve.

Vetëm në shtetet e Frederikut të Madh dhe Bismarkut qëndresa u bë tërësisht e mundur.

Në të gjitha këto katastrofa, gjermanët kanë luftuar kundër njëri-tjetrit. Nëse në disa raste ka ndodhur që përplasja të ketë qenë midis një fisi dhe një tjetri, apo midis një sovrani apo një tjetri, kjo është domethënëse dhe e rëndësishme vetëm për sipërfaqen e historisë.

Në themel të të gjithë këtyre konflikteve, qëndron mosmarrëveshja intensive që fshihet në thellësi të çdo

shpirti gjerman, një konflikt i brendshëm që në fillim shpërtheu në mënyrën më ogurzezë në epokën gotike, në personazhet e Frederick Barbarossa-s dhe Henry Luanit në Betejën e Lenjanos.

A e ka kuptuar ndokush këtë dikotomi të shpirtit gjerman? Kush e ka pikasur te Martin Luther-i mishërimin e dukës Viduking të Saksonisë? Ç'ishte ajo nxitje e pashkatërrueshme që i bëri gjermanët ta simpatizojnë dhe të luftojnë me Napoleonin kur, në emër të gjakut francez, ai po përhapte idetë angleze nëpër kontinent?

Çfarë na shtyn ne të dalim në përfundimin se gjëegjëza e Lenjanos është thellësisht e ngjashme me atë të Lajpcigut? Përse Napoleoni shkatërrimin e asaj bote të vogël të Frederikut të Madh e konsideroi si çështjen e tij më urgjente dhe në mendimet e tij më të thella si më të pazgjidhshmen?

Tashmë, në muzgun e kulturës perëndimore, mund ta kuptojmë se Lufta Botërore në thelb është konflikti midis dy ideve gjermanike, të cilat si të gjitha idetë e vërteta, përjetohen dhe nuk shprehen.

Duke u pasuar nga shpërthimi aktual i përleshjes ballkanike të vitit 1912, kjo mosmarrëveshje para së gjithash mori dukjen e jashtme të një konflikti midis dy fuqive të mëdha, ku njëra kishte në krah këdo, ndërsa tjetra askënd. Ajo arriti një përfundim të përkohshëm në fazën e luftës së llogoreve dhe në shkatërrimin e ushtrive të mëdha. Përgjatë kësaj etape, për mosmarrëveshjen e brendshme e të pazgjidhur të gjoksit gjerman u gjet një formulë e re. Së fundmi, duke përqafuar një zakon të

shekullit të nëntëmbëdhjetë që dikton mbivlerësimin e faktorit ekonomik, ne e kemi shpjeguar konfliktin nëpërmjet termave sipërfaqësorë të “socializmit” dhe “kapitalizmit.” Por ajo çfarë po ndodh në të vërtetë prapa kësaj fasade verbale, është lufta madhore e shpirtit faustian.

Në momentin në fjalë, edhe pse vetë gjermanët nuk ishin të vetëdijsëm rreth kësaj lufte, gjaegjëza napoleonike u shfaq përsëri.

Me qëllimin për ta shkatërruar atë shtet kryevepër, i cili ishte kriteri ynë i vërtetë dhe personal – aq personal saqë asnjë popull tjetër nuk ka qenë i aftë ta kuptojë apo ta imitojë atë, duke e urryer si gjithçka djallëzore dhe të pashkatërrueshme - një ushtri angleze pushtoi gjermaninë.

Besojeni apo jo, kjo është ekzaktësisht ajo çfarë ndodhi. Goditja vdekjeprurëse jo medoemos ishte orkestruar nga predikuesit e kozmopolitanizmit apo nga elementë të tjerë të pabesë. Ishim vetë ne që e shkaktuam këtë fatkeqësi, ne gjermanët, me vullnetin tonë pothuajse metafizik, me vendosmërinë tonë kokëfortë dhe vetëmohuese, me patriotizmin tonë të ndershëm dhe entuziast. Ky vullneti ynë, në thelbin e tij është një armë e volitshme për çdo armik të jashtëm me kuptimin praktik që i japin anglezët.

Është një përbërje e pasigurtë e ideve dhe aspiratave politike, të cilat vetëm anglezët janë vërtet të aftë t'i përsosin dhe implementojnë. Ndërsa neve, pavarësisht të gjitha pasioneve dhe zellit vetësakrifikues, ai na ka shpënë drejt diletantizmit politik; ndikimi që ai ka pasur në ekzistencën tonë politike ka qenë shkatërrimtar, helmues, vdekjeprurës. Është armiku ynë i padukshëm anglez, i lënë nga Napoleoni në tokën gjermane pas Betejës së Jenës.

Sensi ynë i mangët sa i përket realitetit, aq i mbitheksuar sikur të kishte forcën e një Caktimi, i është kundërvënë instinktit tjetër të popullit gjerman dhe ka bërë që historia jonë e jashtme të zhvillohet si një rrjedhim i qëndrueshëm i katastrofave të tmerrshme. Paqartësia rreth realitetit tonë, na shtyu drejt shkatërrimit gjatë periudhës së Hohenstaufenit, kur sundimtarët e lavdishëm e konsideronin veten mbi kërkesat e jetës së përditshme, njësoj siç kishin vepruar në shekullin e

nëntëmbëdhjetë, duke i hapur kështu shtegun krijimit të filistinizmit provincial që ne e kemi personifikuar si “Mikaeli gjerman.” Mikaelizmi është shuma e të gjitha dobësive tona: e pakënaqësisë themelore ndaj ngjarjeve që kërkojnë vëmendje dhe përgjigje; e padurimit tonë për të kritikuar kohën e gabuar; e nevojës sonë për t’u shplohur dhe pushuar në kohën e gabuar; e ndjekjes pas idealeve në vend të nismës për të vepruar; e veprimit të përshpejtuar në kohën kur kishim nevojë për reflektime të kujdesshme; e Popullit tonë si grumbull të pakënaqurish; i asambleve tona përfaqësuese që kishin përfunduar në taverna të lavdishme. Që të gjitha këto tipare janë thelbësisht angleze, por të një imitimi të keq gjerman. Mbi të gjitha, ne i gëzohemi kafshatës sonë të lirisë dhe sigurisë së garantuar dhe jemi gati ta valëvisim me krenari pikërisht në ato momente kur Xhon Bull, me një instinkt të sigurtë, do ta fshihte me maturi.

19 korriku i 1917-tës ishte akti i parë i dramës së Revolucionit Gjerman. Në vend që të ishte një ndryshim i thjeshtë në lidhësi, siç do ta rrëfenin armiqtë tanë nisur nga format e dhunshme që ai mori, ai rezultoi në një grusht shteti nga ana e elementëve anglezë që gjendeshin mes nesh, të cilët në atë kohë panë një mundësi për ta shfrytëzuar. Ajo nuk ishte një revoltë kundër pushtetit të një të paafiti, por kundër pushtetit në përgjithësi.

Paaftësia në nivelet më të larta? Është më e saktë të themi se këta “revolucionarë,” ku midis të cilëve nuk gjendej asnjë burrë i vërtetë shteti, lidhur me ata burra që gjendeshin në pozitën e autoritetit, e bënë qimen tra. Në atë kohë, për të shëruar paaftësinë në fjalë, çfarë tjetër

kishin ata për të ofruar përveçse një parim abstrakt? Ajo nuk ishte një revoltë popullore. Njerëzit panë plot ankth dhe dyshim, edhe pse jo pa njëfarë simpatie të ngjashme me atë të Mikaelit ndaj masave të marra kundër “atyre në krye.” Ai ishte një revolucion i grupeve parlamentare. Termi “partia e shumicës” në kuptimin tonë nuk ka asnjë lidhje me numrin e madh të njerëzve në dispozicion; ai është termi i një klubi me dyqind antarë. Matthias Erzberger, nga pikëpamja taktike ishte demagogu më i talentuar në mesin e tyre, që shkëlqente nëpër skandale, intriga dhe pusi, një virtuoz i vërtetë në lojën e fëmijëve për të shkarkuar ministra. Atij i mungonte dhe grimca më e vogël e talentit të parlamentarizmit anglez për të qenë një burrë shteti; gjithçka që ai bënte ishin imitime dhe hile. Ai joshi një tufë oportunistësh të panjohur, të cilët deri atëherë punonin nëpër poste të rëndomta të administratës.

Këta ishin pasardhësit e vonë të revolucionit filistin të vitit 1848-të; për ta, opozita politike ishte një *Weltanschauung*.³ Këta ishin social-demokratët e kohëve të fundit, që përpiqeshin të funksiononin pa dorën e hekurt të August Babelit. Sensi i qartë që ky i fundit kishte rreth realitetit, nuk do ta kishte toleruar këtë spektakël të paturp. Ai do të kishte kërkuar dhe do ta kishte siguruar një diktaturë, qoftë nga e Djathta ashtu dhe nga e Majta. Ai do ta kishte përmbysur këtë parlament dhe pacifistët e Ligës së Kombeve do t'i

³ Këtë term mund ta përkthejmë si një filozofi apo mënyrë të veçantë të të jetuari, një vizion apo një botëkuptim i një individi apo një grupi njerëzish. (Shënim i përkthyesit)

kishte shpënë përpara togës së pushkatimit. Për ne gjermanët, kjo ishte Rënia e Bastijës.

Sovraniteti i udhëheqësve të partive është një ide angleze. Nëse do të duam ta zbatojmë atë, do të na duhet të jemi anglezë që në origjinë, në thelb dhe në instinkte dhe të kemi përsosur mënyrën angleze të administrimit të çështjeve publike. Miraboja kishte pikërisht këtë në mendje kur tha: “Koha në të cilën ne po jetojmë është madhështore, por njerëzit e saj janë shumë të vegjël, ndaj dhe ende nuk shoh askënd të përshtatshëm me të cilin të lundroj në të njëjtën varkë.” Në vitin 1917 nuk kishte asnjë njeri të vetëm që mund ta përsëriste këtë frazë krenare e të trishtë. Ky grusht shteti ishte i gjithi negativ në natyrë.

Ai shkatërroi shtypjen e pushtetit politik, refuzoi t'i lëshonte urdhrat nga lart, por nga ana tjetër i mungoi aftësia për të marrë vendime të reja. Ai e rrëzoi shtetin dhe e zëvendësoi atë me një oligarki partiake vartësish, të cilët opozitën e shihnin si një profesion, ndërsa qeverinë e përgjegjshme si një pandehje. Ajo shkatërroi, zhvendosi dhe çmontoi gjithçka fije-fije, për kënaqësinë e kundërshtarëve politikë dhe dëshpërimin e vrojtuesve të brendshëm.

Ai provoi zbatimin e një pushteti të sapofituar mbi zyrtarët më të rëndësishëm, njësoj si një prijës vendas teston një një pushkë duke ia drejtuar skllëvërve të tij. Ky ishte një shpirt i ri që mbizotëroi derisa, në momentin e zi të rezistencës përfundimtare, shteti u zhduk tërësisht.

Pas sulmeve nga ana e kryengritësve tanë anglezë, medoemos që do të vinin kryengritjet e proletariatit marksist të vitit 1918. Skena ndryshoi dhe u zhvendos nga hollet e Raishtagut, nëpër rrugët e qytetit. Të inkurajuar nga rebelimi i “Ushtrisë Vendasë,” lexuesit e shtypit radikal shpërthyen keq, edhe se ishin braktisur nga udhëheqësit e tyre, të cilët u treguan mjaftueshëm të mençur që për momentin të ishin vetëm gjysmë të bindur rreth kauzës së tyre.

Pas revolucionit të budallallëkut, erdhi revolucioni i vulgaritetit. Përsëri, nuk ishte populli ai që ndërmoi i pari të vepronte, madje as masat e trajnuara nga pikëpamja socialiste; por ishte turma e drejtuar nga fundërrinat e gazëtarisë. Socialistët e vërtetë ishin ende të përfshirë në luftën përfundimtare të frontit ushtarak, apo tashmë preheshin në varret masive të Evropës. Ata ishin ngritur në vitin 1914, ndërsa tani po tradhtoheshin.

Ky ishte akti më i pakuptimtë në historinë gjermane. Nëse duam që një veprim të ngjashëm ta gjenim në historinë e vendeve të tjera, do të lodheshim më kot. Një franc me shumë të drejtë do ta refuzonte një krahasim me revolucionin e vitit 1789, si një fyerje të mirëfilltë ndaj shtetit të tij. A ishte pra ai, Revolucioni i Madh gjerman?

Sa e shplarë, sa e zbehtë, sa e zbrazur tërësisht nga bindja ishte e gjithë ajo që ndodhi! Aty ku prisnim heronj, gjetëm ish të dënuar, gazetarë, dezertorë që

endeshin për qark duke bër titur e vjedhur, të dehur nga vetë rëndësia dhe pandëshkueshmëria e tyre, duke sunduar, shkarkuar, duke u ngritur e duke shkruar poezi. Është vërtet e trishtë që tipa të tillë kanë ndotur çdo revolucion të mundshëm. Ndoshta kjo është e vërtetë. Por në revolucione të tjerë, populli i gjithë u ngrit me një forcë thelbësore, që ndihmoi në zhdukjen e plotë të fundërrinave që morën gjithashtu pjesë. Ndërsa në rastin tonë, ishin vetëm këta të fundit ata që vepruan. Teksa nuk u pa asnjë shenjë e masës së madhe, e bashkuar si një trup i vetëm përreth një ideje të përbashkët.

Partia e August Babelit kishte cilësi ushtarake që e dallonte nga socializmi i të gjithë shteteve të tjera: gjurmët trokëllitëse të batalioneve të punëtorëve, një sens i qetë vendosmërie, disiplinë e mirë dhe një kurajo për të dhënë jetën për një parim transhendent. E megjithatë, shpirti i partisë u zbeh dhe u davarit, kur udhëheqësit e saj më inteligjentë të një viti më parë iu dorëzuan armikut të të njëjtit vit, e që ishte filistinizmi reaksionar.

Këtë ata e bënë nga frika që patën karshi marrjes së përgjegjësive, nga frika se mos ia dilnin një kauze që e kishin përkrahur për dyzet vjet. Ata iu frikësuan momentit kur do t'iu duhej ta krijonin një realitet të tërë në vend që ta luftonin atë. Kur kjo ndodhi, Marksizmi dhe Socializmi, thënë ndryshe, teoria e klasave dhe instinkti kolektiv, i ndanë për herë të parë rrugët e tyre.

Të vetmit që ruajtën njëfarë integriteti ishin spartacistët. Më të zgjuarit e kishin humbur besimin te dogma, por iu mungonte kurajoja që ta luftonin dhe të

dilnin haptazi kundër saj. Kësisoj, ne dëshmuam spektaklin e klasës punëtore e cila u nda nga populli, e frymëzuar nga disa ide dhe doktrina që i mësoi përmendësh. Udhëheqësit e saj në të vërtetë ishin dezertorë; pasuesit i ndoqën ata duke iu zvarritur nga pas, teksa nuk karakterizoheshin nga kurrfarë udhëheqjeje; dhe në horizont dukej një libër që pasuesit nuk e kishin lexuar kurrë dhe që udhëheqësit nuk e kishin kuptuar kurrë në thellësinë dhe përmasat e tij të vërteta.

Në një revolucion fituesi nuk është kurrë një klasë e vetme (interpretimi i zakonshëm i 1789-tës është i rremë dhe “borgjezia” është thjesht një fjalë). Fituesi i vërtetë – dhe kjo nuk është kurrë e tepërt që të përsëritet vazhdimisht – është gjaku, shndërrimi i idesë në mish dhe shpirt, në një forcë që të nxit e të shpie përpara me gjithsej. Fituesit e 1789-tës e quajtën veten borgjezë; por në të vërtetë *çdo* francez i vërtetë ishte atëherë dhe është edhe sot një borgjez. Çdo gjerman i vërtetë është një punëtor. Kjo është pjesë e mënyrës së tij të të jetuarit. Marksistët mbajtën pushtetin, por hoqën dorë prej tij vullnetarisht; për bindjet e tyre, kryengritja erdhi shumë vonë. Thënë ndryshe, kryengritja ishte një gënjeshtër.

A e dimë +’është revolucioni? Kur Bakunini u kundërshtua në qëllimin e tij për ta kurorëzuar revoltën e Dresdenit të vitit 1848 duke djegur të gjitha ndërtesat publike, ai deklaroi: “Gjermanët janë thjesht tejet budallenj për ta bërë këtë,” dhe më pas u largua në rrugën e tij. Shëmtia e papërshkrueshme e Ditëve të Nëntorit është e paprecedent. Në to nuk ka as edhe një moment energjik dhe asgjë frymëzuese. Aty nuk gjejmë dot asnjë njeri të madh, asnjë fjalë me peshë e që të jetë e destinuar t’i rezistojë kohës, asnjë veprim i mprehtë; gjithë sa shohim janë vogëlsira, urrejtje dhe çmenduri. Jo, ne nuk jemi revolucionarë.

Nuk ka urgjencë, parti apo shtyp që të ngjallë dhe nxisë një stuhi anarkike që të ketë të njëjtën forcë me atë që u shfaq në emër të rendit në vitet 1813, 1870 dhe 1914. Ky revolucion të gjithëve, me përjashtim të disa budallenjve dhe oportunistëve, iu duk si shembja e një ndërtese, e sidomos më së shumti vetë udhëheqësve socialistë.

Ajo ishte një situatë unike: ata kishin fituar befasisht atë çfarë kishin lakmuar për dyzet vjet, pra pushtetin absolut, e megjithatë, ishin gjithsesi të mjerë. Të njëjtët ushtarë që luftuan si heronj për katër vjet nën flamurin e zi, të bardhë e të kuq, u treguan pa shtyllë kurrizore dhe të pafuqishëm përpara flamurit të kuq. Ky revolucion ithtarëve të tij nuk iu dha guxim, por i zhveshi nga ai.

Vendi klasik i revolucioneve evropiane perëndimore është Franca. Oshëtimia e frazave të rëndësishme,

lumenjtë e gjakut nëpër rrugë, *gijotina e shenjtë*, netët e tmerrshme të zjarrvënieve masive, vdekja heroike nëpër barrikada, orgjitë e masave të çmendura – që të gjitha këto nxjerrin në pah mendësinë sadiste të kësaj race. Ne kishim në dispozicion të gjithë repertorin e fjalëve dhe veprave simbolike për revolucionin perfekt që kishte nisur në Paris, e megjithatë, ajo çfarë bëme ishte një imitim i keq i tyre. Në vitin 1871 francezët ne na treguan se si një kryengritje proletare dukej në sytë e artilerisë armike. Dhe me siguri që kjo nuk ishte e vetmja herë.

Angli përpiket ta bindë armikun e brendshëm rreth dobësive të pozitive të tij. Nëse është i pasuksesshëm në këtë, ai thjesht merr shpatën dhe revolen në dorë dhe, duke iu shmangur melodramës revolucionare, i paraqet atij zgjedhjen. Ai i pret kokën mbretit të vet, në instinkt e sipër i tregon se kjo është e nevojshme në cilësinë e një simboli. Për të, një veprim i tillë është një predikim i mirëfilltë i pashprehur me fjalë.

Gjëra të tilla francezi i bën nisur nga *revanshi*, për hir të kënaqësisë së pastër të shikimit të një skene të përgjakshme. Ai është i eksituar nga ideja e mprehtë e prerjes së kokës mbretërore. Pa koka njerëzore të të varura nëpër shtylla, pa aristokratë të varur nëpër fenerë rrugësh dhe pa priftërinj të therur nga gra shtëpiake, ai do të ndihej i frustruar. Ai nuk është fort i interesuar për rezultatin e të tilla ditëve *madhështore*. Anglezi dëshiron qëllimin, ndërsa francezi mjetet.

Po dëshira jonë cila ishte? Gjithë sa ne realizuam ishte një parodi e alternimit të të dyja teknikave. Ne prodhuam pedantë, djelmosha shkollë dhe thashetheme

në Paulskirche dhe Vejmar, demonstrata të vogla nëpër rrugë dhe në sfond një komb që karakterizohej nga një interes i zbehtë. Një revolucion i vërtetë duhet të përfshijë të gjithë popullin: ai duhet të jetë si një thirrje e vetme, një akt i pacipë, një zemëratë, si një qëllim. Revolucionet e vërtetë socialist gjerman ndodhi në vitin 1914.

Ai u zhvillua në një mënyrë legjitime dhe ushtarake. Në domethënie të vërtetë, e cila vështirë se mund të kuptohej nga një njeri me formim mesatar, ai gradualisht do t'i linte në hije ngjarjet e neveritshme të 1918-tës dhe do t'i bënte të dukeshin si faza në zhvillimin afatgjatë të vetë Revolucionit.

E megjithatë, opinioni historik që qarkullon në nivel popullor, nuk do t'i jepte rëndësi këtij Revolucionit, por kryengritjeve të nëntorit. Është e lehtë të përfytyrojmë se si, në kushte ideale, në këtë kohë mund të kishte filluar një revolucion i vërtetë proletar. Kjo thjesht tregon burracakërinë verbuese dhe mediokritetin e atyre që u deklaruan në mbështetje të kauzës proletare. Revolucionet e mëdha luftohen me gjak dhe hekur. Çfarë do të kishin bërë në këtë situatë udhëheqësit e mëdhenj popullorë, të Pavarurit dhe Jakobinët?

Në të njëjtën kohë, çfarë ishte ajo që bënë marksistët? Ata kishin pushtetin dhe mund të kishin bërë thjesht gjithçka. Një njeri i madh nga radhët e popullit mund të kishte pasur të gjithë kombin pas vetes. E megjithatë, asnjëherë nuk ka ndodhur që një lëvizje e masave të jetë shkatërruar nga paaftësia e udhëheqësve dhe togerëve të saj më shumë sesa në këtë rast.

Jakobinët ishin përgatitur që të sakrifikonin gjithçka sepse para së gjithash, ata sakrifikuan vetet: “*Marcher volontiers, les pieds dans le sang et dans les larmes,*” siç është shprehur dhe vetë Sent Zhysti.⁴ Ata luftuan kundër shumicës brenda kombit dhe kundër gjysmës së Evropës në front. Ata morën mbarë duke rrafshuar gjithçka që hasën. Krijuan ushtri nga hiçi. Korrën fitore pa oficerë dhe pa armë. Ah sikur imituesit e tyre gjermanë që i ngjanin papagajve të kishin valëvitur në front flamurin e kuq dhe t’i kishin shpallur luftë deri në vdekje kapitalizmit! Sikur të kishin dhënë një shembull duke vënë në rrezik vetë jetët e tyre! Nëse do të kishin bërë këtë zgjedhje, ata do të kishin ripërtërirë dhe rigjallëruar një ushtri tashmë të vdekur duke i rikthyer në jetë nga e para oficerët e saj, ashtu si dhe do ta kishin pushtuar të gjithë Perëndimin. Ai ishte një moment që sakrifica personale do të përkthehej në fitore.

Por ata u zbrapsën pa një e pa dy. Në vend që të marshonin në drejtimin e legjioneve të kuqe, ata zunë pozicionet më të mira nëpër sovjetet më të mirëpaguara popullorë. Në vend që të zhvillonin luftën kundër kapitalizmit, ata fituan xhama dritaresh, depo të lira ushqimesh dhe thesare shtetërore. Në vend që të shisnin jetët e tyre, shitën uniformat.

Ky revolucion dështoi si pasojë e burracakërisë dhe frikës. Tani është shumë vonë. Nuk do t’ia dalim kurrë të rikuperojmë atë çfarë humbëm gjatë Armëpushimit. Ideali i masës degjeneroi në një seri marrëveshjesh

⁴ Duke marshuar vullnetarisht, me këmbët që kullonin gjak dhe lot. (Shënim i përkthyesit)

korruptive, të imponuara pa premtime reciproke. Në trimërinë e tyre këta “revolucionarë” nuk u zbrapsën nga përfitimi në kurriz të pjesës tjetër të njerëzve, si nga fermerët, punonjësit civilë dhe intelektualët. Në vend që të vepronin, ata nisën që sloganet “sovjetë,” “diktaturë” dhe “republikë” t’i artikulonin aq shpesh me të madhe sa që brenda harkut kohor të dy viteve, do të ishin shndërruar në objekt talljeje e të qeshurash. I vetmi “veprim” që ndodhi ishte përmbysja e monarkisë. E megjithatë, një formë republikane qeverisjeje nuk ka të bëjë aspak me socializmin.

E gjithë kjo vërteton se, në kundërvënien me pjesën tjetër të popullit (dhe na del se ky *është* në kundërshtim me të), “pushteti i katërt,”⁵ që në të vërtetë është një koncept negativ,⁶ është i paaftë për të vepruar në mënyrë konstruktive. Kjo vërteton se nëse ky ishte vërtet revolucion i socialist, atëherë proletariati nuk mund të jetë përkrahësi i tij më efikas. Nuk ka rëndësi se çfarë do të vijë më pas, kjo çështje tashmë është zgjidhur në mënyrë përfundimtare. Klasa shoqërore e trajnuar nga August Babeli për luftën vendimtare, tashmë ka dështuar.

Dhe ka dështuar një herë e përgjithmonë, sepse momente të këtij lloji, pasi nuk shfrytëzohen njëherë, humben për të mos u rifituar më kurrë. Një pasion i madh nuk mund të zëvendësohet nga hidhërimi. Që tani e tutje le të mos ketë asnjë iluzion nga ana e mbështetësve të programit të dikurshëm “socialist;” ata e

⁵ Gazetaria. (Shënim i përkthyesit)

⁶ Rënia e Perëndimit, Vëllimi i II-të, fq. 354.

kanë tjetërsuar tërësisht elementin e çmuar të klasës punëtore. Dikur udhëheqësit e një lëvizjeje të madhe, një ditë kanë për ta parë veten si heronjtë gojëmedhenj të përleshjeve të rrugëve nëpër periferitë e qyteteve. Me një fjalë, kalimi nga sublimja te qesharakja është vetëm një hap larg.

I këtillë pra, ishte revolucioni gjerman, ajo ngjarje që u trashëgua nëpër poezi e këngë brez pas brezi. Ai ishte një spektakël i një ironie aq të frikshme saqë do të duhet të kalojnë dekada të tëra që gjermanët ta shohin atë në dritën e tij të vërtetë: një revolucion që ia del të përmbysë dhe hedhë poshtë vetë qëllimet e tij dhe që tani ka për synim diçka tjetër, pa e ditur ende se çfarë.

Le të përfytyrojmë për një moment që jemi qytetarët e së ardhmes dhe që i shohim pas këta tre revolucione: Revolucionin e nderuar Anglez, Revolucionin madhështor Francez dhe Revolucionin absurd Gjerman. Mund të dalim në përfundimin se përmes këtyre ngjarjeve, tre popujt e sipërpërmendur të botës perëndimore u përpoqën që të arrinin tre format ideale të ekzistencës, të shpallura në moton e famshme: “Liri, barazi dhe vëllazëri.” Këto ideale shfaqen në programet politike të parlamentarizmit liberal, demokracisë sociale dhe socializmit autoritar. Në secilin rast, duket se ideale të tilla ishin një koncept i ri për këta popuj, ndërkohë që në realitet ishin shprehjet më të pastra dhe më ekstreme të strukturave të tyre tërësisht personale dhe të pandryshueshme të mënyrës së të jetuarit.

Në antikitet qëllimi i revolucioneve ishte themelimi i bazave mbi të cilat të mund të realizohej një ekzistencë e qëndrueshme. Pavarësisht shenjave të jashtme të luftës pasionante që i bashkëshoqëronin ata, këta revolucione ishin që të gjithë veprime mbrojtëse. Nga Kleoni e deri të Spartaku, askush nuk mendoi që të shihte përtej krizës

immediate, drejt një riorganizimi të përgjithshëm të shoqërisë antike. Tre revolucionet e mëdha perëndimore, nga ana tjetër, në thelb janë marrë me një çështje të pushtetit: Është vullneti i individit ai që duhet t'i nënshtrohet vullnetit të përbashkët apo e anasjellta? Pasi për këtë çështje u mor një vendim, qëllimi ishte që ai të imponohej nëpër të gjithë botën.

Instinkti anglez vendosi që pushteti i përkiste individit. Jeta është e lirë për të gjithë, ku kushdo përpiqet për veten e tij dhe fiton më i forti. Anglezët synonin liberalizmin dhe promovonin besimin te pabarazia e njerëzve. Shteti nuk duhet të ekzistonte më; secilit i duhej të luftonte vetë nëpër betejat e tij sepse në fund fare, ato do t'i shërbenin të gjithëve. Instinkti i francezëve vendosi që të gjithë njerëzit janë të barabartë, ndaj dhe për rrjedhojë pushteti nuk duhet t'i përkasë askujt. Nënshtrimi nuk duhet të ekzistonte fare dhe për pasojë, as rendi dhe as shteti; praktikisht nuk duhet të ekzistonte asgjë. Ky ideal teorik i anarkisë, në praktikë ka qenë vazhdimisht i konfirmuar (në vitet 1799, 1815, 1871, 1918) nga sundimet despotike të gjeneralëve dhe presidentëve.

Që të dy këta sisteme mund të quhen demokraci, por për arsye shumë të ndryshme. Ata nuk kishin të bënin aspak me luftën e klasave në kuptimin marksist të fjalës. Revolucioni Anglez, që prodhoi llojin e qytetarit që bën një jetë private dhe është përgjegjës vetëm për veten, veprimin e tij e orientoi në drejtim të shtetit dhe jo të të pasurve. Pushtetet sekulare dhe fetare që mbështesnin shtetin u shfuqizuan dhe vendin e tyre e zuri besimi te avantazhet që vinin prej vendndodhjes ishullore të

Anglisë. Shtresa e pasur ekziston edhe sot e kësaj dite, e njohur dhe e respektuar nga të gjithë – madje edhe nga punëtorët, që e nderon atë në mënyrë instinktive. Vetëm Revolucioni Francez ishte një “konflikt i vërtetë klasor,” edhe pse në thelb, ishte një konflikt midis palëve shoqërore dhe jo atyre ekonomike. Në Francë të privilegjuarit e paktë u integruan me masën homogjene të popullit, pra me borgjezinë.

Në kontrast me këta të dy, Revolucioni Gjerman ishte rrjedhojë e një teorie. Instinkti gjerman, apo më mirë ta themi instinkti prusian, shpall se pushteti i përket totalitetit. Individit i shërben totalitetit, i cili është sovran. Mbreti, siç besonte Frederiku i Madh, është thjesht shërbyesi i parë i popullit të tij. Çdo qytetari i është caktuar pjesa e tij në këtë totalitetit. Ai merr urdhra dhe iu bindet atyre.

Ky është socializmi autoritarian, siç e kemi njohur që në shekullin e tetëmbëdhjetë. Ai është thelbësisht neoliberal dhe antidemokratik, së paku kur krahasohet me liberalizmin anglez dhe demokracinë franceze. Por është gjithashtu e qartë që edhe instinkti prusian, është gjithashtu antirevolucionar. Detyra e zhvendosjes së organizmit shtetëror nga shekulli i tetëmbëdhjetë në atë të nëntëmbëdhjetë – një proces që mund të përshkruhet si liberal dhe demokratik, por në një kuptim tërësisht të ndryshëm dhe prusian - ishte një proces që kërkonte një talent organizativ.

Por mendja radikale teorike shpiku një shpiku një “pushtet të katërt” nga gjiri i popullsisë, i cili ishte i pakuptimtë në një shtet fermerësh dhe punonjësish

civilë. Emërtimin “pushteti i tretë” teoria ia dha segmentit më të gjerë të popullsisë, atij që përbëhej nga një larmi zanatesh dhe profesionesh, duke e dalluar atë si një element të një “konflikti klasor.” Përfundimisht, idenë socialiste ajo e shndërroi në një prerogativë të “pushtetit të katërt.” Me këto abstraksione në mendje, teoristët vendosën që në nëntor të 1918-tës të arrinin atë që në të vërtetë kishte qenë e pranishme për një jetë të gjatë. Të frikësuar nga sloganet, ata nuk ia dolën ta kuptonin gjendjen aktuale të çështjeve dhe në fund ia dolën që ta shkatërronin status quo-në. Ata jo vetëm që shkatërruan shtetin por shtypën edhe partinë e Bebelit, kryeveprën e një socialisti të vërtetë veprimi, një organizim vërtet autoritarian dhe ushtarak, arma më e mirë që punëtorët kishin në luftën e tyre për ta mbushur shtetin me shpirtin e shekullit të ri.

Kjo është ajo çfarë e bën këtë revolucion kaq dëshpërimisht komik. Ai ia doli në mënyrë të admirueshme që t’i vinte zjarrin vetë shtëpisë së tij. Atë çfarë populli gjerman i kishte premtuar vetes në vitin 1914; atë çfarë ai kishte filluar ta vinte në jetë në mënyrë të ngadaltë dhe mospërfillëse; ajo për të cilën miliona njerëz kishin dhënë jetën nëpër fushëbeteja – të gjitha këto u mohuan dhe u shkatërruan.

Pas kësaj, ajo çfarë pasoi ishte sikleti e pezullia. Askush nuk e dinte se si ta përçonte përshtypjen që ajo që ishte duke ndodhur ishte një revolucion aktiv. Një shpjegim i tillë ishte një emergjencë, sepse punëtorët, që kishin pritur diçka plotësisht të ndryshme, i panë udhëheqësit e tyre me një mosbesim gjithnjë e në rritje.

Lehja e vazhdueshme e sloganeve në ajër dhe pa asnjë destinacion, nuk ishte zgjidhje.

Dhe kështu Mikaeli gjerman, ai liberal i pandreqshëm, e drejtoi fronin e përmbysur dhe u ul në të. Trashëgimtari i padjallëzuar i kësaj shakaje revolucionare, thellësisht antishoqëror për nga natyra, ai u zbyth në mënyrë të barazvlefshme si nga konservatorët ashtu dhe nga spartakistët, i frikësuar se këta grupe një ditë mund ta zbulonin se çfarë kishin të përbashkët mes tyre. ai ishte Karl Moor-i i Schiller-it, i ulur në një poltronë të gjerë e të rehatshme, tolerant ndaj të gjitha bindjeve politike, përfshirë këtu edhe më të dyshimtat, me kushtin që ato të përqaфонin parimin republikan-parlamentar-demokratik, që do të bisedonin gjatë dhe do të vepronin pak dhe që do t'i fshihnin nga sytë e tij cilësitë e tyre autoritare të tilla si vendosmëria, guximi dhe bindja e disiplinuar.

Për ta mbrojtur veten, miku ynë i mirë Mikael i bëri thirrje personalitetit të shquar të episodit të nëntorit dhe nuk është jodomethënëse që ky njeri ishte një ushtar i pandreqshëm dhe që nuk i ndryshonte kurrë bindjet e tij. Me ç'rast, Mikaeli menjëherë u rikthye te mosbesimi i tij i vjetër i shpirtit ushtarak, pa të cilin farsa e Vajmarit do të kishte përfunduar shpejt.

Kjo shfaqje për të ardhur keq e padituriisë, paaftësisë, dobësisë dhe poshtërimit do të mjaftonte për ta diskredituar përgjithmonë parlamentarizmin në Gjermani. Nën flamurin e zi, të kuq e të verdhë, i cili tani është shndërruar në simbolin e përjetshëm të çmendurisë, ne dëshmuam një përsëritje të të gjitha budallallëqeve të 1848-tës, kur politika në të njëjtën

mënyrë nuk ishte veprim por një teorizim dhe dërdëllitje boshe. Liberali i 1917-tës ishte në lavdinë e tij. Ai pati armëpushimin që dëshiroi, Ligën e tij të Kombeve, paqen dhe qeverinë që deshi. Mikaeli e hoqi kapelen e tij duke buzëqeshur, me pritshmërinë se Xhon Bulli do të ishte “thjesht i shkëlqyer.” Por buzëqeshja e tij u shndërrua në të qara, teksa nënshkroi dokumentet: Xhon Bull ishte duke përdorur një francez të çmendur si menaxherin e tij të biznesit.

Në zemrën e popullit gjerman Vajmari është diçka e dënuar. Ai nuk është diçka as për të qeshur. Miratimi i Kushtetutës është përshëndetur dhe pranuar nga një indiferencë absolute. Autorët e tij menduan se agimi i parlamentarizmit kishte arritur, kur në të vërtetë ai edhe në Angli është në një hije gjithnjë e më të dendur. I tillë siç është, sistemi anglez presupozon praninë e personaliteteve të forta, të shpërndara midis dy grupeve shumë të vjetra dhe reciprokisht politikisht plotësuese.

Në Vajmar, ku kishte një mungesë të dëshpëruar personalitetesh të fortë, besohej se opozita politike ishte shenja e vërtetë dalluese e sistemit parlamentar. Dhe kështu ata nisën me një përkushtim të pashembullt t'i kundërviheshin një qeverie që nuk ekzistonte më. Tabloja ishte e ngjashme me një klasë shkolle në të cilën mësuesi nuk ishte i pranishëm.

E ardhmja me shumë mundësi këtë episod ka për ta parë me një përçmim të thellë. Viti 1919 është pika më e ulët e dinjitetit gjerman. Frankfurt Paulskirche përmbante sa akademikë dhe budallenj të ndershëm, aq edhe grumbullime komike intelektualësh. Në Vejmar të

krijohej përshtypja se prapa skenave qëndronin agjentë të zgjuar. Nuk kishte kurrfarë diference nëse politikanët veprues ishin vetë komplotistët apo thjesht viktimat e komplotuesve; këto parti e ngatërruan shumë shpesh atdheun në avantazhin e tyre. Ajo çfarë ne kemi tani është një *Direktorat* i para Termidorit. Mjerë për ne nëse do ta rikthejmë përsëri fazën që tashmë e kemi kaluar!

Është po aq e sigurtë që komedia e zyrtë e këtij revolucioni të rremë do të përfundojë. Bota e jashtme është duke u përgatitur për një fazë të re të Luftës Botërore. Këto ditë gjërat po ndodhin shumë shpejt. Në Asamblenë tonë Kombëtare, që konsiston në një Raishtag të degjeneruar, politikanët janë duke përdorur gërmadhat e shtetit tonë të shkatërruar për të ndërtuar një strehë të improvizuar.

Shumë shpejt të vetmet veprimtari do të jenë marrëveshjet mashtruese e hileqare sa i përket pagave, mallrave dhe posteve zyrtare. Ndërkohë, të tjerë njerëz po fillojnë të mendojnë ndryshe rreth ngjarjeve të vitit të fundit. Ata janë duke krahasuar atë çfarë sot po ndërtohet me atë që ishte dje. Po fillojnë të kuptojnë se, në realitet, një popull nuk mund të zgjedhë kurrë midis dy llojeve të ndryshme qeverisjeje.

Ai mund të zgjedhë zbulimet e jashtme të qeverisë, por jo thelbin, shpirtin e qeverisë, madje edhe për shkak se opinioni publik i ngatërron në mënyrë të vazhdueshme këta dy përbërës. Ajo çfarë përfundon duke u shkruar në një kushtetutë nuk është asnjëherë thelbësore. Gjëja e rëndësishme është se si instinkti i një populli e interpreton atë. Parlamenti Anglez qeveris me

ligje të pashkruara dhe pjesërisht, antidemokratike, të cilat e kanë përfutur trajtën e tyre përfundimtare pas një zhvillimi dhe praktike të gjatë. Dhe kjo është pikërisht arsyeja se përse është kaq i suksesshëm.

T'ia kursejmë vetes gabimet, revolucioni ende nuk ka mbaruar. Nuk ka rëndësi se si e interpretojmë, si të pakuptimtë apo domethënës, si një dështim apo si një fillim i mbarë, si preludin e një revolucioni botëror apo thjesht si një kryengritje turme e një shteti të vetëm, ajo që mbetet e vërtetë është që ne gjendemi në mes të një krize. Dhe si çdo gjë organike, si çdo sëmundje, kjo krizë do të pasojë një rrjedhë pak a shumë tipike që nuk mund të influencohet përmes mjeteve artificiale. Në perspektivën e këtij fakti, të tilla dallime etike si “kauza e drejtë” dhe “tradhtia” janë vërtet të pavlera. Që tani e tutje, revolucionarët dhe kundër-revolucionarët e ngjashëm duhet të kenë dituri të përparuara rreth natyrës njerëzore; ata duhet të jenë të aftë të rrokin dhe shfrytëzojnë situatën e menjëhershme me qëllimshmëri dhe maturi. Në vend që të praktikojnë artin e vjetër të psikologjisë diplomatike sa i përket diplomatëve dhe sovranëve, ata duhet të mësojnë të zbatojnë atë mbi mendjen e masave, e cila i përgjigjet shumë më shpejt gabimeve që vijnë nga mungesa e taktit.

Udhëheqësit popullorë, edhe ata të karakterizuar nga një inteligjencë mediokre, kanë një aftësi të pagabueshme për këtë. Mungesa e instinktit që shfaqin udhëheqësit tanë aktualë politikë, ndoshta më së miri shpjegohet përmes përpikmërisë tipike gjermane të edukimit të tyre “teorik.”

Udhëheqësi i vërtetë popullor duhet të ketë një sens plotësisht të saktë të kohëzgjatjes, të tempit dhe të ritmit, të ngjijtes dhe zbritjes së secilës fazë të situatës; duhet ta

dijë mirë që një veprim i gabuar do t'i kushtonte humbjen e të gjithë kontrollit. Veç kësaj, ai duhet ta dijë saktësisht se cilët faktorë *mund* të kontrollojë dhe cilët mund t'i lejojë që të ndjekin rrjedhën e tyre, duke pritur për kohën kur mund t'i shfrytëzojë në një kontekst më të gjerë apo, nëpërmjet një manipulimi mjeshëtor, t'i orientojë ato në drejtimin që e gjykon si të nevojshëm. Revolucionarët e mëdhenj gjithmonë e kanë zotëruar aftësinë taktike të gjeneralëve të mëdhenj. Për një ushtri, gjendja mbizotëruese e një ore të vetme mund të konsistojë në fitore apo dështim.

Për mendjen teorike, pjesa më e rëndësishme e revolucionit është fillimi i tij, kur forcat janë rreshtuar në një kundërvënie të qartë dhe të përcaktuar me njëra-tjetrën. Nga ana tjetër, mendja skeptike preferon të studiojë fazën finale të një revolucionit, sepse për të ajo bart më shumë domethënie dhe nga pikëpamja psikologjike është më e dobishme.

Çështjet e shtetit asnjëherë nuk kanë qenë kaq të ndërlikuara sa sot. Shpërthimi i Revolucionit Gjerman në të njëjtën kohë ishte tradhtia e kombit tonë në favor të armikut. Si rezultat, qëndrimi ynë emocional kundrejt Marksizmit ndryshon radikalisht nga ai i të gjithë vendeve të tjera.

Në vitin 1792, kombi dhe revolucionit ishin një dhe e vetmja gjë; në 1919-tën, janë e kundërta e njëri-tjetrit. Revolucionit Anglez e kufizoi veten e tij në një ishull, kurse kryengritësit francezë, falë trimërisë që treguan në këtë fushë, ishin të aftë që situatën ta kishin nën kontroll gjatë gjithë kohës. Ndërsa në revolucionin tonë, çdo fazë

e rë ndodhi dhe u zhvillua nën tryshinë e skicimeve të huaja. Parisi, Londra dhe Nju Jorku janë që të gjitha të përfshira – jo përmes lëvizjeve të tyre punëtore por nëpërmjet ushtrive, të cilat janë të gatshme t'i dërgojnë menjëherë kundër nesh, nëse Revolucioni Gjerman do të kishte marrë formë të padëshirueshme nga perspektiva e tyre. Zhvillimi i tij në këtë mënyrë përkoi me dëshirën e marksistëve tanë, ndaj dhe ata do të bënin mirë që të përgatiteshin për pasojat. Përveç granatave të dorës së Spartakistëve dhe mitralozëve të Reichswehr⁷, kemi Ushtrinë Pushtuese franceze dhe flotën angleze.

Gazetat tona janë plot deklarata “heroike” nga ana e bolshevikëve. Çdo ditë ne marrim dozën e caktuar të informacionit rreth masakrave të kapitalistëve perëndimorë, duke lexuar faqet tona editoriale. Gazetaria nuk është zëvendësuesja për një front të vërtetë revolucionar, i mbështetur nga një artileri e rëndë. Sa më shumë që predikojnë për revolucionin botëror, aq më pak kërcënues bëhet ai. Në ligjërimin revolucionar që ne dëgjojmë dhe lexojmë këto kohë, dominon zemëratë dhe mirëbesimi është në kufijtë e së papërfillshmes. Duhet vënë në dukje se burracakërisë e treguar përballë armikut as revolucionarët rusë nuk e konsideruan një pikë themelore të programit të tyre.

Dhe nuk duhet harruar që shumë prej atyre të cilët morën pjesë në kryengritjen e nëntorit vepruan pikërisht kështu, nisur jo nga entuziazmi për këtë apo atë zgjedhje politike, por për shkak se ishin të uritur dhe të

⁷ Reichswehr në gjuhën gjermane do të thotë “Mbrojtja e Rajhut” dhe ishin forcat e armatosura gjermane nga viti 1919 në atë 1935. (Shënim i përkthyesit)

dëshpëruar, për shkak se nervat e tyre nuk mund ta përballonin dot më atë sforcim. Vendimet e mbërritura në Versajë bënë të mundur vazhdimin e gjendjes së luftës. Por edhe për sa kohë mund të ndodhë që efekti psikologjik i atyre vendimeve të konsistojë në një ndihmë dhe jo në një pengesë për konceptimet e marksistëve?

Greva e përgjithshme i ka rritur jetëgjatësinë e dobisë së tyre, si një armë e vërtetë. Viti i kaluar i shpërndau dhe i asgjësoi të gjitha energjitë me të cilat lëvizja marksiste duhet të fillonte të vepronte, ndaj dhe në këtë moment rigjallërimi i tyre është jashtë çdo diskutimi. Ngjarjet absurde që zhvillohen në Asamblenë Kombëtare janë të destinuara të mos prodhojnë asgjë përveç përbuzjes karshi idesë parlamentare.

Në çdo revolucion vjen një kohë kur paqen dhe rendin e brendshëm populli do ta kërkojë me çdo çmim, kur për ndërmarrjen e veprimeve themelore politike nuk do t'ia dalë ta bindë asnjë pakicë revolucionare, madje edhe nëse përdor metodat më drastike. Kur kjo pikë arrihet, revolucioni praktikisht ka arritur në fundin e tij dhe askush nuk ka fuqinë që t'i shmangë apo t'i shtyjë pasojat e tij. Për të kuptuar se populli francez më në fund ishte ngopur me revolucionin, vetmja gjë që duhet të bëjmë është të krahasojmë numrin aktual të votave të plebishitit jakobin me ato të instalimit të Bonaparte-s si konsulli i parë.

Këtë pikë përfundimtare jemi duke e arritur me shumë shpejtësi edhe në Revolucionin Gjerman. Dhe

durimi i popullit gjerman ka për të mbaruar akoma dhe më shpejt.

E megjithatë, janë vetëm përkrahësit e përbetuar të ndryshimit radikal ata që janë të ekspozuar nga rreziku i kryerjes së gabimeve; por edhe kundërshtarët e tyre barazvlefshëmrisht të përbetuar janë të ekspozuar ndaj të njëjtave mundësi gabueshmërie. Një ndjesi e fortë por e papërcaktuar zhgënjimi është ende një rrugë e gjatë nga vendimi aktual për të kapitulluar. Sensi i dështimit politik që është përhapur nëpër popullin gjerman është si një plagë e hapur që është shumë e ndjeshme edhe ndaj prekjes më të vogël.

Nëse opozita do të bënte qoftë edhe përpjekjen më të vogël për t'i dhënë revolucionit fund me dhunë, do të çlironte në popull një valë të papërmbajtur hidhërimi dhe zemërimi, të cilën edhe vetë radikalët janë të paaftë që ta ngjallin. Do të përjetonim një protestë të një force ngjithëse, një shpejtim të beftë të gjendjes popullore që udhëheqësit e vendosur mund ta shfrytëzonin për veprime të një lloji vërtet drastik. Paçka se është e vërtetë që një zhvillim i tillë nuk do të ndikonte në kohëzgjatjen apo kuptimin thelbësor të ngjarjeve historike, ajo gjithsesi do ta kombinonte formën dhe intensitetin e tyre në një shkallë të konsiderueshme. Gjërat mund të merrnin një rrjedhë shumë të përgjakshme.

Tani ne kemi arritur në një fazë vendimtare të këtij revolucion, kemi mbërritur në një kohë kur mendja e padepërtueshme e masës mund të ngatërrojë edhe vrojtuesit më të ditur, duke i shkaktuar një ndryshim të

beftë rrjedhës së ngjarjeve, siç i ka dhënë në revolucionet e mëdha që kanë ndodhur më parë. A mos ndoshta heshtja e nderë që mbizotëron në disa zona të vendit tonë tregon praninë e një vullneti të pathyeshëm? Mos ndoshta zhurma e padurueshme që ne dëgjojmë nga këto zona duhet të interpretohet si një vetëdije gjithnjë e më e lartë rreth disfatës përfundimtare? Mos ndoshta për kryengritësit tashmë është shumë vonë për të vepruar? Po për opozitën, mos ndoshta është shumë herët?

Është një njohuri e zakonshme që struktura të tilla politike që për momentin duken të pathyeshme, në harkun kohor të dy viteve mund ta kenë humbur peshën e tyre. Kjo ishte e vërtetë në vitin 1918 dhe ka për të qenë përsëri e tillë në të ardhmen e afërt, pavarësisht se me një efekt thuajse të kundërt. Njerëzit e djeshëm të oborrit mund të jenë mbretvrasësit e sotëm, ndërsa mbretvrasësit e sotëm, princat e së ardhmes. Në kohë të tilla askush nuk mund të jetë i sigurtë se për sa kohë do t'i zgjasin bindjet që ka.

Por në përputhje me ç'njësi kohe do ta përshtasim të menduarit tonë? Duhet të fillojmë të mendojmë në perspektivën e muajve apo viteve? Ritmi dhe kohëzgjatja e Revolucionit Gjerman u përcaktuan nga koha dhe mënyra në të cilën ai nisi. Askush nuk mund të ketë dijeni rreth këtyre faktorëve, e megjithatë ato ekzistojnë dhe funksionojnë në harmoni me pashmangshmërinë e Caktimit. Kushdo që përpiqet që të ndërhyjë te to, ka për t'u asgjësuar. Zhirondinët u shkatërruan sepse menduan se kulmi i revolucionit qëndronte prapa tyre; Babeufi u përball me fatin e tij sepse besoi se kulmi do të duhej ende të vinte. Natyra e brendshme e Revolucionit do të

qëndronte e paprekur edhe nëse do të shpërthenin luftra të reja, madje edhe nëse do të shfaqej ndonjë personalitet i madh. Ndodhi të tilla mund të shkaktojnë një ndryshim të befasishëm dhe të plotë në *dukjen* historike të Revolucionit Gjerman – i cili është gjithçka që ka rëndësi për vrojtuesin e zakonshëm – por funksioni i tyre i vërtetë do të konfirmonte domethënien e tij më të thellë dhe më thelbësore.

Njeri i madh është ai që e kupton shpirtin e kohës së tij, që mishëron atë shpirt. Në këtë botë ai nuk vjen për ta shkatërruar, por për ta përmbushur. Ndaj dhe tani le t'i shqyrtojmë më nga pranë origjinën e shpirtit të socializmit gjerman.

II. Socializmi si mënyrë jetese

8

Përpara nesh shtrihen gjashtë mijë vite të historisë së lartë njerëzore. Midis numrit të madh të njerëzve dhe ngjarjeve që janë shfaqur në të gjithë planetin tonë, ne mund të dallojmë ata elementë që formësojnë historinë në kuptimin e duhur të fjalës: spektaklin dhe fatin e kulturave të mëdha.

Në syrin e vrojtuesit ato duken si njësi formale që në thelb karakterizohen nga një strukturë e ngjashme, si manifestime të dukshme të forcave të fuqishme të shpirtit njerëzor, si shprehjet reale dhe jetike të mistereve më të thella të evolucionit njerëzor.

Në secilën kulturë gjendet i pranishëm një parim i pandryshueshëm që i jep asaj tiparet e tij të veçanta të besimit, mendimit, ndjenjave, veprimit, qeverisjes, artit dhe strukturës shoqërore. I njëjti parim ka bërë të mundur lindjen e atyre që ne sot i quajmë “lloje” të njeriut: të njeriut klasik, indik, kinez dhe perëndimor. Secili prej tyre ka pasur instinktin dhe vetëdijen e vet, që do të thotë se ka pasur “racën” e tij, në kuptimin spiritual të fjalës.

Për më tepër, secila nga këto njësi kulturore është e plotë në vetvete dhe e pavarur nga të tjerat. Historiografia tradicionale ka qenë e interesuar vetëm në ndikimet historike mbi kulturat, pa e kuptuar që ndikime të tilla në të vërtetë janë të llojit më sipërfaqësor. Për së brendshmi, të gjitha kulturat mbeten ashtu siç edhe janë.

Ato lindin dhe lulëzojnë buze Nilit dhe Eufratit, Gangut dhe Hang Hose, në Shkretëtirën Semite, në brigjet e Egjeut apo në rrafshnaltat përbri lumenjve të Evropës së Veriut. Secila kulturë bashkon në gjirin e saj qenie njerëzore dhe iu mundëson atyre që të formojnë një popull; që do të thotë se një popull pra, me fjalë të tjera, nuk është krijuesi por krijesa e kulturës së tij.⁸

Dorianët dhe jonianët, helenët dhe etrusko-romakët, popujt e Kinës së vjetër, teutonët dhe latinët, gjermanët dhe anglezët – që të gjithë këta popuj kanë mendësinë dhe domethënien e tyre të veçantë, ku secili qëndron në kundërvënien të zellshme me të tjerët. I parë nga për së jashtmi dhe i krahasuar me kulturat e tjera, secili merr një formë të bashkuar: kështu pra ne flasim për njeriun klasik, kinez dhe perëndimor.

Në themel të çdo kulture qëndron një ide që është e shprehur nga disa fjalë të caktuara të cilat bartin një domethënie të thellë. Në kulturën kineze këto fjalë janë *tao* dhe *li*; për grekët apolonianë kjo ide kulturore përmbante fjalët *logos* dhe *to on* (“ajo që është”). Në gjuhën e njeriut faustian ideja kulturore bazë shprehet nga fjalët “vullnet,” “fuqi” dhe “hapësirë.” Njeriu faustian ndryshon nga të tjerët nga vullneti i tij i pangopur për të arritur të pafundmen. Me teleskopin e tij ai kërkon që t’i tejkalojë përmasat e universit, ndërsa përmasat e tokës me tela dhe hekurudha. Me makinat e tij ai vendoset në pozicione të favorshme për të pushtuar natyrën. Ai përdor të menduarit historik për të nënshtruar të shkuarën dhe për ta integruar atë në ekzistencën e tij, e

⁸

Rënia e Perëndimit, II, fq. 165.

gjitha kjo nën etiketimin e “historisë botërore.” Me armët e tij me rreze të gjatë, ai kërkon që të nënshtrojë të gjithë planetin, përfshirë dhe mbetjet e të gjitha kulturave më të vjetra, duke i detyruar ato që t'i përputhen strukturës së tij të të jetuarit.

Ne kemi të drejtë të pyesim se dhe për sa kohë do të vazhdojë kjo përpjekje? Pas një numri të caktuar shekujsh secila kulturë transformohet në një qytetërim. Ajo çfarë dikur ka qenë e gjallë shndërrohet në të ngurtë dhe në të ftohtë. Shtrirja e mendjes dhe shpirtit zëvendësohet nga një lakmi për shtrirje dhe zgjerim drejt botës materiale. “Jeta,” në kuptimin e përdorur nga Meister Eckart, shndërrohet në “jetë” në kuptimin politik dhe ekonomik të fjalës; fuqia ushtarake e ideve bëhet imperializëm.

Një shenjë e fillimit të këtij transformimi është shpallja e idealeve përfundimtare por tejet tokësore; brenda kulturës fillon të zërë vend një etapë e pjekjes, e karakterizuar nga mosha dhe përvoja e duhur. Sokrati, Leo Ce, Rusoi dhe Buda, secili prej tyre paralajmëroi një kthesë në rënie në kulturat e tyre përkatëse.⁹ Që të gjithë këta mendimtarë, për së brendshmi janë që të gjithë të lidhur me njëri-tjetrin.

Asnjëri nuk zotëronte një metafizikë të vërtetë; secili prej tyre ishte ithtar i ideve praktike por përfundimtare dhe qëndrimeve të cilëve ne iu kemi veshur emërtime aq gjithëpërfshirëse si Budizëm, Stoicizëm apo socializëm.

⁹ Rënia e Perëndimit, I, fq. 351; II, fq. 305.

Socializmi pra, nuk është një instinkt me një origjinë të errët primitive si ato që gjejnë shprehje në stilin e katedraleve gotike, në pamjet madhështore të perandorëve dhe papëve të mëdhenj, apo në themelimin e Perandorive Spanjolle dhe Britanike. Përkundrazi, ai është një instinkt politik, shoqëror dhe ekonomik, i gjendur në popuj të vërtetë dhe të karakterizuar nga një natyrë realiste, dhe si i tillë është një produkt i një faze të qytetërimit tonë, por jo i kulturës sonë, e cila mori fund rreth viteve 1800. E megjithatë ky instinkt, i orientuar plotësisht drejt botës së jashtme, ende e ushqen vullnetin e vjetër faustian për pushtet dhe pafundësi; tani ai është shndërruar në vullnetin e tmerrshëm të dominimit absolut të botës në kuptimin ushtarak, ekonomik dhe intelektual të fjalës. Në faktin historik të Luftës Botërore dhe në konceptin e një revolucioni botëror, mund të ndihet ideja e skalitjes së turmave të shumta të njerëzimit në një të vetme. Imperializmi i Babilonisë kishte për qëllim vetëm kontrollin e Lindjes së Afërt, ndërsa ai i popullit indik ishte i kufizuar vetëm brenda territorit indian; imperializmi grek dhe romak kufizohej brenda Britanisë, Mesopotamisë dhe Saharasë, ndërsa Perandoria Kineze u shtri deri në Detin Kaspik. Imperializmi modern, nga ana tjetër, ka për qëllim që ta zotërojë të gjithë globin. Ne nuk njohim e pranojmë as kufij e as limite. Përmes një *Volkerwanderung*¹⁰ Amerikën ne e kemi bërë pjesë të Europës Perëndimore. Në çdo kontinent ne kemi ndërtuar llojin tonë të qyteteve dhe e kemi nënshtruar popullsinë qendrore duke i

¹⁰

Periudhe migrimi. (Shënim i përkthyesit)

imponuar mënyrën tonë të të jetuarit dhe menduarit. Një veprimtari e tillë është shprehja më e lartë e kuptimit tonë dinamik sa i përket pushtetit botëror. Ajo çfarë ne besojmë, çfarë ne dëshirojmë, është konceptuar që të jetë e imponueshme dhe e vlefshme për të gjithë. E duke qenë se jeta për ne nënkupton atë të jashtme, politike, shoqërore dhe ekonomike, gjithçka duhet t'i nënshtrohet idealit tonë politik shoqëror dhe ekonomik, përndryshe është e destinuar të shkatërrohet.

Kjo shtysë drejt dominimit universal është ajo çfarë unë e kam quajtur “socializëm modern.” Tani ne po bëhemi gjithnjë e më të vetëdijshëm rreth pranisë së tij. Kjo është ajo çfarë ne qytetarët e botës perëndimore kemi të përbashkët. Ajo është aktive në çdo qenie njerëzore nga Varshava në San Francisko dhe secili nga popujt tanë është i magjepsur nga magjia e premtimeve dhe potencialeve të saj. E megjithatë, ne jemi të vetmit popuj që bëjmë pjesë në të. Socializmi klasik, kinez apo rus, në këtë kuptim nuk ekziston.

E megjithatë, në themel të kësaj vetëdijeje të fuqishme kolektive, ekziston armiqësia dhe kontradikta e brendshme. E fshehur brenda shpirtit të pirtit të çdo kulture gjendet një çarje e pariparueshme. Historia e çdo kulture është një konflikt i përhershëm midis popujve, klasave, individëve apo tendencave brenda një individi – kemi të bëjmë pra gjithmonë me të njëjtin problem të tmerrshëm.

Sapo shfaqet një element historik, ai menjëherë shkakton shfaqjen e një tjetër elementi, kësaj radhe të kundërt me veten. Niçja ka identifikuar dikotominë e

madhe të jetës klasike, e cila shfaqet dhe rishfaqet në forma të ndryshme: Apoloni dhe Dionisi, stoikët dhe epikurianët, Sparta dhe Athina, senati dhe plebenjtë, tribunatët dhe patricët. Me Hanibalin në Kanae, Helenizmi Epikurian u rreshtua në kundërvënie me Romën e stoikëve dhe senatorëve. Në Filipi, elementi spartan i Romës u mund nga elementi athinas i personifikuar nga Çezari. Edhe te mëmëvrasja e Neronit ne mund të dallojmë triumfin e idesë dionisiake të *bukë dhe cirk*, mbi ndershmërinë apoloniane të grave romake.

Përgjatë të gjitha epokave të historisë kineze, në jetën dhe mendimin kinez, në betejat dhe librat e tyre, mund të perceptojmë antitezën që lidhet me emrat e Konfucit dhe Lao Ce-së, ashtu si dhe konceptet e papërkthyeshme të *li* dhe *tao*. Në mënyrë të ngjashme, është e njëjta ndarje e shpirtit faustian që ka formësuar fatin tonë përgjatë Gotikes dhe Rilindjes, Potsdamit dhe Versajës, Kantit dhe Rusoit, socializmit dhe anarkizmit, dhe që ka për ta vazhduar ta formësojë deri në ditët tona të fundit.

Por gjithsesi, ky Caktim është i bashkuar. Mosmarrëveshjet dhe antitezat i shërbejnë një realiteti superior. Epikurianizmi nuk është gjë tjetër përveçse një tjetër formë e Stoicizmit; Eskili i bëri bashkë Apolonin dhe Dionisin; Çezari i kombinoi senatin dhe plebenjtë; kurse Taoizmi i Leo Ce-së ndihmoi në krijimin e Kinës konfucianiste. Ndërsa popujt perëndimorë instinkti i të cilëve është anarkik, në vetvete janë vërtet socialistikë në kuptimin e gjerë faustian të fjalës.

III. Prusianët dhe anglezët

10

Tre popuj perëndimorë e kanë mishëruar socializmin në këtë kuptim të gjerë: Spanja, Anglia dhe Prusia. Firenzeja dhe Parisi ishin burimet e antitezës anarkiste ndaj socializmit: Italia dhe Franca. Konflikti midis këtyre dy qasjeve kundrejt jetës dhe botës formon skicën bazë të asaj që ne e quajmë histori moderne të botës. Shpirti gotik, me ngutinë e tij të jashtëzakonshme për t'i thyer dhe kapërcyer të gjithë kufijtë, u manifestua në figurat e perandorëve dhe papëve të mëdhenj, te Kryqëzatat, nëpër katedralet imponuese, në institucionin e kalorësisë dhe nëpër urdhrat fetarë. Në shekullin e pesëmbëdhjetë, shpirti i Firences lindi për t'iu kundërvënë këtij shpirti. Ajo çfarë ne e quajmë Rilindje¹¹ është parimi anti-gotik i kufizimit artistik dhe të menduarit e hijshëm.

Karakteristika të fokusit të saj të ngushtë janë moria e principatave grabitëse, republikave dhe *udhëheqësit* që lulëzuan në Italinë e kohës, ashtu siç janë dhe skemat politike oportuniste të reflektuara në veprën klasike të Makiavelit dhe modestia përmes së cilës edhe Vatikani zbatoi planet e tij për hegjemoni. Ajo ishte një protestë kundër thellësisë dhe gjerësisë së universalizmit faustian. Populli italian, si një lloj më vete, origjinën e tij e ka në Firence.

Shfaqja e dytë e elementit të kundërt ndodhi në Francë përgjatë *shekullit të madh*. Në të shohim Racinin

¹¹ Rënia e Perëndimit, I, fq. 232.

të cilit i vishet një rol artistik që është analog me atë të Rafaelit; *shpirti* i salloneve pariziane rimori atmosferën e pallatit Medici; politika e fiseve Borxhia dhe Sforca vazhdimësinë e saj e gjeti në luftrat lakmitare të Luigjit të XIV-të; dhe thënia e famshme e mbretit, “*Shteti jam unë*,” është një shprehje e idealit rilindas të personalitetit të lirë dhe mjeshtëror. Franca dhe Italia janë vërtet shtete dhe realitete të ngjashme.

Midis datës së lindjes së këtyre dy popujve, gjendet shekulli i jashtëzakonshëm spanjoll, që zanafillën e ka që nga Plaçkitja e Romës në vitin 1527, kur shpirti spanjoll pushtoi shpirtin e Rilindjes, deri në Traktatin e Pirenejve të vitit 1659, kur Spanja përfundimisht u detyrua që t’i dorëzohet epërsisë së Francës.¹² Ky episod shënoi lulëzimin e fundit të madh të parimit gotik. Madhështia kastiliane është e fundit që dëshmojmë nga kalorësit feudalë (Don Kishoti, Fausti spanjoll!).

Shoqëria e Jezusit është i fundit dhe ç’është e vërteta, i vetmi institucion që prej kur urdhrat kalorsiakë u themeluan si një armë kundër jobesimtarëve. Perandoria e themeluar nga Habsburgët spanjollë ishte realizimi i idealit të Hohenstaufenit, njësoj siç Këshilli i Trentos realizoi idealin e papatit.

Me lindjen e shpirtit gotiko-spanjoll të Barokut, nëpër botën perëndimore evropiane u përhap një stil i rëndë dhe impresionues jetese. Spanjollit ndjeu brenda vetes peshën e një misioni të madh, duke përjetuar jo një “ego” por një “id.” Ai ishte një ushtar ose një prift. I shërbente ose Zotit ose mbretit të tij. Në fakt, një ideal i

¹²

Rënia e Perëndimit, II, 388.

tillë i rreptë dhe nënshtrues nuk u përqaftua përsëri deri përpara lindjes së Prusisë. Në personazhin e Dukës së Albës, në këtë njeri të karakterizuar nga një sens i pakrahasueshëm detyre, prusianët duhet të kenë pikasur tipare të njohura për ta. Spanjollët dhe prusianët janë dy popujt e vetëm që u ngritën dhe luftuan kundër Napoleonit. Atë çfarë ne e quajmë shtet modern u krijua në Eskorial. Të gjitha teknikat e burrshtetësisë moderne origjinën e tyre e kanë në Madrid: politikat kombëtare dhe dinastike të shkallës së gjerë, diplomacia qeveritare, përdorimi i luftës si një lëvizje e qëllimshme dhe e përlllogaritur në lojën e ndërlikuar të shahut të strategjisë së madhe. Bismarku ishte burrshtetasi i fundit i stilit spanjoll.

Në Firence dhe në Paris, mosmarrëveshjet kufitare mjaftonin për të përmbushur nevojën e ngutshme për pushtime. Një herë Leibnici i sugjeroi Luigjit të XIV-të që ai t'i mësynte Egjiptit, por mbreti refuzoi. Për ekspeditën e tij Kolombi kërkoi ndihmë në të dy qytetet, por më kot.

Që prej asaj kohe, mendimi politik italian dhe francez është fokusuar në disa çështje të tilla si nënshtrimi i Pizës, sigurimi i kufirit të Rinit, reduktimi i territorit të vendit fqinj dhe poshtërimi i armikut. Sa të ndryshme që janë këto shqetësime të vockla krahasuar me ato të Spanjës perandorake! Shpirti spanjoll synonte të pushtonte tokën dhe të themelonte një perandori në të cilën dielli nuk do të perëndonte kurrë.

Gjithë sa na duhet është të krahasojmë *konkustadorët* spanjollë me *kondotierët* italianë. Ishin

spanjollët ata të cilët e konceptuan të gjithë globin si objekt të një planifikimi politik evropiano-perëndimor. Dhe është e rëndësishme të kuptojmë se konfliktin shpirtëror që shpuri në Plaçkitjen e Romës: ky veprim i dha fund Kishës së Rilindjes. Mendësia gotiko-spanjolle, që ka ndikim edhe në Vatikanin e ditëve tona, asokohe u ngrit kundër Kishës së Rilindjes dhe kishave ngushtësisht të lidhura me Reformacionin.

Që prej asokohe, ideja e dominimit botëror nuk është lënë asnjëherë mënjanë. Që prej nga ky moment e tutje, shpirti i popujve italianë dhe francezë ka mbetur armiqësor kundrejt Kishës, edhe pse më pak në cilësinë e një institucioni fetar sesa si mishërim i konceptit spanjoll të hegjemonisë universale.

Kjo shpjegon politikën fetare “gale” të ndjekur nga mbretërit francezë, nga Revolucioni, nga Napoleoni, ashtu si dhe nga qëndrimi anti klerikal i monarkisë italiane. Por megjithatë, Kisha gjeti mbështetje në Madrid dhe Vjenë.

Edhe Vjena, gjithashtu, është një krijim i shpirtit spanjoll. Gjuha nuk mjafton dot e vetme për ndërtimin e një populli. Në këtë shembull një popull, ai austriak, para së gjithash u krijua nga atmosfera e jetës së tij oborrtare, më pas nga kleri i tij dhe në fund nga fisnikëria. Në këtë proces ai është vetëtjetërsuar në mënyrë të pakthyeshme nga pjesa tjetër e gjermanëve, sepse një popull i karakterizuar nga rrënjë të thella historike nuk mund të ndryshojë kurrë, edhe pse herë pas here mund ta marrë në konsideratë që mund t’i nënshtrohet ndonjë ndryshimi të caktuar. Populli austriak është spanjoll dhe habsburgas

për nga natyra, pavarësisht faktit nëse gjenden apo jo në të pjesëtarë të familjes Habsburge. Mendimtarët austriakë mund ta mohojnë këtë, por instinkti austriak e konfirmon diçka të tillë. Gjermania spanjolle, e përfaqësuar nga Oborri Perandorak, u përball me disfatën e saj në vitin 1648, vit i cili shënoi triumfin e Gjermanisë franceze, thënë ndryshe, të morisë së princave individualë.

Që prej asaj kohe e këndej, këta princa zgjodhën të mendonin, të jetonin dhe të vepronin në përputhje me stilin e veçantë dhe provincial të Versajës, ndërsa ambiciet e tyre u kufizuan në zgjerime të vogla në drejtim të kufijve privatë, duke e bërë kështu veshin e shurdhër për plane më madhore pushtimesh. Kulminacioni i ambicies spanjolle u arrit kur Wallenstein propozoi marshimin drejt Kostandinopojës dhe transformimin e Detit Baltik në një bazë për flotën spanjolle. Tradhtia dhe rënia e tij shënuan momentin e ndryshimit të rrjedhës. Gjermania franko-spanjolle u mund të Konniggratz.

Madje edhe në vitin 1914, shpallja e luftës ndaj Serbisë nga ana e Austrisë ishte një lëvizje diplomatike e orkestruar në mënyrën e diplomacisë spanjolle të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Anglia, nga ana tjetër, përfshirjen e saj në Luftën Botërore nuk e shpalli në këtë mënyrë, por e nxiti shpërthimin e saj nëpërmjet disa teknikave taktikisht superiore, të zhvilluara gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Paqja angleze e Traktatit të Fontainablesë dhe Paqja Prusiane e Hubertusbergut, që të dyja të nënshkruara në

vitin 1763, shënuan fundin e shekullit të madh francez. Me rënien e latinëve, kontrolli i fateve të Evropës Perëndimore kaloi në duart e popujve gjermanikë. Lindja e kombit anglez modern ndodhi në shekullin e shtatëmbëdhjetë, ndërsa ai i kombit prusian në atë të tetëmbëdhjetë. Ata janë më të rinjtë dhe të fundit nga popujt perëndimorë. Të sapokrijuar nga njerëzillëku i panjollësuar, ata zotërojnë vullnetin faustian për pushtet dhe pafundësi në kuptimin e tij më të pastër të fjalës dhe në formën e tij më jetike. Krahasuar me ta, Franca dhe Italia duken vërtetë popuj të vegjël dhe epokat e tyre të suksesit politik duken si përjashtime të përkohshme të shfaqura në një dramë të madhe historike. Vetëm spanjollët, anglezët dhe prusianët i kanë dhënë qytetërimit evropian ide *universale*: ultramontanizmin, kapitalizmin dhe socializmin në një kuptim më të lartë krahasuar me atë që nënkuptohet nga përdorimi i sotëm i kësaj fjale.

E megjithatë, duhet të kuptojmë se rënia e Francës gjithashtu nënkuptonte edhe fundin e kulturës perëndimore. Parisi trashëgoi parimet krijuese të gotikes së hershme, Rilindjes italiane dhe barokut spanjoll, duke i kombinuar ato në formën e tyre përfundimtare, më të përsosur dhe më të ëmbël, në stilin rokoko. Ç'është e vërteta, kultura franceze është e *vetmja* kulturë. Anglia shënon fillimin e qytetërimit. Stili francez është një stil sjelljeje, intelektit dhe shijeje; ndërsa Anglia ka përsosur stilin e të jetuarit praktik, atë të parave.

Më duhet ta qartësoj se çfarë kam për qëllim me termin “prusianizëm.” Emri, sigurisht, i referohet një zone të Evropës në të cilën disa qëndrime të caktuara morën një formë impresionuese dhe filluan të zhvillohen. Por Prusianizmi, para së gjithash është një ndjenjë, një instinkt, një detyrë. Është mishërimi i tipareve shpirtërore dhe intelektuale – dhe këtu nuk përjashtojmë edhe ato cilësi të caktuara fizike – që prej kohësh janë shndërruar në karakteristikat dalluese të një race, apo më mirë ta themi, të atyre që janë më të mirët dhe përfaqësuesit më tipikë të saj.

Sigurisht që jo çdo njeri që ka lindur në angli është “anglez” në kuptimin racor të fjalës; dhe jo kushdo që ka lindur në Prusi është vërtet “prusian.” Kjo fjalë paraqet gjithçka që ne gjermanët zotërojmë nga fati, vullneti, nxitja e brendshme dhe aftësia jonë dhe nuk ka të bëjë aspak me idetë, dëshirat dhe tekat tona të vagullta. Në të gjithë Gjermaninë ekzistojnë lloje të vërtetë prusianësh dhe këtu kam parasysh njerëz si Fridrih List dhe Hegel, ashtu si dhe shpikës, dijetarë, inxhinierë dhe organizatorë, por veçanërisht një lloj të posaçëm të punëtorit gjerman.

Që nga Beteja e Rosbahut dhe Leutenit, ka pasur shumë gjermanë që në thellësinë e shpirtit të tyre kanë fshehur sforcim të vogël të Prusianizmit, një burim potencial energjie që mund të shndërrohet në aktiv në momentet e mëdha të historisë. E megjithatë, arritjet e vetme prusiane kanë qenë krijimet e Frederik Vilhelmit

të I-rë dhe Frederikut të Madh: që do të thotë, shteti dhe populli prusian.

Çdo realitet suprem lind realitete të mëvonshme. Elementi prusian përsëri është duke u ndjerë te gjermanët e sotëm apo më mirë të themi, në llojin e sotëm gjerman; në mënyrë të përshkallëzuar ai sot po redukton efikasitetin e ideologjive të dala mode. Edhe pse gjermanët më të mirë nuk janë të vetëdijshëm rreth tij, Prusianizmi, me kombinimin që i bën realizmit, disiplinës, energjisë dhe *ndjenjës së grupit*, është një premtim i madh për të ardhmen. Për momentin, populli gjerman, madje çdo individ gjerman, është i kërcënuar nga ajo çfarë ne e kemi etiketuar si “German Michel” – si larmia e bindjeve të venitura, të cilat ne ende i besojmë si të mprehta, por që në të vërtetë janë të padobishme apo edhe të rrezikshme për qytetërimin perëndimor.

Koncepti i “gjermanëve” i përdorur në kuptimin idealistik nga profesorë dhe entuziastë, është një konstrukt artificial i bazuar në themelin e rremë të një gjuhe të përbashkët. Ai është jopolitik dhe jopraktik; një koncept i tillë nuk shpërfaq një “racë” në kuptimin e instinkteve që kanë një funksion përbashkësues në botën reale.

Kjo ide përbëhet nga mbetje të ngurtësuara që vijnë nga mendësia mesjetare gotike, së bashku me grupet e ngatërruara të shpirtrave përjetësisht femënorë. Lëvizja romantike në Gjermani, me politikën e saj ëndërrimtare të 1848-tës, i solli edhe një herë në qendër të vëmendjes këto tipare. Mbetjet gotike, të përziëra me pjesëza dhe

copëza të ideve angleze, përbëjnë bazën e të tilla bindjeve të parëndësishme si kozmopolitanizmi, miqësia ndërkombëtare dhe humanitarizmi universal. Në raste serioze, popujt janë nxitur për të tradhtuar nisur nga përfaqimi naiv i ideologjive të tilla, nga të kënduarit dhe të shkruarit rreth gjërave që shpata spanjolle dhe paraja angleze tashmë i kanë arritur.

Të tillë janë provincialistët e përhershëm, heronjtë mendjethjeshtë të *bildungsroman-it*¹³ gjerman, të cilët mund t'i nënshtrohen një mase të caktuar të zhvillimit të brendshëm, por që shfaqin një mungesë të jashtëzakonshme talenti kur vjen puna te gjërat e kësaj bote. Të tillë janë zotërinjtë e shëndoshë të klubeve tanë të boulingut, të tavernave të birrës dhe asambleve tona qeveritare, të cilët mungesën e tyre të aftësisë përpiqen ta justifikojnë duke akuzuar menaxhimin e dobët të departamenteve qeveritare.

Ata janë ata të cilët karakterizohen nga tendenca përgjumëse kundrejt liberalizmit anglez dhe armiqësisë së tij karshi shtetit, një ndjenjë kjo që i kënaq ata edhe pse janë të paditur rreth iniciativës së fortë të shfaqur nga qytetari i thjeshtë anglez në çështjet politike e të ngjashme me to. Ata bashkëndajnë pëlqimin mendjengushtë të italianëve dhe francezë rreth vogëlsisë

¹³ Bildungsroman është një tipologji e zhanrit të romanit, e cila kryesisht trajton rininë apo vitet e formimit të personazhit kryesor. Themeluesit e këtij lloji romani janë autorët gjermanë. Në gjuhën shqipe janë të botuar së paku tre romane të tilla: “Loja e rruazave prej qelqi,” nga Herman Hesse; “Daulja e llamarintë,” nga Gunter Grass; “Vitet e formimit të Vilhelm Majsterit,” nga Wolfgang Göte. (Shënim i përkthyesit)

në politikë dhe refuzimin për ta ndjekur mendimin politik përtej kufijve të fqinjëve të ngushtë. Rendingun ata e shohin si armiqësor ndaj kulturës, e megjithatë janë treguar të paafhtë për ta kuptuar shpirtin e kulturës të cilën e lavdërojnë aq shumë.

Në të njëjtën kohë ata janë mbrojtësit më të çiltër të autoritetit kishtar të stilit spanjoll, i cili nuk bën gjë tjetër përveçse sektet e ndryshme fetare i fut në grindje me njëri-tjetrin.

Të këtillë pra, janë “gjermanët tanë tipikë:” jopraktikë, servilë, budallenj por të ndershëm, njerëz të paformë dhe pa ndonjë premisë përmirësimi, të dalë mode, mendjevegjël, të lodhshëm dhe degradues. Ata janë armiku i brendshëm i çdo gjermani të vërtetë, si një individ dhe i të gjithë gjermanëve si një komb. Së bashku ata përfaqësojnë “Michelin gjerman” të pesë personifikimeve “tipike” të popujve krijues modernë, i cili konsiston në të vetmin personifikim negativ. Ata përfaqësojnë një formë të njerëzimit gotik që i ka rezistuar përpjekjeve të kulturës së post-Rilindjes dhe post-Reformacionit, për të krijuar një racë në kuptimin e ri të termit.

Kolonizimi i organizuar i frontit sllavik përfshiu të gjitha fiset gjermane, por zona u sundua nga fisniket e Saksonisë së Ulët. Kësisoj populli prusian, për nga origjina, është ngushtësisht i lidhur me atë anglez. Ishin të njëjtët saksonë, frizianë dhe anglë të cilët, si banda lëvizëse dhe shpesh nën emrat normanë dhe danezë, nënshtruan britonët keltë.

Vendbanimet saksone u përhapën nëpër brigjet e Tamizit njësoj siç ishin përhapur në rajonin thuajse shkretinor pranë lumenjve Havel dhe Sprej, një shtrirje toke kjo që për nga zgjerimi i shkretuar dhe rëndësia vendimtare është e krahasueshme vetëm me Latiumin, Kampanjën romane.

Duke studiuar figurat e ngurta të Dukës Vidukind, Margrave Gero dhe Henri Zemërluani, mund të krijojmë një përshtypje të llojit të njerëzve që e vendosën këtë popull në rrugën e tij të Caktimit.

Por shpirti viking dhe ai shoqëror i kalorësve teutonikë gradualisht i hapi shtegun lindjes së dy imperativave të përkundërt etikë. Njëra palë brenda vetes mbante të gjallë idenë gjermanike, ndërsa tjetra e ndjente veten të nënshtruar prej saj: që do të thotë, se në njërën anë kishim pavarësinë personale, ndërsa në anën tjetër shpirtin përtej personal të bashkësisë. Këtyre koncepteve ne sot i referohemi si “individualizëm” dhe “socializëm.”

Në këto dy fjalë janë përmbledhur virtyte të llojeve më të shkëlqyera: në rastin e parë kemi përgjegjësinë personale, vetëbesimin, vendosmërinë dhe iniciativën;

ndërsa në tjetrën shohim besnikërinë, disiplinën, vetëmohimin dhe ndjenjën e detyrës. Të jesh i lirë dhe të shërbesh – nuk ka asgjë më të vështirë sesa kjo. Një popull shpirti dhe qenia e të cilit janë të aftë për të, një komb që vërtet mund të shërbejë dhe të jetë i lirë, meriton që të marrë mbi supe një caktim të madh.

Shërbimi – ky është stili i Prusisë së Vjetër, i ngjashëm me atë të Spanjës së Vjetër, i cili gjithashtu krijoi një popull duke e përfshirë atë nëpër luftra kalorsiake kundër paganëve. Jo “unë” por “ne” – një ndjenjë bashkësie kjo për të cilën çdo individ e sakrifikon të gjithë qenien e tij. Individit nuk ka asnjë rëndësi; gjithë sa ai duhet të bëjë është t’i ofrohet së tërës.

Gjithçka ekziston për gjithçka dhe çdo gjë i përket asaj lirie të brendshme të lavdishme, asaj që quhet *libertas oboe dientiae* dhe që gjithmonë ka nxjerrë në pah shembujt më të mirë të llojit prusian. Ushtrinë prusiane, shërbimin civil prusian dhe brigadat e punëtorëve të August bebelit, janë që të gjitha produkte të këtij parimi lloji.

Por megjithatë, nxitja për individualitet dhe pavarësi, shumë prej atyre me gjak viginku në venat e tyre, si për shembull anglezët, gjermanët dhe skandinavët, i shtyu që pasuritë e tyre t’i kërkonin nëpër stepat amerikane.

Në fakt, kjo aventurë ishte një vazhdim i ekspeditave të nisura nga Groenlanda që nga koha e *Eddave*, kur vikingët arritën të shkonin deri në brigjet kanadeze; një migrim i jashtëzakonshëm i teutonëve, i

karakterizuar nga nevoja e madhe për distanca të gjata dhe zgjerime të pakufijshme, të synuara nga skuadra aventurierësh të cilët do të hidhnin themelet e do të hapnin shtegun për ndërtimin e një tjetër populli me karakteristika saksone.

E megjithatë, ky popull i ri do të lindte nga toka mëmë e kulturës faustiane, duke i munguar kësisoj “përbërja e brendshme” rreth të cilës Gëte flet në poemën e tij me titull “Amerika.” Ai ruajti disa raca me gjak fisnik dhe virtytet shoqëruese të fuqisë dhe zellshmërisë, por ishte pa rrënjë e për rrjedhojë pa një të ardhme.

E këtillë ishte origjina e llojeve angleze dhe prusiane. Diferenca midis tyre është ajo midis një populli shpirti i të cilit është zhvilluar nga vetëdija e sigurisë ishullore dhe një tjetri që ka qenë i detyruar të mbajë një zonë të ndërmjetme pa kufij natyrorë për ta ruajtur atë nga armiqtë. Në Angli, “izolimi i shkëlqyer” zëvendësoi shtetin e organizuar.

Një komb i pashtet ishte i mundshëm vetëm nën këto kushte; izolimi ishte përbërësi i nevojshëm për zhvillimin e shpirtit të Anglisë moderne, një shpirt që për herë të parë sigurinë e plotë e fitoi në shekullin e shtatëmbëdhjetë, kur anglezët u bënë padronët e padiskutueshëm të ishullit të tyre.

Ky është rasti i një topografie krijuese: populli anglez e formësoi dhe e ndërtoi veten e tij, ndërsa ai prusian u formësua në shekullin e tetëmbëdhjetë nga oborri i Hohenzollernëve, të cilët sollën me vete përvojën kufitare të Evropës Qendrore dhe që për

rrjedhojë ishin shndërruar në përkrahës të shtetit të organizuar.

Si njësi të vërteta politike, si shtete dhe joshtete, Prusia dhe Anglia mishërojnë funksionimin maksimal dhe minimal të parimit socialistik mbipersonal. “Shteti” liberal anglez është tërësisht i pakuptueshëm; ai nuk ka as edhe një pretendim të vetëm për qytetarin dhe as nuk e koncepton atë si një element kuptimplotë të sistemit politik. Ai i shërben atij në mënyrë ekskluzive duke e konsideruar si një mjet drejt një qëllimi.

Gjatë shekullit midis Vaterlosë dhe Luftës Botërore, Anglia jetoj pa një arsimim të detyrueshëm, pa një shërbim të detyrueshëm ushtarak dhe pa një siguri të detyrueshme shoqërore, nisur nga antipatia e qartë që ushqente karshi këtyre privilegjeve negative. Armiqësia e anglezëve kundrejt organizimit të centralizuar është mjeshtërisht e shprehur në fjalën e tyre “society” (shoqëri), e cila në të menduarit e tyre ka zëvendësuar konceptin ideal të “shtetit.”

Në iluminizmin francez koncepti në fjalë hyri përmes termit *societe*, ndërsa Monteskjeja mendonte kështu: “*Des societes de vingt a trente millions d’hommes – ce sont des montres dans la nature.*” (Disa shoqëri që përbëhen nga njëzet apo tridhjetë milion banorë janë treguese në natyrë.)

Kjo ishte një ide anarkike franceze, por e formuluar sipas botëkuptimit britanik. Rusoi, siç dihet mirë, këtë fjalë e përdori për të fshehur urrejtjen që kishte për rregullat dhe urdhrat që vinin nga autoriteti; kurse Karl Marksi, struktura e mendimit të të cilit ishte gjithashtu

kryesisht angleze, thjesht e ndoqi atë. Lessingu, si një përfaqësues i *Aufklärung* (Iluminizmit), përdori termin *Menschengeschlecht* për të përçuar kuptimin e “shoqërisë njerëzore.” Gëtja, Shileri dhe Herderi preferuan fjalën *Gesellschaft*, e cila më vonë u shndërrua në shprehjen e parapëlqyer të liberalëve gjermanë, që e përdorën atë për të fshirë nga mendja e tyre idenë më fisnike por më kërkuese të *Staat*.

Anglia e braktisi përgjithmonë parimin e shtetit të organizuar, por e zëvendësoi atë me konceptin e qytetarit të lirë. Qytetari kërkon leje që të luftojë i vetëm në luftën e pamëshirshme për ekzistencë dhe kjo është e vetmja mënyrë përmes së cilës ai mund të kënaqë instinktet e tij vikinge. Buckle, Maltusi dhe Darvini, më pas dolën me përkufizimin se thelbi elementar i “shoqërisë” ishte lufta e hapur për ekzistencë.

Dhe kishin plotësisht të drejtë, së paku sa i përket vendit dhe popullit të tyre. Për të qenë sa më të saktë, në Anglinë moderne ky parim vepron në një mënyrë shumë të rafinuar dhe të përsosur. Por të dhënat për një përdorim më sipërfaqësor të tij mund të gjenden në sagat isllandeze, ku një sjellje e tillë është dukshëm spontane dhe jo e huazuar nga një tjetër kulturë. Forcat me të cilat Uilliam Pushtuese mori Anglinë në vitin 1066 mund të quhen një “shoqëri” e aventurierëve kalorës.

Po ashtu, kompanitë tregtare angleze kanë nënshtruar dhe shpronësuar shtete të tëra, ku si të fundit prej tyre, që prej 1890-tës, mund të përmendim hapësirat tokësore të Afrikës së Jugut. Në mënyrë të përshkallëzuar, i gjithë kombi anglez mori karakteristikat

e një “shoqërie.” Instinkti i vjetër nors për pirateri dhe tregti të mprehtë, tek e fundit, ka ndikuar në qëndrimin e anglezëve karshi të gjithë realitetit, përfshirë këtu pronën, punën, popujt e huaj dhe individët dhe klasat më të dobta shoqërore të vetë shoqërisë së tyre. I njëjti instinkt po ashtu ka prodhuar teknika politike që janë armët jashtëzakonisht efikase në luftën për zotërimin e globit.

Një koncept plotësues i konceptit të “shoqërisë” është “qytetari privat.” Ai përfaqëson shumën e disa cilësive etike pozitive, të cilat si të gjitha virtytet e mëdha etike nuk përftohen përmes trajnimit apo edukimit, por janë të lindura dhe përsosen me kalimin e brezave. Stili i veçantë anglez i politikës, në thelb është ai që përfshin qytetarë privatë apo grupe të përbëra nga të tillë individë.

Ky dhe vetëm ky është kuptimi i vërtetë i qeverisë parlamentare. Cecil Rhodes ishte një qytetar privat që pushtoi shtete të huaja. Miliarderët amerikanë janë qytetarë privatë që sundojnë shtete të huaja përmes një klase inferiore politikanësh profesionistë. Liberalizmi gjerman, nga ana tjetër, nga pikëpamja etike është i pavlerë. Shtetit ai thjesht i thotë “Jo!” dhe është i paaftë ta justifikojnë kundërshtinë e tij duke ofruar një sugjerim barazvlefshmërisht superior dhe energjik.

Nga qëndrimet politike që mbizotërojnë sot në Gjermani, vetëm socializmi ka fuqinë e vlerës së brendshme dhe integritetit. Liberalizmi është për mendjecektit, për ata të cilëve u pëlqen të flasin shumë për gjëra që nuk mund t’i arrijnë kurrë. Kjo është mënyra

se si ekzistojmë ne gjermanët; ne nuk mund të jemi kurrë si anglezët, maksimumi që mund të arrijmë është të jemi karikatura të tyre, gjë që e kemi arritur vërtet shpesh herë. Çdokush për veten: kjo është një ide angleze. Çdo njeri për këdo tjetër: kjo është mënyra prusiane. Por megjithatë,

Liberalizëm do të thotë “shteti për veten dhe çdo njeri për veten e tij.” Kjo është një formulë e pamundur për t’u ndjekur, me përjashtim të rasteve kur dikush dëshiron vërtet që të ndjekë rrjedhën liberale, që do të thotë të thuash një gjë duke u vendosur në kundërvënie të plotë ndaj të kundërtës së saj, por që në fund lejon që triumfuesja të jetë pikërisht e kundërta.

Në Gjermani janë të pranishme disa fizolofi politike që janë jopopullore dhe të pavlera, por asnjëra nuk është e përçmuar aq sa pikëpamja liberale. Liberalizmi, në formën e tij gjermane, gjithmonë ka qenë i reshtuar në anën e sterilitetit mendor, në atë të paditurisë dhe mungesës së kuptimit të domosdoshmërive historike. Ai ka nënkuptuar paaftësinë për të bashkëpunuar me të tjerët apo për të bërë sakrificë për ta.

Pozicioni i tij gjithmonë ka qenë ai i një kritike tërësisht negative, edhe pse jo si një shprehje e një vullneti të paepur për ta ndryshuar shoqërinë – siç manifestohet nga socialistët e Babelit – por thjesht nisur nga dëshira për të qenë “të ndryshëm.” Nëse nga njëra anë liberalët tanë asnjëherë nuk kanë dështuar të përqafojnë ndonjë “pozicion,” nga ana tjetër atyre u ka munguar vitaliteti dhe disiplina e brendshme, besimi dhe fuqia qëllimplotë që janë tipare aq karakteristike të

formës angleze të liberalizmit. Në fakt, ato nuk janë asgjë tjetër përveçse pengesa në rrugëtimin tonë historik.

Që prej kohëve napoleonike, liberalizmi ka pushtuar mendjet e klasave tona të arsimuara. Pseudo-intelektualët (“filistinët kulturorë të Niçes) dhe dijetarët e kullave të fildishta, të izoluar nga bota reale nëpërmjet një barriere të përbërë nga një dituri abstrakte, kanë qenë mbrojtësit e tij më të patundur. Edhe historiani Mommsen, i cili e përsosi shkëlqyeshëm fushën e tij të vështirë diturore me një gjakftohtësi të vërtetë prusiane, në cilësinë e një antari të Asamblesë, përqafoi një qëndrim të pakuptueshëm në kundërvënje me politikën e Bismarkut. Një krahasim interesant mund të bëhet midis Mommsenit dhe përkthyesit dhe botuesit anglez të veprës së tij *Historia e Greqisë*, Xhorxh Grotit, i cili ishte një bankier dhe liberal.

Të karakterizuar nga një prodhimtari e ngjashme me atë të lepurit, shkrimtarët dhe profesorët tanë, kanë prodhuar libër pas libri dhe kanë konceptuar skemë pas skeme në të cilat konceptet angleze të qytetarit të lirë, personalitetit të lirë, popullit si sovran dhe ato të një njerëzimi universal, të lirë dhe progresiv, janë larguar nga realiteti i zyrave angleze të biznesit dhe janë zbuluar duke u ngritur lart në retë gjermane. Bismarku, të cilin në vitin 1880 Bruno Bauer e quajti një “imperialist socialist,” kishte disa gjëra interesante për të thënë rreth këtyre dijetarëve të cilët botën e librave të tyre e ngatërronin duke e marrë për botën e vërtetë. August Babeli tashmë e ka demonstruar instinktin e tij të pagabueshëm, duke i qortuar me vend akademikët që ishin bërë pjesë e partisë së tij. Ai e ndjeu instinktin anti-

prusian të intelektualëve gjermanë, i cili ishte duke e thërrmuar rendin dhe disiplinën e vendit të tij. Dhe koha vërtetoi që ai kishte të drejtë. Që nga vdekja e Bebelit, socialistët e “edukuar” e kanë plasaritur fuqinë e partisë dhe i kanë bashkuar forcat me liberalët tanë të “edukuar” të klasës së mesme. Së bashku, këto dy grupe tani janë duke vënë në skenën e Teatrit të Oborrit në Vejmar një rigjallërim të dramës ideologjike të Frankfurt Paulskirches, ku profesoret zhvillojnë biseda diturore rreth formulimit të një kushtetute të shkruar.

Në “izolimimin e tyre të shkëlqyer,” mbi bazën e instinktit të tyre etik, anglezët kanë arritur një bashkim, si të brendshëm ashtu dhe të jashtëm, të cilin nuk e ka arritur asnjë popull tjetër modern nga Evropa Perëndimore. Anglia ka prodhuar një formë unike të një shoqërie të respektueshme, një klasë “zonjash dhe zotërinjsh” të bashkuar mes tyre nga një sens i fortë interesi të përbashkët, ashtu si dhe nga struktura uniforme të menduarit, ndjenjash dhe sjelljeje.

Që prej vitit 1750, ky lloj i mrekullueshëm shoqërie ka qenë model për të gjithë qytetërimin modern, duke filluar para së gjithash me Francën. Moda artistike e njohur si “Perandori” shërbeu si një sfond për këtë mënyrë të jetuari. Në thelb ai ishte një formë praktike dhe e kufizuar e rokokosë dhe të gjithë mjedisin e kësaj shoqërie ai e ngopi me një shije elegante dhe të rafinuar. Lidhur me këtë, sot ne veçanërisht kemi parasysh mjeshtrit e portretit të qytetëruar, piktorët Thomas Gainsborough dhe Sir Joshua Reynolds.

Anglezët ishin të bashkuar nga një ndjenjë e përbashkët suksesi dhe fati të mirë, ndryshe nga prusianët, të cilët prekeshin nga ndjenja e sfidës dhe detyrës. Për anglezët mund të mendojmë si olimpiantët e botës së biznesit të ulur në një tryezë banketi, ose si vikingët të kthyer nga ekspeditat e largëta, por kurrsesi si kalorësit në betejë.

Krahas prejardhjes fisnike, pasuria është kushti madhor për t’u pranuar në grup; ajo është gjithashtu kriteri për t’u pozicionuar sa më lart në hierarkinë e

strukturës shoqërore të grupit. Pasuria është virtyti i parë i anglezit, është shenja e tij dalluese, qëllimi dhe ideali i tij. Sot, vetëm Anglia e zotëron atë që shumëkush mund ta quajë kulturë shoqërore, edhe pse nuk është se posedon ndonjë formë tjetër më filozofike të kulturës. Anglezët janë një popull të karakterizuar nga një cektësi e thellë; ndërsa ne gjermanët, në “tokën e poetëve dhe mendimtarëve,” shpesh herë shfaqim thjesht një thellësi sipërfaqësore.

Nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë një lloj gjerman apo prusian shoqërie e ngjashme me atë angleze. Një shoqëri e përbërë nga ego të ndara, së cilës i mungon patosi përbashkësues i qëllimit dhe synimit të përbashkët, ne gjithmonë na është dukur si diçka qesharake. Në imitimim të tyre të “klubit” dhe “banketit” anglez, individualistët dhe liberalët tanë gjermanë kanë shpikur *Verein-in*¹⁴ dhe *Festessen-in*;¹⁵ këto janë mjetet e tyre për zhvillimin e “solidaritetit kulturor.”

Stili prusian i të jetuarit ka prodhuar një vetëdije të thellë dhe energjike të rangut, një ndjenjë bashkimi bazuar mbi etosin e punës dhe jo të kohës së lirë. Ajo bashkon antarët e çdo grupi profesional – atë me natyrë ushtarake, shërbimin civil dhe punën e krahut – duke i mbushur me një krenari rreth profesionit të tyre, e duke iu dedikuar veprimtari që janë në dobi të të gjithë të tjerëve, tërësisë dhe shtetit. Një ndjenjë e tillë solidariteti brenda çdo grupi, shprehjen e saj simbolike e gjen

¹⁴ Një organizatë apo shoqatë shoqërore apo politike. (Shënim i përkthyesit)

¹⁵ Një darkë apo mbledhje formale miqësore, ku përveç bisedimeve shtrohet edhe një tryezë. (Shënim i përkthyesit)

përmes fjalëve: në nivelin e lartë janë *Shokët*, në atë të mesëm janë *Kolegët*, ndërsa poshtë, por të karakterizuar nga e njëjta krenari, *Antarët*. Lidhja përbashkësuese në të gjitha nivelet është një etos suprem përkushtimi dhe jo suksesi.

Tipari dallues i antarësisë është rangu dhe jo pasuria. Kapiteni është superior ndaj togerit, edhe pse ky i fundit mund të jetë një princ apo një milioner. Francezët gjatë Revolucionit përdorën termin “*borgjezi*” për të nënvizuar idealin e barazisë, por ai nuk i korrespondon as kuptimit anglez dhe as atij gjerman të distancës në marrëdhëniet shoqërore. Një ndjenjë për distancën është i përbashkët për të dy popujt gjermanikë; ajo ku ne dallojmë është origjina e kësaj ndjenje.

Kur një punëtor gjerman përdor fjalën “*borgjezi*” ai nënkupton një person i cili, në mendimin e vet, thjesht ka arritur një status të caktuar shoqëror pa kryer ndonjë punë të vërtetë – ky është ideali anglez i parë nga perspektiva gjermane. Anglia ka snobët e saj, ndërsa Gjermania tituj-kërkuesit.

Ndjenja shekullore e solidaritetit të grupit në të dy shekujt, ka shkaktuar një konformitet të mrekullueshëm të qëndrimeve fizike dhe mendore, në njërin rast një racë biznesmenësh të suksesshëm, në tjetrin një racë punëtorësh. Një simbol i rëndësishëm i këtij procesi, paçka se i jashtëm, është shija angleze që gjendet në veshjen e burrave.

Anglia ka prodhuar një veshje civile në kuptimin më të pastër të fjalës: uniformën e individit privat. Moda e tyre prodhon një ndikim të pakundërshtueshëm në të

gjithë Evropën Perëndimore. Anglia ka veshur të gjithë botën me uniformat e saj, gjë që është simbol i tregtisë së lirë, krijimit të pasurive private dhe “pamundësive.” E kundërta e këtij stili anglez është uniforma prusiane. Ajo është një emblemë e shërbimit publik dhe jo e ekzistencës private.

Në vend që të simbolizojë suksesin e fituar nga veprimtaria e zellshme, ajo simbolizon vetë veprimtarinë. “Unë jam shërbëtori i parë i shtetit tim,” tha mbreti prusian, i ati i të cilit veshjen e uniformave e kishte shndërruar në një praktikë të zakonshme në mesin e fisnikërisë. Sa prej nesh e kanë kuptuar domethënien e frazës “manteli i mbretit?”

Moda angleze në veshjen e meshkujve është një çështje detyrimi shoqëror, madje akoma dhe më e ngurtë sesa specifikimet për veshjen e uniformës në shtetin prusian.

Kushdo që në Angli është dikush, as nuk do ta shpinte nëpër mend që përpara shokëve të tij të shfaqej në një veshje “civile” që do të ishte në kundërshtim me modën dhe zakonin. Por vetëm anglezi është i aftë që të bëjë këtë paraqitje të duhur në këtë zakon “zotërinjsh.” *Bratenrock-u*¹⁶ i filistinit provincial gjerman është një kopje e varfër e anglezit model.

Nën të, zemra filistine gjermane vazhdon të rrahë për “liri” dhe “dinjitet njerëzor.” *Bratenrock-u* është simboli i idealeve të vitit 1848 dhe sot vishet plot krenari

¹⁶ Lloj fraku i veshur ne Gjermaninë e shekullit të nëntëmbëdhjetë. (Shënim i përkthyesit)

nga liberalët gjermanë që një herë e një kohë kanë qenë socialistë.¹⁷

Për mënyrën prusiane të të menduarit, vullneti i individit është i përfshirë te vullneti i totalitetit. Trupat e oficerëve, antarët e degëve të shërbimit civil, ushtria e punëtorëve e August Bebelit dhe së fundi *Populli gjerman* i 1813-shit, 1870-tës dhe 1914-tës, që të gjithë kanë ndjerë, dëshiruar dhe vepruar si një njësi mbipersonale. Ky nuk është thjesht instinkti i tufës; ai është një shprehje e fuqisë dhe lirisë sublime, diçka që i jashtëmi nuk mund ta kuptojë kurrë.

Prusianizmi është i jashtëzakonshëm. Edhe në formën e tij proletare, ai e refuzon bashkimin e punëtorëve të vendeve të tjera së bashku me pseudo-socializmin e tyre egoist. Servilizmi, snobizmi – këto janë fjalë për qëndrime të cilat kuptohen dhe përcmohen vetëm kur degjenerojnë. Prusiani i vërtetë nuk përcmon askënd; madje përkundrazi, është ai të cilit ia kanë frikën.

Anglezi, në të vërtetë e gjithë bota, nuk do ta kuptojë kurrë që etika prusiane bart në vetvete një pavarësi të brendshme të një thellësie të konsiderueshme. Për njerëz të karakterizuar nga aftësi të mjaftueshme mendore, një sistem detyrimesh shoqërore garanton një liri supreme të jetës së brendshme, e cila nuk është e mundshme nën një sistem privilegjesh shoqërore. Një

¹⁷ Francezi, që prirjet faustiane i konsideron si të sikletshme, vëmendjen e tij kreative ia përkushton modës së grave dhe jo uniformave të profesionit dhe suksesit. Në Francë, biznesit dhe detyrimeve civile, iu është dashur që t'i hapin rrugë *dashurisë*.

mendësi si ajo e gjeneral Moltkes është e pakonceptueshme në Angli. Për lirinë e tij *praktike* anglezi paguan me humbjen e një tjetër lloj lirie; për së brendshmi ai është një skllav, qoftë në cilësinë e puritanit, racionalistit, sensualistit apo materialistit. Tashmë janë bërë dy shekuj që ai është shpikësi i të gjitha filozofive që kanë të bëjnë me pavarësinë e brendshme. Më së fundmi ai ka prodhuar Darwinizmin, sipas të cilit e gjithë përbërja fizike e njeriut është në varësi të forcave materiale. Në mënyrë aksidentale, forma veçanërisht e pagdhendur e Darwinizmit e përhapur nga Buchneri dhe Heckeli, është shndërruar në *Botëkuptimin* e filistinit gjerman.

“Shoqërisë” së tij anglezi i përket edhe në kuptimin shpirtëror. Veshja e tij është gjithashtu shprehje e ndërgjegjes së tij të uniformëzuar. Ai e përshëndet dhe i gëzohet të drejtës së tij për të vepruar si një qytetar privat, e megjithatë për të nuk ekziston diçka e tillë si të menduarit privat. Jeta e tij është e drejtuar nga një filozofi e përbashkuar dhe teologjikisht e orientuar nga një përmbajtje vërtet e paktë reale, që është në modë sa janë edhe palltoja dhe dorashkat. Termi “instinkti i tufës” këtu është me vend të përdoret më shumë se kudo tjetër.

Revolucioni Gjerman nuk ka pasur pasoja të brendshme. Luteranizmi ishte një qëllim dhe jo një fillim.¹⁸ Gjermania gotike ishte në prag-vdekjen e saj, por u ngrit edhe një herë tjetër për të kryer këtë akt madhështor dhe personal.

Vetë Luteri mund të kuptohet vetëm në kontekstin e klimës së Rilindjes që mbizotëroi në Kishën e dukshme të kohës së tij. Imazhi i tij publik ishte ai i oborrit të Medičëve; papët dhe kardinalët në të vërtetë ishin *prijës*; administrata kishtarë në mënyrë sistematike i plaçkiste pasuritë private të besimtarëve; besimi fetar në vetvete ishte një çështje formale dhe përpjesëtimi i pendesës me mëkatin ishte shndërruar në një çështje shijeje, njësoj si marrëdhënia midis kolonës dhe arkitraut.

Ndjeshmëria veriore gotike reagoi me zemëratë ndaj këtyre zhvillimeve, por revolta që pasoi, në të vërtetë ishte naëve dhe fshatareske; ajo prodhoi një Kishë pa papatin dhe besimin gotik pa theksin e zgjuar të vendosur mbi formalitetet. Ajo u ndal në bërthamën më të thellë të fuqisë institucionale të Kishës. Revolta u ngrit nga shpirti i mohimit; pasioni i saj frytdhënës nuk mund të zgjaste dhe për shumë gjatë.

Në gjirin e saj u ngjiz shpirti lulëzues i Barokut, kur spanjollët krijuan Kundër-Reformacionin dhe Urdhrin polemik Jezuit. Kjo ishte një lëvizje vërtet krijuese dhe pohuese, e cila e shpuri Katolicizmin në maja të reja të një fuqie jetike. Në pasim të saj, në shekullin e

¹⁸

Rënia e Perëndimit, II, fq. 296.

shtatëmbëdhjetë, kombet e reja veriore nisën të krijonin forma të reja të jetës fetare, duke përdorur mundësitë e panumërta të ofruara nga Krishtërimi.

E përbashkëta e të gjitha këtyre përpjekjeve ishte vullneti rigoroz për të vepruar, një thirrje e fuqishme për të dalë nga kultura e mëngeshme fiorentine dhe dialektika sterile dhe vetëndëshkuese e Paskalit dhe jansenistëve francezë.

Rezultatët ishin Pavarësia revolucionare në Angli dhe, nën ndikimin e saj, lëvizja pietiste në Svabi dhe Prusi. Pietizmi, me bindshmërinë e tij të heshtur, pati një efekt të jashtëzakonshëm mbi llojin prusian, i cili nisi të shfaqej në kohën që flasim.

Ai ndihmoi të kultivoheshin individë të cilët, për së jashtmi, kryen një shërbim të përkushtuar dhe vetëmohues ndaj shtetit të tyre, por që në të njëjtën kohë jeta e brendshme e të cilëve ishte e çliruar nga kufizimet e imponuara nga ekzistenca e kësaj bote – njerëz këta me një tepri të thellë butësie dhe emocioni, ashtu si dhe me një thjeshtësi të brendshme origjinale. Mbretëresha Luizë, Uilljami i I-rë, Bismarku, Moltke dhe Hindenburgu janë shembujt më të mirë të këtij lloji, persona devotshmëria e të cilëve praktikisht ka qenë e çliruar nga dogma.

Ata e kanë fshehur atë nga të tjerët, duke ndjerë se ajo më së miri është e ilustruar nga veprimi publik në krye të detyrës dhe jo nga deklaratat publike.

Anglezi i pavarur, nga ana tjetër, për së jashtmi ishte i lirë në të njëjtën mënyrë që kishin qenë të lirë edhe

paraardhësit e tij normanë. Për veten e tij ai modeloi një fe të thjeshtë laike, duke përdorur Biblen themel dhe duke i siguruar çdo individ privilegjin e interpretimit të tekstit sipas dëshirës së tij. Prandaj, çfarëdo gjëje që i Pavaruri ndërmerre, ishte për definicion moralisht korrekte. Anglezi asnjëherë nuk ka dyshuar në vërtetësinë e kësaj. Suksesi është një provë e Providencës Hyjnore. Nëse Pietisti e konsideronte veten si përgjegjës të vetëm moral për veprimet e tij, i Pavaruri këtë përgjegjësi ia vishte Zotit. Askush nuk e ka fuqinë për t'i ndryshuar këto bindje të thella. Racionalizimet mundet gjithmonë të sajohen për dëshira kompulsive dhe nëse kompulsiviteti shpie në kalbëzim dhe rënie, kjo është thjesht pashmangshmëria e fatit.

Me një vetësiguri vërtet të jashtëzakonshme, instinkti i anglezëve formoi vetëdijën e tij fetare, mbështetur në mësimet sterile, doktrinare, formalistike e kësajsoj tipikisht franceze të Kalvinit.

Në mesin e Kromuellit dhe ushtarëve të tij, doktrina e paracaktimit donte të thoshte se kombi ishte Bashkësia e Shenjtorëve dhe kombi anglez në veçanti ishte Populli i Zgjedhur.

Përpara Zotit çdo veprim ishte i justifikuar sepse ai ishte i mundshëm për t'u kryer; çdo faj, çdo brutalitet, madje çdo krim i kryer në rrugën e suksesit ishte “i paracaktuar nga Zoti” dhe kësajsoj Ai ishte i vetmi përgjegjës. Mbështetur mbi këtë vetësiguri dhe pamëshirshmëri të pakufijshme, Anglia është bërë kombi madhështor që është.

Edhe pse Pietizmi ndikimin e tij më të fuqishëm e ushtroi në zonat gjermanisht-folëse të Evropës, nuk mund ta themi dot se ishte një shprehje e drejtëpërdrejtë e racës gjermane. Në mënyrë përfundimtare ai karakterizohej nga tipare jopraktike dhe provinciale. Ajo çfarë ai bëri ishte që bashkoi qarqe të vogla besimtarësh përreth një shpirti afrimiteti të ngushtë. Për ta jeta u shndërrua në një ideal të shërbimit; ekzistenca e varfër tokësore në mes të mundimeve dhe mjerimit, merrte kuptim vetëm nëse kanalizohet në kornizën e ndonjë detyre të lartë.

E megjithatë, një detyrë e tillë duhej të imponohej dhe kjo ishte arritja e shkëlqyer, pjesërisht e vullnetshme e pjesërisht e paqëllimshme, e derës së madhe të Hohenzollernëve, të cilët ishin trashëgimtarët e idealit kalorsiak të kolonive të Evropës Lindore.

Nga mesi i të gjitha të metave të egotizmit princëror dhe urban, nga themelet e dobësisë mbretërore, u shfaq ideja e Prusisë së Vjetër, ajo ide madhështore që në Gjermani ka gjetur hapësira dhe ka përparuar në mënyrë të vazhdueshme. Që prej asaj kohe ajo ka fituar një vend në shpirtat e gjermanëve më të mirë, madje edhe kur zemrat e tyre kanë qenë të rreshtuara kundër saj.

Pietizmi i Svabisë praktikisht degjeneroi në një ndjeshmëri të klasës së mesme, apo hoqi dorë nga mendjet e tij më të mira – nga Hegeli, për shembull – në avantazh të Veriut, ku ideali i vjetër prusian mundësoi formimin e një lloji të ri, ithtarit e sprovuar të kësaj ndjeshmërie fetare. Shpirtin prusian të këtyre shekujve e karakterizon një përçmim i thellë ndaj pasurisë, luksit,

komoditetit dhe prosperitetit të zhveshur nga vlerat morale. Që të gjitha këto lehtësi janë të papërputhshme me kuptimin kalorsiak të dinjitetit dhe ndjenjës së detyrës. Por për anglezët ato janë dhurata të Zotit; për ta, komoditeti është provë e Providencës Hyjnore dhe atë ata e pranojnë me një mirënjohje të devotshme.

Vështirë se mund të përfytyrojmë një kontrast më të rreptë. Puna, për të Pavarurin e devotshëm, është rrjedhojë e Rënies; ndërsa prusiani atë e sheh si një Urdhëresë Hyjnore. Dy interpretime të natyrës së punës këtu na vijnë në kundërshtim me njëra-tjetrën: puna si biznes dhe si vokacion. Le të meditojmë pak rreth kuptimit të këtyre fjalëve. “Vokacion” do të thotë “thirrje”: një thirrje për te vetë Zoti.

Sipas këtij këndvështrimi, puna në vetvete është moralisht e mirë. Për anglezët dhe amerikanët, sukseesi moral është i përfshirë te *qëllimi* i punës, te sukseesi, paratë dhe pasuria. Puna është thjesht një udhë drejt përmbushjes së këtyre qëllimeve, që duhet ndjekur me një konsideratë të veçantë, për rehatinë dhe sigurinë që ofron.

Është e pashmangshme që në rrugën drejt suksesit konflikti është i pashmangshëm, por ndërgjegjja puritane mund të justifikojë çdo mjet të përdorur. Kushdo që të pengon rrugën drejt suksesit, duhet thjesht të të bëjë rrugë, përfshirë individët, klasa dhe kombe të tërë.

Tek e fundit, ky është vetë vullneti i Zotit. Është e lehtë të shohim se si ideale të tilla, pasi zbatohen në jetën reale, mund ta shpjerë vërtet një komb në majat e tij më të larta të arritjeve.

Në mënyrë që ta tejkalojë letargjinë e lindur të njeriut, etika socialiste prusiane përqafoi bindjen se qëllimi i jetës nuk është lumturia. Slogani i saj është: “Përmbushe detyrën duke kryer punën tënde.” Ndërsa etika kapitaliste angleze mëton: “Pasurohu sepse kështu nuk do të të duhet të punosh më.” Nuk ka dyshim se në këtë moton e dytë gjendet diçka provokuese. Ajo është joshëse, ngase i bën thirrje instinkteve më të ulta njerëzore.

Masat punëtore të kombeve ambicioze e kanë kuptuar mirë atë. Deri vonë në shekullin e nëntëmbëdhjetë ajo prodhoi llojin Yankee,¹⁹ i karakterizuar nga optimizmi i tij i papërballueshëm praktik. Ndërsa motoja tjetër është kërcënuese. Ajo është për ata të paktë të cilët dëshirojnë ta injektojnë atë në bashkësi dhe kësisoj, t’ia imponojnë masave. Maksima e parë është për një vend të pashtet, për egoistët dhe llojet vikinge, të karakterizuar nga nevoja e lartë për dyluftime të vazhdueshme personale, si ato që i hasim në natyrën e sporteve angleze.

Ajo nënkupton pavarësi ekstreme të mendjes, të drejtën për ta arritur lumturinë në kurriz të të gjithë të tjerëve, për aq kohë sa fuqia që zotëron ta mundëson këtë – me fjalë të tjera, Darwinizëm shkencor. Ndërsa maksima tjetër, është shprehje e idesë socialiste në të gjithë thellësinë e saj: vullneti për pushtet dhe lufta për lumturi, por për lumturinë e tërësisë, për lumturinë e të

¹⁹ Term që në historinë dhe kulturën gjuhësore angleze emërton banorët vendas të Anglisë së Re në përgjithësi dhe të Shteteve të Jugut në veçanti, të cilat kishin përqafular një tjetër frymë nga trembëdhjetë kolonitë e veriut. (Shënim i përkthyesit)

gjithëve dhe jo të individit. Në këtë kuptim, socialisti i parë i vetëdijshëm ka qenë Frederik Vilhelmi i I-rë dhe jo Marksi. Lëvizja socialiste universale zanafillat e saj i ka pikërisht me këtë personalitet shembullor. Kanti, me imperativin e tij kategorik, lëvizjen në fjalë e pajisi edhe me një formulë.

Në fazën përfundimtare të kulturës perëndimore evropiane, ishin të pranishme dy shkolla të mëdha filozofike, ajo angleze e egoizmit dhe e sensualizmit e viteve 1700 dhe shkolla prusiane e idealizmit e viteve 1800. Ato shprehin çfarë këto kombe janë, si njësi etike, fetare, politike dhe ekonomike. Filozofia në vetvete nuk është asgjë; ajo është një grumbull fjalësh, një seri librash. Në vetvete, ajo nuk është as e vërtetë as e rreme. Ajo është gjuha e jetës së një mendjeje të madhe. Për anglezin, Hobsi është duke thënë të vërtetën kur ai ngre “sistemin egoist” dhe filozofinë optimiste vige të së mirës së përbashkët (“lumturia më e madhe për numrin më të madh të njerëzve”). Por për anglezin edhe Shaftesbury, gjithashtu, flet të vërtetën, me portretin që i bën xhentëlmenit tor, personazhit sovran që e jeton jetën e tij në maksimum. E megjithatë, për ne Kanti është po aq i vërtetë në përbuzjen e tij ndaj “lumturisë” dhe dobisë, duke ngritur lart imperativin e tij kategorik të detyrës. Hegeli, në perspektivën tonë, me ndjeshmërinë e tij të fuqishme të realitetit, përcakton fatin konkret të kombeve individuale dhe jo mirëqenien e “shoqërisë njerëzore,” në qendrën e diskutimeve të tij historike. Mandevili, në veprën e tij *Fabula e bletëve*, deklaroi se egoizmi i individit është forca shtytëse e shtetit; ndërsa Fihte shprehej se ishte detyra për të punuar. Cili është qëllimi më i lartë: liria *përmes* pasurisë apo liria *nga*

pasuria? Si të sillemi pra, sipas imperativit kategorik të Kantit: “Sillu sikur pohimet morale që të drejtojnë ty të jenë të vlefshme dhe të përligjen për të gjithë;” apo duke përqafuar idenë e Bentamit: “Sillu në mënyrën që do të të garantojë suksesin”?

Vikingët dhe kalorësit – që të dy këta lloje ilustrojnë antitezën e sisteme morale angleze dhe prusiane. Mësimet filozofike që kanë dalë nga këto dy botë të veçanta ndjeshmërie, pasardhësit e filozofëve të të dy kombeve, që të gjithë bartin tiparet e tyre dalluese. Anglezi është një utilitarist, në të vërtetë është i vetmi i tillë në Evropën Perëndimore. Ai nuk mund të tjetër tjetër gjë dhe çdo herë që përpiket ta mohojë këtë shtysë të fortë të brendshme, rezultati është dukuria që është bërë e famshme si “cant”²⁰ dhe në formën e saj më të pastër mund të gjendet në letrat e Lordit Çesterfild. Anglezët janë një komb teologësh. Revolucioni i tyre i madh, para së gjithash mori një formë fetare dhe duke pasuar shfuqizimin e shtetit, përveç asaj teologjike, nuk ekzistonte asnjë gjuhë tjetër për të shprehur shqetësimet e jetës shoqërore. Dhe kështu ka ndodhur: një interpretim biblik i çështjeve të diskutueshme tregtare, mund ta lehtësojë ndërgjegjen dhe ta rrisë ndjeshëm ambicien dhe iniciativën. Nisur nga konsiderata për mundësitë për sukses në luftën personale për ekzistencë, mendësia teologjike, duke përdorur vetë emrin e saj, përpiket që ta fshehtë qëllimin e vërtetë të të gjithë veprimtarisë: pasurinë. Nëse në atmosferën prusiane ekziston një konflikt i ngjashëm me këtë, atëherë është ai

²⁰ Ligjërim hipokrit i një natyre morale, fetare apo politike. (Shënim i përkthyesit)

që ka të bëjë me pozicionin dhe rangun. Në shumë raste shumëkush joshet që ta quajë atë ambicie dhe kërkim titulli. Por megjithatë, në parim, ai është një manifestim i vullnetit për të marrë mbi supe një përgjegjësi më të madhe, nisur pikërisht nga ndjesia e gatishmërisë për të vepruar kështu.

Nga të gjithë popujt e Evropës Perëndimore, këta të dy dallohen mes tyre nga një hierarki e rreptë shoqërore. Kjo është një shenjë e prirjes së tyre për veprimtari dinamike. Kjo e fundit, çdo individ e vendos në vendin e caktuar në të cilin ai duhet më së shumti. Një përcaktim i tillë është rezultat i një konservimi të tërë të pavetëdijshëm dhe të pavullnetshëm energjish. Ai është një shprehje e qëndrimit themelor moral dhe etik të një populli.

Për kthjelltësimin dhe përmbushjen e kësaj ndjenje të veçantë në shërbim të strukturës shoqërore kërkohen shekuj të tërë. Shpirti viking dhe ai i kalorësve mesjetarë dalin në pah edhe këtu: në etosin e suksesit dhe atë të detyrës. Populli anglez është i strukturuar sipas linjave të pasurisë dhe varfërisë, ndërsa ai prusian sipas atyre të detyrës dhe bindjes.

Kësisoj, kuptimi i dallimeve klasore është tërësisht i ndryshëm në këta dy vende. Në një asociacion të qytetarëve të lirë privatë, klasa më e ulët është grupi që nuk zotëron asgjë; ndërsa në një shtet të vërtetë, grupi më i ulët është ai që nuk ka asgjë për të thënë.

Në Angli demokracia nënkupton mundësinë që kushdo mund të pasurohet; në Prusi nënkupton se rangjet ekzistuese janë të hapura për t'u ngjitur nga kushdo. Brenda strukturës së shoqërisë prusiane, individi vendin e tij e gjen në përputhje me aftësinë që zotëron dhe jo në varësi të kërkesave të traditës.

Franca (dhe kjo do të thotë që edhe Firenceja gjithashtu) asnjëherë nuk ka pasur një strukturë natyrale dhe instinktive klasore të këtij lloji, madje as përpara 1789-tës. Rregulli ishte anarkia shoqërore; në të ekzistonin grupe arbitrare privilegji të madhësive dhe përbërjeve të ndryshme, por jo një sistem i përcaktuar marrëdhëniesh midis tyre. Përveç klasës së fisnikërisë së oborrit, ekzistonte edhe ajo e fisnikëve gjyqësorë; kishte lloje si ata të *abatëve* dhe *mbështetësve të përgjithshëm*, ashtu si dhe dallime të qarta si ato midis fraksioneve të klasës urbane të tregtarëve.

Kjo mungesë e një strukture hierarkike shoqërore në Francë ekzistonte që nga fillimi dhe është rezultat i prirjes tipike franceze për *barazi*. Në Angli fisnikëria gradualisht arriti në pikën sa para së gjithash përfaqësonte fisnikërinë e pasurisë, ndërsa në Prusi fisnikërinë e arritjeve ushtarake.

Klasa fisnike franceze asnjëherë nuk ka arritur një uniformitet të tillë të domethënies shoqërore. Revolucioni Anglez u drejtua kundër shtetit, thënë ndryshe, kundër kuptimit “prusian” të rendit në Kishë dhe jetën publike. Revolucioni Gjerman luftoi kundër sistemit “anglez” të pasurisë dhe varfërisë, i cili origjinën e kishte në zhvillimet industriale dhe tregtare të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe ishte shndërruar në pikën fokale të tendencave anti-prusiane dhe antisocialiste.

Ndërsa Revolucioni Francez nuk u drejtua kundër rendit të huaj e për rrjedhojë të përhershëm; rendin ai e

luftoi si qëllim në vetvete. Kjo është demokracia sipas stilit francez.

Në këtë pikë, më në fund mund ta kuptojmë më mirë kuptimin e thellë etik të sloganeve “kapitalizëm” dhe “socializëm.” Ato përfaqësojnë dy sisteme të shtresëzimit shoqëror, ku njëri bazohet mbi pasurinë dhe në luftën e papërmbajtur për sukses, ndërsa tjetri është themeluar mbi autoritetin dhe legjislacionin. Anglezi asnjëherë nuk do të pranonte urdhra nga dikush që është më i varfër sesa ai dhe as prusiani nuk do t’i ngrinte kurrë lavde pasurisë si qëllim në vetvete.

E megjithatë, edhe punëtori i karakterizuar nga vetëdija klasore i partisë së dikurshme të August Bebelit, i bindej udhëheqësisë së partisë me të njëjtën siguri instinkti që punëtori anglez respekton milionerin si marrësi i favoreve hyjnore.

Konflikti i klasës proletare nuk e ka fuqinë për të ndikuar në këto qëndrime thellësisht të rrënjosura. E gjithë lëvizja punëtore angleze është e mbështetur mbi dallimin që ekziston midis të pasurve dhe të varfërve brenda vetë klasës punëtore. Nën kushte të tilla, është e pamundur të përfytyrojmë diçka të ngjashme me disiplinën e hekurt të një partie të stilit prusian të miliona njerëzve.

“Shpërndarja e pabarabartë e pasurisë” është formula proletare tipike e anglezëve, e përdorur në mënyrë të vazhdueshme nga Shou. Edhe pse ne ajo na duket qesharake, është ekzaktësisht e përshtatshme për idealin e jetesës së pretenduar nga vikingu i qytetëruar. Me gjithë respektin për lulëzimin e shkëlqyeshëm të këtij

ideali në llojin e yankee-t, ne mund të flasim për dy forma të socializmit, të pranishme në botën anglo-seksone dhe Gjermani: për socializmin e miliarderëve dhe socializmin e nëpunësve civilë. Si një shembull i llojit të parë mund të përmendim Andriu Karneixh, i cili ishte i pari që transformoi një sasi të madhe fondesh publike në një pasuri private, vetëm me qëllimin për ta kthyer atë mbrapsht duke e shpërndarë përmes gjesteve sovrane nëpër sipërmarrje publike.

Deklarata e tij se “Kushdo që vdes i varfër vdes pa nder,” është shumë domethënëse për të përçarur përparësinë që duhet të ketë vullneti për pushtet mbi totalitetin. Ky lloj socializmi privat, që në raste ekstreme është thjesht administrimi diktatorial i parave publike, nuk duhet të ngatërrohet me socializmin e nëpunësve dhe administratorëve të vërtetë publikë (të cilët edhe vetë mund të jenë shumë të varfër). Shembujt e kësaj forme të dytë të socializmit, janë personalitetet tejet të ndryshme të Bismarkut dhe Bebelit.

Xhorxh Bernard Shou sot është eksponenti kryesor i socializmit “katastrofik,” i cili pasurinë dhe varfërinë ende i sheh si faktorët kontrollues të sferës ekonomike. “Varfëria është e keqja më e madhe dhe krimi më i keq.” (*Major Barbara*) Ai predikon kundër “masave burracake që kapen pas paragjykimit të zbehtë se është më mirë të jesh i mirë sesa i pasur.” Punëtori duhet të përpiqet që të bëhet i pasur – kjo ishte politika e sindikatave angleze që në fillimet e tyre. Kjo është arsyeja se përse në Angli asnjëherë nuk ka pasur një socializëm në kuptimin proletar, që nga Oueni e deri te Shou; ishte e pamundur që të ndaheshe nga kapitalizmi i klasave të ulta.

Për ne, faktori kontrollues i shoqërisë është ndërveprimi i urdhrit dhe bindjes në një bashkësi rreptësisht të strukturuar sipas një hierarkie, qoftë ajo në trajtën e një shteti, partie, trupave të zyrtarëve apo nëpunësve të shërbimit civil. Antari i secilës nga këto bashkësi është një shërbëtor i asaj bashkësie. Punëtor në shërbim të mbretit të Prusisë – kjo do të thotë ta bësh detyrën tënde pa iu dhënë korrupsionit të shkaktuar nga përçafimi i konceptit të fitimit privat. Rrogat e paguara zyrtarëve prusianë dhe nëpunësve civilë që nga koha e Frederik Vilhelmit të I-rë, kanë qenë qesharakisht të vogla krahasuar me shumat e kërkuara që duhet t’iu përkasin antarëve të klasës së mesme në Angli.

Kompensimi i vërtetë për këtë punë është rangu. Edhe në partinë e August Bebelit ndodhte e njëjta gjë. Ky shtet brenda shtetit i punëtorëve, nuk dëshironte që të pasurohej, gjithë sa ai dëshironte ishte të sundonte. Gjatë grevave të tyre të detyruara, këta punëtorë vuajtën nga uria vërtet shumë, por duke u karakterizuar nga qëllimi i përfutimit të pushtetit dhe nuk sakrifikuuan për paga më të larta.

Ata u sprovuan në mbështetje të një filozofie që parimisht apo aktualisht, ishte në kundërvënie me atë të punëdhënësve të tyre. Ata i qëndruan besnikë një parimi moral dhe një disfatë në betejën e tyre, në të vërtetë donte të thoshte një fitore morale.

Punëtorët anglezë ishin tërësisht të paafte për ta kuptuar këtë. Ata nuk ishin të varfër dhe gjatë grevave ata i pranuan mijëra stërlinat që iu ofruan nga punëtorët gjermanë, të cilët përfytyronin se shokët e tyre përtej

Kanalit ishin duke luftuar për të njëjtën kauzë. Kësisoj, Revolucioni i Nëntorit në Gjermani, ishte rasti i një mosbindjeje si në partinë e punëtorëve, ashtu dhe në radhët e forcave të armatosura. Transformimi i beftë i lëvizjes së disiplinuar punëtore në një luftë të egër për paga më të larta, e realizuar nga grupe të veçanta të pavarur nga njëri-tjetri, për idenë angleze ishte një fitore e mirëfilltë.

Dështimi i saj u nënvizua nga fakti se në Ushtri u rishfaq një organizim tejet i disiplinuar. Personaliteti vërtet i talentuar që u shfaq në skenë ishte një ushtar. Dhe Revolucioni Gjerman do të vazhdojë në këtë mënyrë, si një seri suksesesh dhe dështimesh nga ana e autoritetit ushtarak.

I njëjti kontrast mbizotëron edhe në mendimin ekonomik të të dy vendeve. Ekonomistët politikë kanë bërë gabimin vdekjeprurës të të menduarit vetëm në terma materialistë. Në vend që të marrin në konsideratë morinë e instinkteve ekonomike të botës, ata gjithmonë flasin në terma të përgjithshëm rreth shtresëzimit ekonomik të “njeriut të epokës moderne” dhe të “së tashmës.” Kur përdorin një gjuhë të tillë, disiplina shkencore e ekonomisë politike shfaq të gjitha mangësitë e origjinës së saj angleze. Sepse zanafillën e saj ajo e ka në mesin e anglezëve modernë, me të gjithë vetëbesimin e tyre dhe mungesën e taktit psikologjik. Ajo u bë “filozofia” e tyre e vetme; mund të themi se ajo i korrespondonte sensit të tyre të garimit tregtar, suksesit dhe fitimit personal. Me këtë interpretim pastërtisht anglez të çështjeve ekonomike, ata kanë infektuar mendjet e Kontinentit duke filluar që prej shekullit të tetëmbëdhjetë.

Kalorësit teutonikë që u vendosën dhe kolonizuan kufijtë lindorë të Gjermanisë në Mesjetë, karakterizoheshin nga një ndjenjë e vërtetë për autoritetin e shtetit në çështjet ekonomike, ndjenjë që e kanë trashëguar edhe prusianët e vonë. Rreth detyrimeve të tij ekonomike individi është i informuar nga Caktimi, nga Zoti, nga shteti apo nga vetë talenti i tij – që të gjitha këto janë thjesht fjalë të ndryshme për të thënë të njëjten gjë.

Të drejtat dhe privilegjet e prodhimit dhe konsumimit të mirave janë të shpërndara në mënyrë të barabartë. Qëllimi nuk është kurrë pasuria më e madhe për individin apo për çdo individ, përkundrazi, ai është lulëzimi i të gjithëve. Kësisoj, Frederik Vilhelmi i I-rë dhe pasardhësit e tij kolonizuan moçaloret e Lindjes, duke e parë këtë si misionin e tyre hyjnor. Punëtori modern gjerman, me kuptimin e tij fin të realitetit, ka menduar dhe vepruar në përputhje me këto linja, edhe pse teoritë e Karl Marksit ia kanë turbulluar atij lidhjet e ngushta që ekzistojnë midis qëllimeve të tij dhe atyre të prusianëve të vjetër.

Instinkti piratesk i kombit ishullor ka një kuptueshmëri tërësisht të ndryshme të çështjeve ekonomike. Në të veprimtaria ekonomike konsiderohet një çështje dyluftimi dhe plaçke lufte, ndërsa kohët e fundit, shihet thjesht si pjesa që individi ka në këtë plaçkë. Shteti norman, që zhvilloi një teknikë të sofistikuar të grumbullimit të rezervave të parave, mbështetej plotësisht mbi parimin e piraterisë.

Sistemi feudal u paraqit si një mënyrë e shkëlqyeshme dhe elegante e të njëjtit qëllim piraterik. Baronët shfrytëzonin tokën që iu ishte caktuar, duke u shfrytëzuar nga ana tjetër nga duka. Qëllimi i të gjithëve ishte pasuria. Atë Zoti ia dhuronte atyre sipërmarrësve dhe guximtarëve.

Shkenca moderne e llogarimbajtjes zanafillën e saj e ka pikërisht me këto piratë sedentarë. Fjalët “kontrollo,” “llogari,” “kontroll,” “faturë,” “arkiva” dhe termi modern për thesarin anglez, “Exchequer,” e kanë

zanafillën në dhomat e kontabilitetit të dukës norman Robert le Diable (që ka ndërruar jetë në vitin 1035).²¹ Kur Anglia u pushtua në vitin 1066, baronët normanë, kushërinjtë e tyre fisnorë saksonët, i shpronësuan në të njëjtën mënyrë. Kësisoj, pasardhësit e tyre e kanë trashëguar botëkuptimin që ata kishin.

I njëjti stil sot është ende i pranishëm në çdo kompani tregtare angleze dhe në çdo trust amerikan. Qëllimi i tyre nuk është të punojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, për ta ngritur të gjithë standardin e jetesës së kombit, përkundrazi, gjithë sa ata duan është të prodhojnë pasuri private nëpërmjet përdorimit të kapitalit privat, mposhtjes së garës private dhe shfrytëzimit të publikut përmes reklamimit, luftrave të çmimeve, stimulimit artificial të konsumatorit dhe kontrollit të rreptë të raportit midis ofertës dhe kërkesës. Kur anglezi flet për pasurinë kombëtare, ai nënkupton numrin e milionerëve që ka vendi.

Këtu është me vend të citojmë Fridrih Engelsin: “Për mendësinë angleze asgjë nuk është më e huaj sesa solidariteti.” Edhe në sporte dhe argëtim, anglezi sheh shijen e një superioriteti personal, veçanërisht në aspektin fizik. Ai përfshihet në sporte të ndryshme për hir të rekordeve kombëtare dhe botërore; ai i shijon çmimet e fituara nga dyluftimet, një sport ky që është ngushtësisht i lidhur me zakonet e tij ekonomike dhe tërësisht i huaj për mendjet e gjimnastëve në Gjermani.

E gjithë kjo vërteton se ekzistenca ekonomike e Anglisë është e njëjtë me biznesin, thënë ndryshe, është

²¹ Rënia e Perëndimit, II, fq. 372.

një formë e rafinuar e piraterisë. Instinkti anglez të gjitha komoditetet i konsideron si pre, si artikuj që duhen manipuluar me qëllim për t'u pasuruar. Makinaria industriale angleze u krijua në interes të tregtisë, qëllimi kryesor i së cilës ishte prodhimi i produkteve të lira. Kur bujqësia angleze filloi ta kufizonte uljen e pagave duke përcaktuar çmimet e veta, thjesht u braktis në interes të tregtisë. Betejat midis kapitalit dhe punës në industrinë angleze të viteve 1850, kishin të bënin me produktin e “fuqisë punëtore” – njëra palë dëshironte që ta siguronte atë me çmim të lirë, ndërsa tjetra në këmbim të saj kërkonte një çmim të lartë.

Gjithçka që Marks i thotë me një admirim qejfprishur rreth “shoqërisë kapitaliste,” para së gjithash lidhet me një instinkt ekonomik anglez dhe jo me një të tillë universal.

Termi sublim “tregti e lirë” është pjesë thelbësore e ekonomisë vikinge. Termi prusian, thënë ndryshe ai socialist, do të ishte “kontroll shtetëror i shkëmbimit të të mirave.” Brenda kompleksitetit të veprimtarisë ekonomike, tregtisë ai i vesh një rol vartës dhe jo dominues. Ne mund ta kuptojmë se përse Adam Smith e fshehu urrejtjen etij ndaj shtetit dhe “bishave dinake të quajtur burrështetas.” Ç’është e vërteta, zyrtarët qeveritare mbi tregtarët duhet të kenë të njëjtin efekt siç policët kanë mbi hajdutët dhe kryqëzorët detare mbi anijet pirate.

Gjithashtu, një tjetër karakteristikë e anglezit është mbivlerësimi që ai ka për rëndësinë e shumave kapitale për shëndetin ekonomik. Materialisti e ka të pamundur ta

kuptojmë se koncepti anglez i kapitalit nga pikëpamja psikologjike, e për rrjedhojë edhe nga ajo praktike (jeta praktike, tek e fundit, është shprehje e kushteve psikike) I ndryshëm nga sistemi francez i mjeteve private dhe koncepti prusian i fondeve administrative. Anglezët asnjëherë nuk kanë qenë të mirë në sferën e psikologjisë. Idetë e tyre ata gjithmonë i kanë konsideruar si logjikisht detyruese mbi “njerëzimin.”

Në të vërtetë, që të gjithë ekonomistët politikë modernë bazohen mbi gabimin elementar të barazimit të jetës ekonomike kudo nëpër botë, me një interes të veçantë anglez ndaj biznesit, gabim ky që bëhet edhe nga ata që i refuzojnë teoritë e shkollës së Mançesterit. Marksizmi, nëse nga njëra anë e mohon këtë teori, nga ana tjetër i ka përqaftuar plotësisht strukturat e saj.

Kjo shpjegon dështimin grotesk të të gjitha parashikimeve që kanë të bëjnë me shpërthimin e Luftës Botërore; ajo që u tha ishte se shembja e ekonomisë botërore do të ndodhte brenda pak muajve.

Kapitalizmi i stilit anglez është plotësuesi i vetëm i vërtetë i socializmit marksist. Rregullimi i çështjeve ekonomike nga ana e shtetit, një ide prusiane kjo, e transformoi kapitalizmin gjerman instinktivisht në një strukturë ekonomike socialiste. Hapi i parë i këtij procesi ishte legjislati i tarifor mbrojtës i 1879-tës.

Në fakt, sindikatat e mëdha ishin shtete ekonomike brenda shtetit. Ato përfaqësojnë “përprjekjen e parë praktike dhe sistematikisht të madhe të kapitalizmit, edhe pse kjo ishte diçka jo e planifikuar në mënyrë të qëllimshme, për të kuptuar misteret e vetë teknikave të

tij dhe për të fituar kontroll mbi forcat shoqërore, të cilat deri në atë kohë ishin konsideruar si të natyrshme dhe të pakuptueshme, që gjithë sa kërkonin ishte një bindje pasive dhe e verbër. (Lensch, *Drei Jahre Weltrevolution*)

Megjithatë, liberalizmi gjerman – anglezi brenda nesh – ende e adhuron tregtinë e lirë dhe jo thjesht lirinë e shpirtit njerëzor. Duke vepruar kështu, gjermani “liberal” e portretizon veten si budallai më i madh. Për shkak se i ka keqkuptuar dhe është përpjekur t’i përkrahë disa instinkte të caktuara vikinge, “përmbledhtazi” ai e ka refuzuar shtetin autoritar, vullnetin mbipersonal dhe shtypjen e individit në favor të totalitetit. Duke përqafuar një qëndrim të tillë, ai ka vepruar, apo së paku kështu beson, në mënyrë “metafizike”.

Ky është besimi i gjermanëve të “arsimuar” të cilëve u mungon përvoja praktike: i profesorëve, poetëve dhe mendimtarëve, i të gjithëve atyre që shkruajnë me tepri por që kurrë nuk *bëjnë* asgjë. Sigurisht që ata nuk mundën ta kuptojnë apo ta pranojnë moralisht formën tjetër të liberalizmit, parimin pirat të tregtisë së lirë me filozofinë e saj të “secilit për vete.” Ata thjesht nuk e kanë kuptuar ndonjëherë lidhjen midis konceptit abstrakt të vetes së pavarur dhe zbatimit praktik të tij nëpër zyrat e firmave të mëdha industriale dhe tregtare. Prandaj liberalizmi gjerman i bursës e ka lidhur profesorin gjerman pas në vagonin e tij.

E ka dërguar atë nëpër takimet politike që të flasë dhe të flasin për të. E ka ulur në karrigen e botuesit, ku me një mendjemprehtësi filozofike ai ka diskutuar nene e nene me radhë, duke ia përcjellë ato një tërësie

opinionesh publike politike (për bartësit e të cilëve gazeta ka kohë që e ka zëvendësuar Biblën si burimi i së Vërtetës) që nga pikëpamja tregtare ishin të dëshirueshme për t'u përqaftuar. E ka shpënë atë në asamblenë legislative për të thënë “Po” dhe “Jo,” duke siguruar kështu për interesa tregtare, të cilave asnjëherë nuk iu bëhet vonë për teori dhe kushtetuta, krijimin e gjithnjë e më shumë mundësive për ryshfet dhe pirateri.

Ky liberalizëm anglo-gjerman tani ushtron një kontroll të ngjashëm me atë të biznesit, mbi praktikisht të gjithë gazetat e rëndësishme gjermane, të gjithë klasën e arsimuar dhe partinë liberale. Por profesorët nuk janë të vetëdijshëm për këtë.

Në Angli liberali është një liberal në çdo aspekt; nga pikëpamja etike ai është i lirë dhe për këtë arsye edhe ekonomikisht i tillë, lidhje kjo për të cilën ai është shumë i vetëdijshëm. Liberali gjerman ka dy personalitete të veçanta, atë etik dhe atë tregtar.

Njëri prej tyre mendon, ndërsa tjetri vepron dhe kontrollon; por vetëm ky i dyti është i vetëdijshëm rreth kësaj marrëdhënieje reciproke, gjë që i duket diçka zbavitëse.²²

Kësisoj, shohim që në botën moderne kemi të bëjmë me dy parime të mëdha ekonomike, që qëndrojnë në kundërvënie me njëri-tjetrin. Vikingu është bërë një tregtar i lirë; ndërsa kalorësi teuton sot është një zyrtar administrativ. Mes tyre nuk mund të ketë një pajtim. Secili nga këta dy parime janë shpallur nga një popull

²²

Rënia e Perëndimit, II, fq. 402.

gjerman, që në thelb është një faustian *par excellence*. Ai as nuk mund të pranojë një kufizim të vullnetit të tij dhe as nuk mund të jetë i kënaqur derisa e gjithë bota i është dorëzuar idesë së tij të veçantë. Nëse e vërteta është kështu, lufta do të vazhdojë derisa njëra palë të shpallë fitoren e saj përfundimtare. Çfarë do të jetë pra ekonomia botërore, një shfrytëzim apo një organizim botëror?

Çfarë do të jenë çezarët e perandorisë së ardhshme, miliarderë apo administratorë universalë? Popullsia e botës, për aq kohë sa kjo perandori e qytetërimit faustian do të qëndrojë e bashkuar, do t'i nënshtrohet karteleve dhe trusteve, apo njerëzve si ata që parashikohen në faqet mbyllëse të Pjesës së II-të të *Faustit* të Gëtes? Fatet e botës janë vërtet në rrezik.

Mendimi ekonomik francez ka qenë po aq provincial sa ai i Rilindjes. Provincializmi është karakteristikë e sistemit tregtar të Luigjit të XIV-të, e shkollës fiziokratike të Turgotit gjatë Iluminizmit, por gjithashtu edhe i planifikimit të Fourierit, të cilët kishte për qëllim ndarjen e “shoqërisë” në njësi të vogla ekonomike që do të quheshin “falansteri” (shih romanet e fundit të Emil Zolasë).

Vetëm tre popujt e vetëm faustianë e zotërojnë shtysën e brendshme për të krijuar një sistem ekonomik të vlefshëm për të gjithë botën. Një përpjekje e tillë u bë nga fisnikët spanjollë, kur Botën e Re e përfshinë në perandorinë e tyre. Si ushtarë të vërtetë, ata u përmbajtën nga teorizimi rreth ekspansionit ekonomik, por duke i

zgjerruar horizontet e tyre gjeografike dhe politike, përgatitën rrugën për një lloj të ri të mendimit ekonomik.

Shteti i parë që formuloi një teori rreth veprimtarisë së saj ekonomike ishte Anglia, e cila krijoi konceptin e “ekonomisë politike” për të shpjeguar praktikën e saj të shfrytëzimit universal. Si biznesmenë, anglezët ishin mjaftueshëm të zgjuar për të kuptuar fuqinë e fjalës së shkruar mbi kombet e vetëdijshme të të gjitha kohërave rreth rëndësisë së librit. Dhe ata e bindën kombin e tyre se interesat e piratëve të tij ishin ato të të gjithë botës. Ata ia dolën ta kombinonin konceptin e lirisë me atë të tregtisë së lirë.

I treti dhe i fundit nga këta popuj faustianë, siç ishte Spanja me kombin e saj vërtet ushtarak, karakterizohet nga mungesa e mendjemprehtësisë praktike të anglezëve. Arritjet prusiane brenda vetë sferës së saj ekonomike, me ndihmën e filozofisë shpirtërore gjermane të idealizmit, në teori përftuan titullin e lartësuar të socializmit.

Por krijuesit e vërtetë të jetës ekonomike prusiane nuk ishin të aftë ta kuptonin në këtë paraqitje teorike krijimin e tyre. Kësisoj, lindi një konflikt i hidhur midis këtyre dy fraksioneve panevojshëmrisht armiqësore: njëri i përbërë nga teoricienë dhe tjetri nga individë në krye të çështjeve praktike. Në këtë pikë, kemi arritur një etapë që për të dy palët është e detyrueshme që të bien në ujdë mes tyre dhe ta pranojnë detyrën me të cilën përballen.

Nga kapitalistët apo socialistët ka për t’u sunduar bota? Përgjigjja e kësaj pyetjeje dhe zgjidhja e kësaj çështjeje nuk mund të vendoset nga dy vende në garë.

Kjo është bërë një çështje e brendshme për çdo shtet. Menjëherë sapo armët e përdorura kundër shteteve të huaja të lihen mënjanë, kanë për të kërcitur ato të luftës civile. Sot, në çdo shtet, ekziston një parti ekonomike angleze dhe prusiane. Dhe kur klasat dhe fraksionet të jenë të lodhura nga lufta, mjeshtëritë individuale do ta mbajnë atë të gjallë në emrin e parimit. Në mes të konflikteve të mëdha të epokës klasike të zhvilluara midis parimeve apoloniane dhe dionisiane, Lufta e Peloponezit, nga një luftë midis Athinës dhe Spartës u transformua në një garë midis oligarkisë dhe popullit, e shtrirë në të gjitha qytetet. Vendimet e marra në betejat e Filipit dhe Actiumit, u desh që të rishikoheshin fuqimisht në kohën e Gracchit, duke e mbushur Forumin Romak me gjak. Në botën kineze, lufta korresponduese midis perandorive Tsin dhe Tsu, midis filozofive *tao* dhe *li*, zgjati një shekull.

Në Egjipt, misteret e mëdha të të njëjtit lloj janë të fshehura nën misterin e periudhës së Hyksosit, që shënon hegjemoninë e barbarëve lindorë. Si është e vërteta, a u thirrën apo erdhën sepse egjiptianët ishin dëshpërimisht të shkatërruar nga konflikti civil? Po rusëve, a do t'i veshë të njëjtin rol bota perëndimore? Paqeruajtësit tanë të parëndësishëm mund ta thonë të tyren rreth pajtimit midis kombeve; por ata kurrë nuk mund të pajtojnë *ide*. Shpirti viking dhe ai i kalorësve kanë për të luftuar mes tyre deri në fund, edhe pse bota mund të dalë e rraskapitur dhe e shkatërruar nga gjakderdhja e shekullit.²³

²³

Rënia e Perëndimit, II, fq. 414.

Kjo çështje na shpie në aspektet politike të antitezës anglo-prusiane. Politika është përmasa më e lartë dhe më e fuqishme e të gjithë ekzistencës historike. Historia botërore është historia e shteteve; ndërsa historia e shteteve është historia e luftrave.²⁴ Idetë, kur ushtrojnë trysni për t'u ndër marrë vendime, marrin formën e një sive politike: të shteteve, popujve apo partive. Ato duhet të luftojnë jo me fjalë por me armë. Lufta ekonomike shndërrohet në një luftë ushtarake midis shteteve apo brenda tyre. Asociacionet fetare të tilla si Judaizmi, Islami, hugënotët dhe mormonët, e perceptojnë veten si shtete kur diskutohet vazhdimësia e ekzistencës apo sukcesi i tyre.

Gjithçka që vjen nga thellësia e shpirtit për t'u bërë mish apo krijim mishtor, kërkon mbrapsht një sakrificë të përbërë pikërisht nga mishi. Idetë që janë shndërruar në gjak kërkojnë po gjak. Lufta është struktura e përjetshme e ekzistencës më të lartë njerëzore dhe shtetet ekzistojnë për hir të saj; ato janë shprehje e gatishmërisë për luftë.

Edhe në rastet kur një njerëzim i lodhur dhe pa gjak që nuk ka aspak dëshirë të përfshihet në luftë, si qytetarët e botës klasike gjatë shekujve të saj të fundit, apo si indianët dhe kinezët e sotëm, ai thjesht mund ta shkëmbejë rolin e mbajtësit në këmbë të luftës me atë të të qenit objekt për të cilin janë të tjerët ata që e mbajnë luftën në këmbë.

²⁴

Rënia e Perëndimit, II, fq. 416.

Edhe nëse do të arrihej një harmoni universale faustiane, si llojet mjeshtërore të periudhave të vona romake, kineze apo e faraonëve të vonë egjiptianë, përsëri që të gjithë do të luftonin mes tyre për zotërimin e kësaj perandorie, nëse forma e saj përfundimtare do të ishte ajo kapitaliste; apo për rangjet më të larta, nëse ajo do të ishte socialiste.

Sidoqoftë, një element i pandashëm i çdo strukture politike është populli që e ka krijuar këtë strukturë, që e bart atë në gjakun e tij dhe që i vetëm është i aftë ta mishërojë. E analizuar në vetvete, një strukturë politike është një koncept i zbrazët. Kushdo mund ta flasë “gjuhën” e saj. Por askush nuk mund ta rikrijojë apo ta mbushë atë me një realitet të vërtetë. Në politikë ashtu si dhe në çdo gjë tjetër, nuk ka zgjedhje. Secila kulturë dhe çdo popull i caktuar brenda një kulture, i organizon çështjet e veta dhe i përmbush fatet e saj në përputhje me struktura që janë të lindura dhe thelbësisht të pandryshueshme. Një debat filozofik rreth “monarkisë” apo “republikës” në të vërtetë është një zënkë rreth termave. Forma monarkike e qeverisjes *an sich*,²⁵ është një koncept po aq joreal sa edhe forma e resë *an sich*. Një “republikë” e vjetër klasike dhe një “republikë” perëndimore evropiane janë dy gjëra që kanë raporte të shpërpjesëtuara mes tyre. Kur një krizë nxit thirrjen e “monarkisë” apo “republikës” në të vërtetë nuk është asgjë më shumë sesa një thirrje, nuk është asgjë më shumë sesa sinjalizimi verbal në një skenë melodramatike, edhe pse është e vetmja gjë që shumica e popujve në një epokë të caktuar mund të kuptojnë dhe

²⁵

Siç ne e njohim. (Shënim i përkthyesit)

prej së cilës mund të frymëzohen. Në realitet, duke u dhënë pas këtyre momenteve ekstaze dalldisëse, një popull gjithmonë ka për t'u kthyer në strukturën e tij politike, cilësia thelbësore e të cilës pothuajse asnjëherë nuk mund të shprehet në gjuhën popullore. Instinktët e një race energjike janë aq të fuqishme sa ato mund të pajtohen dhe të jenë në harmoni me çdo formë qeverisjeje që rastësia historike mund të vendosë në udhën e saj dhe ta formësojë në përputhje me qëllimet e saj.

Dhe kur kjo ndodh askush nuk është i vetëdijshëm se struktura politike në fjalë është përmbushur vetëm si emër. Forma e vërtetë politike e një vendi të caktuar nuk duhet të kërkohet në përpilimin e kushtetutës së tij; përkundrazi, ajo gjendet në ligjet e pashkruara dhe të pavetëdijshme, në përputhje me të cilët kushtetuta hyn në fuqi.

Pa u parë rast pas rasti se për cilat kombe bëhet fjalë, fjalët “republikë,” “parlamentarizëm” dhe “demokraci” janë etiketime të pakuptimta.

Prandaj, “forma parlamentare e qeverisjes” është një dukuri specifikisht angleze, e pamendueshme dot, përveçse si një produkt i karakterit viking të anglezëve, i situatës së tyre ishullore dhe i procesit shekullor nëpërmjet të cilit ata kanë kombinuar një metodë të caktuar për menaxhimin e sjelljeve tregtare me një etikë të tërë shoqërore. Të përpiqesh ta imitosh atë është diçka e kotë. “Parlamentarizmi” në Gjermani është ose i pakuptimtë ose tradhti. Anglia ia ka dalë që t'i helmojë

të gjithë vendet të cilave iu ka ofruar “ilaçin” e formës së saj të qeverisjes.

Dhe anasjelltas: nëse do të ndodhë që zhvillimi përfundimtar i qytetërimit perëndimor, thënë ndryshe, ai qytetërim që sot e sundon botën si një të tërë, do ta shpallë të pamundur këtë formë qeverisjeje, atëherë Anglia me siguri që do ta humbasë qëndrueshmërinë e saj politike si komb.

Socializmi anglez do të kryente tradhti nëse do të përpiqej që të hiqte dorë nga Parlamenti. Sepse Anglia është një shoqëri e lirë e përbërë nga individë privatë, të cilëve vendndodhja ishullore iu ka ofruar mundësinë e shfuqizimit të “shtetit” dhe zëvendësimit të tij me këtë ide pastërtisht formale të një serie luftrash, që është duke zgjatur që prej vitit 1916 dhe që mbahet në këmbë nga ushtarë dhe marinarë të marrë hua nga vende të huaja.

Ky parlamentarizëm i pashtet, presupozon një sistem të qëndrueshëm dypartiak, në të cilin partitë duhet të lidhen mes tyre në një mënyrë të veçantë, të karakterizuar nga një respekt karshi organizimit, praktikës, interesave, gjendjeve shpirtërore, zakoneve dhe shpirtit.

Ajo çfarë anglezët quajnë “parti” – kjo fjalë nënkupton gjëra të ndryshme në vende të ndryshme – në origjinë kanë qenë grupime të fisnikërisë, të cilat u ndanë gjatë revolucionit të vitit 1642 e veçanërisht të atij të 1688-tës, në varësi të ndarjes mes besimeve anglikane dhe puritane.

Sigurisht që kjo do të thotë se motivi kryesor i kësaj ndarjeje ishte një diferencë në botëkuptimin e tyre etik. Paraardhësit detarë norsë, rreth të cilëve ne lexojmë nëpër sagat islandeze, secilit grup të ri u lanë në trashëgim tipare të ndryshme. Torët trashëguan krenarinë që ushqenin rreth gjakut të tyre fisnik, respektin e tyre aristokratik për autoritetin e trashëguar, për pronën e patundshme dhe për bëmat e tyre ushtarake dhe konfliktet e përgjakshme.

Ndërsa te Vigët mund të dallojmë kënaqësinë që norsët ndjenin karshi piraterisë dhe plaçkitjeve, dhënien e tyre pas triumfeve të shpejta dhe të lehta, të mbushura me plaçkë të bollshme lufte, ashtu si dhe vlerësimin e tyre ndaj dinakërisë dhe mendjemprehtësisë dhe jo ndaj forcës fizike. Imperialisti dhe tregtari i sotëm anglez është produkti përfundimtar i një procesi shekullor, gjatë të cilit tiparet norske bazë janë sofistikuar dhe rafinuar, duke rezultuar kështu në një mbarështim gjithnjë e më të kujdesshëm brenda klasës aktuale sunduese.

Demokratizimi i Anglisë në shekullin e nëntëmbëdhjetë ishte vetëm në dukje; në realitet kombi, ashtu si dhe në Prusi, vazhdoi të udhëhiqej nga një pakicë që zotëronte aftësi përbashkësuese dhe të qëndrueshme për veprim praktik. Ushtrimi sublim i këtij vullneti dhe ky talent praktik, vazhduan deri në përfundim të luftës së fundit.

Biznesi – në kuptimin piraterik të fjalës – është shuma dhe thelbi i kësaj politike, pavarësisht faktit nëse janë Torët apo Vigët në krye të punëve. Sigurisht që para së gjithash, që të dyja llojet janë “zotërinj,” janë antarë të

së njëjtës shoqëri të shquar, të cilët shfaqin të njëjtin pëlqim admirues ndaj qëndrimeve shoqërore. Për këtë arsye, paçka se në kohë të caktuara mund të përfshihen në armiqësi të ashpra kundrejt njëri-tjetrit, për anglezët është e mundshme që konfliktet e furishme t'i zgjidhin nëpërmjet bisedave dhe korrespondencave private.

Kësisoj, ata janë të aftë që të bëjnë shumë gjëra vetëm duke u nisur nga parimi se qëllimi justifikon mjetet. Në çdo shtet tjetër mosmarrëveshje të tilla do të humbisnin nëpër poteret e asambleve popullore të plogështa dhe ligjore.

Udhëheqësi i partive angleze çështjet e kombit i zgjidh si individ privat. Kur ai arrin një sukses politik, deklaron se prapa politikës së tij qëndronte “Anglia.” Ndërsa kur politikat e tij, paçka se të suksesshme, përfshihet në marrëveshje që nga pikëpamja diplomatike apo morale janë të sikletshme, ai jep dorëheqjen nga posti i tij, veprim për shkak të të cilit kombi i tij e qorton me ashpërsinë puritane si pasojë e mungesës së sjelljeve të duhura, ashtu si dhe duke e duartrokitur dorëheqjen e tij, i refuzon pasojat shqetësuese të veprimeve të tij. E megjithatë, i gjithë kombi e falenderon Zotin për begatinë që

Ai i ka dhuruar Anglisë përmes punës së suksesshme të këtij politikani.

Një sjellje e tillë është e mundshme vetëm nëse të dyja partitë janë në të njëjtën mendje për çështje themelore. Është e vërtetë që Torët shkaktuan rënien e Napoleonit dhe e detyruan të shkojë në Shën Helenë, pasi ai kishte përhapur idetë Vige nëpër Kontinent. Por

Foksi nuk ishte aspak një kundërshtar i panegociueshëm luftime me Napoleonin.

Dhe kur në vitin 1815 Robert Peel e shpuri sistemin e Kobdenit për tregtinë e lirë drejt triumfit përfundimtar, duke parapëlqyer kësajsoj nënshtrimin ekonomik të botës ndaj transformimit të saj në një protektorat ushtarak, në sistemin Vig Torët pikasën disa nga vetë parimet e tyre. Politika e Torëve gjatë mbretërimit të Eduardit të VII-të shkaktoi Luftën Botërore; e megjithatë Vigët, kundërshtarë të luftës, e pranuan në heshtje këtë mundësi, duke i pritur krahëhapur në radhët e tyre “imperialistët liberalë.”

Kjo lloj veprimtarie është “parlamentarizmi” i vërtetë dhe jo dukjet e pavlera dhe jo efektive që konsiderohen si “parlamentarizëm” në Gjermaninë e sotme, të tilla si shpërndarjet e portofoleve të ministrive ndaj udhëheqësve të partive apo ekspozimi i procesit parlamentar karshi reklamimit më të gjerë.

Në sistemin britanik, vendimet përfundimtare të udhëheqësve të partive janë të fshehta edhe për shumicën parlamentare. Veprimtaritë publikisht të dukshme të politikanëve janë *fable convenue*²⁶ dhe takti shembullor i të dy partive sheh në të se iluzioni i “qeverisjes përmes popullit” ruhet në përpjesëtim të kundërt me kuptimin aktual të termit.

²⁶ Fabula për të cilën është rënë dakord. Që do të thotë, është versioni i ujditur nga palët politike për t’u bërë publik. (Shënim i përkthyesit)

Ideja se partitë, e mbi të gjitha ato angleze, janë segmente të gjera të popullit, është një pakuptimësi diletantësh. Në realitet nuk mund të ekzistojë diçka e tillë si qeveria popullore apo qeverisja nëpërmjet popullit, përveçse në njësitë politike që përfshijnë një numër fshatrash.

Vetëm gjermanët e pashpresë liberalë vazhdojnë të besojnë te ky koncept. Në të gjitha vendet që sistemet politike angleze kanë depërtuar, qeveria në të vërtetë gjendet në duart e pak njerëzve të cilët, përmes një arbitrariteti diktatorial, e ushtrojnë pushtetin e tyre brenda partisë mbi bazën e përvojës, vullnetit superior dhe aftësive taktike që gëzojnë.

Kështu pra, çështja që shtrohet përpara nesh është ajo që ka të bëjë me marrëdhënien midis popullit dhe partisë. Çfarë kuptimi mund të kenë zgjedhjet në kombet moderne perëndimore? Kush i mban ato? Kë dhe çfarë zgjedhin ato?

Kuptimi i sistemit anglez është se populli zgjedh një *parti* dhe jo thjesht një “përfaqësues” të vullnetit dhe opinionëve të tij, sepse këto të fundit, pak a shumë për çdo rast janë të ndikuara nga udhëheqësia e partisë. Partitë janë institucione të vjetra dhe shumë të qëndrueshme, detyra e të cilave është të administrojnë çështjet politike të të gjithë kombit anglez.

Individi anglez e kupton praktikalitetin e një institucioni të tillë dhe nga zgjedhjet në zgjedhje ai mbështet partinë, qëllimet e shpallura të së cilës korrespondojnë më së shumti me mendimet dhe interesat e tij. Ai gjithashtu e kupton parëndësinë e individit

“përfaqësues” të emëruar në mënyrë krejtësisht arbitrare nga ana e partisë. Ç’është e vërteta, fraza “elektorat i trashë” përfaqësuesit mesatar i shkon për shtat më mirë sesa vetë masave votuese. Është domethënëse se punëtorët anglezë shpesh herë kanë votuar për një nëpunës të emëruar nga njëra nga partitë e vjetra dhe jo për një kandidat që vinte nga radhët e punëtorëve. Në çdo rast, pas një vlerësimi të kthjellët të situatës, ata e kanë konsideruar si më me dobi të votonin në këtë mënyrë.

Në Amerikë, ku anglezi i vërtetë nuk qëndron më prapa sistemit, zakoni është që partitë të artikulojnë një paketë premtimesh ndaj popullit dhe një tjetër ndaj atyre të cilët mbushin arkat e saj; premtimet e para shpallen publikisht, të dytat mbahen të fshehta.

Tani kemi arritur në çështjen kryesore që ka të bëjë me atë se si politikbërja paguhet në vendet që kanë një formë parlamentare qeverisjeje. Entuziastët naivë demokratikë thjesht nuk e kuptojnë se në kohën tonë, kur të gjitha kombet, me apo pa pëlqimin e tyre, udhëhiqen nga një politikë interesash tregtare, çështja e financave është themelore, jo aq për shpirtin e kushtetutës, sa për shpirtin e zbatimit të saj praktik.

Entuziastët e padjallëzuar mendojnë bazuar në rrogat e përfaqësuesve, por kjo është një çështje jo fort e rëndësishme. Kurse monarkët e epokës baroke, ishin të prirur të besonin se partitë politike moderne thjesht duhej t'i administronin dhe t'i shpërndanin këto fonde. Nëse e vërteta është kështu, është një çështje pastërtisht përshtatshmërie, nëse biznesi i madh vendos që të zbusë elektoratin, përfaqësuesit apo vetë udhëheqësinë partiake.

E para nga këto alternativa përputhet me strukturën e parlamentarizmit anglez dhe në shekullin e tetëmbëdhjetë, ai u zbatua në një stil të madh përmes blerjes së votave.

Në rrjedhën e kohës kjo metodë është bërë e tepërt. Torët dhe Vigët nga grupet e klasës së lartë, pasi i kanë përkufizuar qartazi qëndrimet e tyre shoqërore, sot janë zëdhënës të disa interesave pastërtisht tregtare dhe sponsorizuesit e tyre dallojnë mes tyre vetëm rast pas rasti në varësi të formës më të përshtatshme dhe arsytimit më të mirë moral të një nisme të veçantë. Grupet e interesit pasi ndahen mes tyre, në mënyrë të

përshkallëzuar nisin të shfaqen nën mbrojtjen e partive të demokratizuara.

Në Francën anarkike, ku klubet dhe asociacionet private, numri dhe fuqia e të cilave ndryshon me shpejtësi, zakoni ka qenë pagimi i përfaqësuesve, ose me para në dorë ose nëpërmjet mënyrave më të rafinuara. Përfaqësuesit socialistë janë thjesht pranues të këtyre teknikave, siç janë edhe të tjerët.

Nuk ndodh rrallë herë që një francez ndërton një karrierë politike i karakterizuar nga siguria se pas disa vitesh mund të blejë një kështjellë. Në Gjermani, ku partitë i qasen njerëzve me programe ideologjike, liberalizmit i është dashur t'i bëjë favore bursës, ndërsa industria e rëndë ka fituar kontroll mbi krahun nacionalist. Industria e rëndë dhe bursa paguajnë për agjitacion politik, ashtu siç paguajnë edhe për një shtyp përkrahës (pjesërisht përmes kontratave të reklamave).

Nëse Kushtetuta e Vajmarit mbetet në fuqi edhe për disa vite, postet e përfaqësuesve që janë në përkrahje të disa interesave të caktuara tregtare, do të jenë të sigurueshme për një çmim të caktuar. Zgjedhjet e para që u mbajtën për Asamblenë e Vajmarit i nxorrën në pah fillimet e praktikave të tilla.

Që demokracia dhe e drejta universale për të votuar janë mjete të besueshme të kapitalizmit, kjo është vërtetuar në të gjitha ato vende që kanë përqafuar këto metoda të modelit anglez. Ndërkohë që profesori liberal Kushtetutën e Vajmarit e përshëndet si përmbushjen e ëndrrave të tij, liberali kapitalist e mirëpret atë si mënyrën më të thjeshtë dhe me shumë gjasa më të lirë

për t'ia nënshtuar politikën sferës së biznesit dhe shtetin batakçinjve.

E gjithë kjo ilustron hegjemoninë e shpirtit viking ndaj qytetërimit perëndimor, që deri më tani përgjithësisht ka qenë një qytetërim anglez. Forma në të cilën parlamentarizmi thelbësisht i patransferueshëm i Anglisë e ka imponuar veten ndaj Kontinentit dhe gradualisht ndaj të gjithë botës, është “kushtetuta.” Kritikën ndaj qeverisë ekzistuese ai e ka shndërruar në një pjesë integrale të vetë qeverisë.

Por natyra pashtet e qeverisë që u zhvillua në shoqërinë angleze, që të gjitha kushtetutave të reja mbështetur te modeli anglez, i ka pajisur me një tendencë të qartë antishtetërore. Nga njëra anë, rezultati ka qenë krijimi i pseudo-partive që më kot kanë tentuar teknikat angleze të vendosjes së pushtetit ekzekutiv në duart e udhëheqësisë së partisë.

Nga ana tjetër, në pah ka dalë një “opozitë,” e cila më shumë sesa konstruktive është një opozitë shkatërruese, e një ndasie të vazhdueshme midis grupit në pushtet dhe parimit partiak, apo midis vetë partive, si rezultat i konceptimeve të tyre gjerësisht divergjente sa i përket privilegjeve partiake. Miraboja, mendja më e mprehtë e Francës në kohën kur ajo iu dorëzua idesë vikinge, nëse do të kishte jetuar më gjatë, me siguri që do t'i ishte kthyer në rendin absolutist, në mënyrë që ta shpëtonte vendin e tij nga pseudo-parlamentarizmi i klubeve sovraane. “Intriga” botërore e shpreh plotësisht qëndrimin e supozuar nga francezi anarkik, në vend të strategjisë së kujdesshme të anglezit, me qëllim që të

japë përshtypjen se metoda të tilla e konfirmojnë mënyrën e tij të jetuarit. Si rrjedhim, forma më e zbatueshme e anarkisë, e themeluar edhe një herë në Francë për të arritur një sukses të shkëlqyeshëm por gjithsesi kalimtar, ka qenë një lloj despotizmi i momentit.

Ky ishte rasti i Mazarinit dhe Risheljesë dhe që prej 1789-tës, ka qenë qëllimi i fshehtë edhe i klubeve më të vogla politike. Shprehja e saj klasike ishte diktatura e një ushtari të huaj, Napoleonit.

Makiaveli, në mes të konfuzionit të politikës së Rilindjes, i vari shpresat te Çezare Borxhia për të arritur diçka të ngjashme. Nga të gjitha kombet perëndimore, Franca dhe Italia nuk kanë prodhuar asnjë ide të vetme politike. Shteti i Luigjit të XIV-të, njësoj si perandoria e Napoleonit, ishte një rastësi e izoluar dhe jo një sistem i destinuar të zgjaste.

Si një formë organike e aftë për t'u zhvilluar, monarkia absolute e epokës Baroke ishte një krijim Habsburg dhe jo Burbon. Që prej Filipit të II-të deri te Meterniku, oborri i Habsburgëve themeloi mënyrën e praktikave qeveritare të pothuajse të gjithë oborreve dhe kabineteve qeveritare; oborri i *Mbretit Diell* shkaktoi përshtypje të madhe vetëm falë zakoneve dhe ceremonialitetit nga i cili karakterizohej.

Provë për këtë është sjellja dhe dukja shumë e ngjashme me ato të Rilindjes nga ana e Napoleonit. Vetëm në Firence dhe në Paris mund të ndodhte që zyrtarët e suksesshëm ushtarak të luanin një rol të tillë

jotradicional dhe të themelonin një lloj shteti aq fantastik e kalimtar.

Në të vërtetë, në Francë nuk ekzistonte ndonjë sistem tipik qeverisës. Rusoi, teoricieni i anarkisë politike, konceptin e tij të kontratës shoqërore e nxorri nga “shoqëria” qëndrueshmërisht e stabilizuar e Anglisë, e cila nga pikëpamja politike funksiononte e karakterizuar nga një vetëbesim instinktiv absolut. Ideja e kontratës shoqërore si hapin e saj përfundimtar, kërkonte mënyra rastësore dhe arbitrare për ta shpëtuar shoqërinë nga konfuzioni i vullneteve individuale. Në rast të një revolucioni, Napoleoni mund të ishte bërë kryeministër në Angli, feldmareshall në Prusi dhe të dyja bashkë në Spanjë, me një pushtet plotësisht diktatorial. Vetëm në Francë dhe Itali ai shihej i veshur me mantelin e Karlit të Madh.

Por megjithatë, në Prusi ekzistonte një shtet i vërtetë në kuptimin më të mirëfilltë të kësaj fjale. Për ta thënë në mënyrë sa më të drejtëpërdrejtë, në Prusi nuk kishte individë privatë.

Çdo person i vetëm që jetonte në këtë sistem, i cili funksiononte me preçizitetin e një makine, ishte një antar integral i tij. Për këtë arsye, detyra e administrimit nuk mund t’i ngarkohej individëve privatë, siç dikton sistemi parlamentar. Administrimi i fondeve publike ishte një funksion zyrtar dhe politikanët përgjegjës për të ishin zyrtarët shtetërorë, shërbëtorë të pasurisë së përbashkët.

Në Angli biznesi dhe politika ishin dy gjëra sinonime; në Francë, mizëria e politikanëve profesionistë të vendosur nëpër poste nga kushtetuta, është shndërruar

në klasë mercenarësh të interesave të biznesit. Në Prusi, politikani puro profesionist gjithmonë ka qenë një figurë e pavlerë. Prandaj, kur demokratizimi i qeverisë u bë i pashmangshëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë, struktura angleze duhej të shmangej, duke qenë se ishte në kundërshtim me stilin prusian.

Në këtë kuptim që po flasim, demokracia nuk do të thoshte liri private, sepse kjo ishte e barabartë me licencën tregtare dhe shpinte drejt një forme politike private, që do të përfundonte duke e përdorur shtetin si një instrument. Ideali kalorsiak i “të gjithëve për të gjithë” iu nënshtrua një interpretimi modern, por jo në kuptimin e formimit të partive, tendencë kjo që një herë në disa vite prekte të gjitha masat, duke iu dhënë atyre ose privilegjin e votimit për një kandidat të miratuar nga partia ose mos të votonin fare, ndërsa vetë partia, nëse ishte në “opozitë,” ngjitej lart për të ndërhyrë në punët e qeverisë.

Përkundrazi, parimi i “të gjithëve për të gjithë,” në Prusi mori formën e caktimit të çdo individi një masë të caktuar urdhri dhe bindjeje, në varësi të aftësive të tij praktike, morale dhe intelektuale. Që do të thotë, çdo qytetari i ishte akorduar një rang dhe shkallë personale përgjegjësie dhe si një post zyrtar, ajo ishte e përvokueshme.

Ky ishte *Ratesystem*, siç ishte planifikuar një shekull më parë nga Baron von Stein. Ai ishte një ide pastërtisht prusiane, mbështetur mbi parimet e përzgjedhjes, bashkëpërgjegjësisë dhe besnikërisë profesionale. Por sidoqoftë, në një mënyrë tërësisht marksiste, ai është

imponuar t'i përngjajë atmosferës mbytëse të egoizmit klasor. Sot ai është një pasqyrim i përpiktë i përshkrimit të bërë nga Marksi për klasën e kapitalistëve piratë anglezë, i vikingëve që operonin jashtë kufijve të kontrollit shtetëror. Ai është një sistem i tregtisë së lirë, tërësisht anglez, por i kthyer përmbys, ngase klasat punëtore sot janë “shoqëria.” Dhe ky është Bentami dhe jo Kanti.

Steini dhe këshilltarët e tij kantianë, dëshironin që t'i organizonin grupet profesionale. Në një vend ku puna duhet të ishte detyra universale dhe kuptimi i vetë jetës, individët nuk duhet të dallonin për nga pasuria, por për nga arritjet. Kësisoj Steini parashikoi zeje profesionale lokale, të organizuara sipas rëndësisë relative të çdo profesioni në shoqërinë e parë si një e tërë.

Ai dëshironte një hierarki përfaqësuese, në krye të së cilës të qëndronte Këshilli Shtetëror; mandatet e të gjitha niveleve mund të revokoheshin në çdo kohë. Planet e tij që të përmbusheshin, nuk kërkonin as parti të organizuara, as politikanë karriere dhe as zgjedhje periodike.

Për të qenë sa më të qartë, Steini asnjëherë nuk i artikuloi mendime të tilla; nga kjo na del se ai i ka refuzuar qëllimisht të gjitha ato.

Por ato ishin të pranishme edhe pa rënë në sy, në reformat që ai sugjeroi, duke mundësuar kështu një demokratizim sistematik të qeverisë prusiane në harmoni me instinktet prusiane dhe jo ato angleze apo franceze, duke garantuar në të njëjtën kohë se për mbarëvajtjen e sistemit të ri, do të përzgjidheshin personalitetet e

duhura. Njësoj siç një makinë ka nevojë për t'u mirëmbajtur nga një inxhinier i aftë, njësoj edhe shteti ka nevojë për një Këshill Shtetëror. Ndërsa jo-shteti, nga ana tjetër, ka nevojë për një këshill të fshehtë, i përbërë nga parti të ndryshme, por i ndërtuar në mënyrë të ngjashme me Këshillin Shtetëror.

Sigurisht që çdo parti duhet të përgatitet që aparati i saj drejtues të mund të shërbejë edhe si trupa qeverisëse e të gjithë vendit. Anglia në fakt, zotëron dy dhe jo një “këshille punëtorësh” apo këshille kurore – ky është pikërisht kuptimi i parlamentarizmit.²⁷ Ndërsa ajo që kërkonte sistemi prusian, ishte një këshill i vetëm, i përbërë nga një antarësi e qëndrueshme.

Përkundrazi, nën përshtypjen e ngjarjeve napoleoniane, admirimi ndaj institucioneve angleze u bë mbizotërues. Hardenbergu, Humboldti dhe të tjerët ishin “anglezë.” Ata besonin tezat e Shaftesburit dhe Hjumit dhe jo ato të Kantit.

Ishte e detyrueshme që reformat të ndodhnin nga brenda sistemit prusian, por në të vërtetë ato u imponuan nga për së jashtmi. I gjithë frustrimi politik i shekullit të nëntëmbëdhjetë, i gjithë steriliteti i pakufi i sistemit tonë parlamentar, e gjithë mungesa e burimeve njerëzore, ideve dhe arritjeve, i gjithë konflikti i vazhdueshëm midis fraksioneve armiqësore dhe trysnive të dhunshme, janë rezultati i drejtëpërdrejtë i imponimit të një sistemi të thellë rigoroz dhe njerëzor, mbi një popull të prirur për

²⁷ Elektorati nuk ka as ndikimin më të vogël në përbërjen e asnjërit prej këshilleve. Ai thjesht zgjedh se cili nga të dy do të qeverisë.

një rend politik tërësisht të ndryshëm, qoftë ai po aq rigoroz dhe i thellë. Në ato zona ku talenti i vjetër prusian për organizim u testua në një kontekst mjaftueshëm të gjerë, siç ishte krijimi i sindikatave dhe karteleve, i bashkimeve tregtare dhe testimi që ai iu nënshtrua në sferën e mirëqenies shoqërore, ai rezultoi më shumë sesa i guximshëm.

Indiferenca me të cilën janë pritur zgjedhjet dhe debatet mbi të drejtën universale për të votuar, pavarësisht përpjekjeve të partive dhe shtypit, tregon se sa i huaj është për Prusinë sistemi parlamentar dhe, që prej vitit 1870, për të gjithë popullin gjerman.

Kur një prusian apo një gjerman ka ushtruar të drejtën e tij për të votuar, në të shumtën e rasteve kjo është thjesht një shprehje e mërzi së tij të mjegullt. Në asnjë vend tjetër këto ditë *puro angleze* nuk paraqesin një përshkrim aq të rremë të ndjenjës aktuale politike. Masat nuk e kanë përdorur kurrë këtë teknikë ekzotike “bashkëpunimi” dhe asnjëherë nuk do ta bëjnë. Kur një anglez nuk ia del t’i ndjekë seancat parlamentare, ai e bën këtë duke besuar se kabineti në fjalë do të kujdeset më së miri për interesat e tij.

Ndërsa kur një gjerman bën të njëjtën gjë, ai niset nga ndjesia e apatisë së plotë. Për të i vetmi realitet është *die Regierung*.²⁸ Për ne, parlamentarizmi gjithmonë ka për të qenë një përzierje gjërash të jashtme dhe në dukje.

Në Angli që të dyja partitë prej kohësh kanë qenë nismëtare sovrane dhe udhëheqëse të politikës. Por në

28

Qeveria. (Shënim i përkthyesit)

Prusi ekzistonte një *shtet* dhe partitë, të themeluara për arsye të protokollit parlamentar, u shndërruan në thjesht kritikuese të shtetit, ndërsa në Angli funksionet e partive ishin një rezultat i drejtëpërdrejtë i konfigurimit aktual të popullit si një entitet tregtar.

Në Prusi që në fillim ekzistonte një marrëdhënie e rreme midis sistemit që kishte qenë për qëllim dhe atij ekzistues, midis planit dhe efektit, midis partive në teori dhe atyre në praktikë. Opozita është një pjesë e domosdoshme dhe integrale e qeverisjes në Angli; ajo luan një funksion plotësues. Ndërsa opozita jonë është vërtet një mohim, si i vetë qeverisë ashtu dhe i partive të tjera. Dhe shfuqizimi i monarkisë nuk i ka ndryshuar aspak gjërat.

Është domethënëse dhe karakteristike e fuqisë së instinktit kombëtar që dy partitë që mund të etiketohen si specifikisht prusiane, ajo Konservatore dhe Socialiste, nuk i kanë humbur kurrë tendencat e tyre antiliberale dhe antiparlamentare.

Ato janë që të dyja socialiste në një kuptim të lartë, prandaj dhe i korrespondojnë në mënyrë thuajse identike dy partive kapitaliste të Anglisë. Duke mos i njohur e pranuar as interesat private dhe as ato partiake si udhëheqëse të qeverisë, autoritetin e pakushtëzuar ato ia veshin totalitetit dhe lidërshiptit të individit në interesin e përgjithshëm.

Fakti se njëra nga këto parti flet rreth shtetit monarkik ndërsa tjetra flet rreth punëtorëve, vërteton që dallimi në fjalë është vetëm verbal, kur ne themi që në vendin tonë punon *kushdo* dhe se vullneti i individit

gjithmonë i nënshtrohet vullnetit të totalitetit. Nën trysinë e sistemit anglez, që të dyja këto parti ishin shtete brenda shtetit.

Sipas vetë bindjeve të tyre ato ishin *shteti*, ndaj dhe kësaj nuk e njihnin nevojën e ekzistencës së ndonjë partie tjetër. Por kjo mjafton si përjashtim i qeverisë parlamentare. Ato nuk i mohonin predikimet e saj ushtarake; veç kësaj, organizonin batalione ekskluzive dhe të mirorganizuara votuesish, në të cilat konservatorët ia dilnin të gjenin oficerë më të mirë, ndërsa socialistët trupa ushtarake. Këta batalione ishin të strukturuar sipas logjikës së urdhrit dhe bindjes dhe kjo ishte mënyra se si ata konceptonin shtetin *e tyre*, shtetin e Hohenzollernëve dhe atë të së ardhmes.

Liria, në kuptimin “anglez,” nuk mbizotëroi as në njërin dhe as në tjetrin shtet. Pavarësisht efikasitetit të tyre parlamentar, ata ushqyen një urrejtje të fshehtë ndaj qëndrimit parlamentar anglez, i cili rangjet shoqërore i përcaktonte në varësi të pasurisë.

Që të dyja partitë e përçmonin sistemin prusian të të drejtës universale për të votuar, me hierarkinë e saj frustruese të të pasurve dhe të varfërve – ndoshta konservatorët më pak, por ata e konsideronin atë vetëm si një mjet efikas që mund të tolerohej për përmbushjen e një qëllimi.

E megjithatë, ata e përbuznin çdo sistem të drejte vote mbështetur mbi strukturën angleze, sepse e dinin që ai medoemos shpinte drejt plutokracisë. Kushdo që është i gatshëm të paguajë për një sistem të tillë, mund t'i korë frutet e tij.

Përveç Konservatorëve dhe Socialistëve, Prusia ka pasur edhe Partinë Ultramontane të stilit spanjoll, tradita shpirtërore e së cilës datonte që prej epokës së hegjemonisë Habsburge dhe përcaktimeve territoriale të Paqes së Vastfelisë. Kjo parti, në mënyrë të fshehtë admiron Napoleonin si themeluesi i Konfederatës së Rinit. Në taktika ata janë mishërues të diplomacisë mjeshtërore të kabineteve të Madridit dhe Vjenës.

Me mprehtësinë e pjekur të Kundër-Reformacionit, ajo ka arritur t'i shfrytëzojë në favor të qëllimeve të veta tendencat demokratike dhe procedurat parlamentare. Në thelb ajo nuk përçmon asgjë – në të vërtetë, është e aftë të përfitojë diçka nga çdo eventualitet.

Dhe nuk duhet të harrojmë edukimin dhe disiplinën socialiste të shpirtit spanjoll, i cili njësoj si ai prusian e ka origjinën në urdhrat kalorsiakë të periudhës gotike dhe që, më herët edhe sesa vetë prusianët, në frazën “Froni dhe Altari” kishte mishëruar një parim universal.

Natyra shpirtërore angleze e Gjermanisë, në thelb ishte ndërtuar si një parti që i përkushtohet përhapjes së parlamentarizmit, me entuziazmin e një *Weltanschauung*-u, si një *Prinzip*, si një *Idee*, si një *Ding an sich*.²⁹ Për këta njerëz, Napoleoni ishte emisari i ideve liridashëse.

Ata i kanë sistemuar “bindjet etike” në kohën kur anglezët ushtronin talentin dhe përvojën e tyre. Simboli i tyre është “këndvështrimi” politik. Kur tre liberalë bëhen

²⁹ *Weltanschauung* (botëkuptim), *Prinzip* (parim), *Idee* (Ide), *Ding an sich* (diçka në vetvete). (Shënim i përkthyesit)

bashkë, ata themelojnë një parti të re; kjo ishte ideja e tyre e individualizmit.

Ata asnjëherë nuk i bashkëngjiten një klubi boulingu, pa paraqitur si pjesë të “agjendës” një “amendament të statutit.” Për shkak se në Angli mbizotëron një rend publik i pashtet, ata i tërbon çdo akt autoritar nga ana e qeverisë. Ata i rrënoqethin edhe qëllimet autoritare të socializmit.

Botëkuptimi *bürgerliche*³⁰ është një dukuri specifike gjermane. Atë nuk duhet ta ngatërrojme kurrë me *bourgeoisie* franceze, e aq më pak me klasën e mesme angleze. Stili i madh i liberalizmit anglez përshtatet në mënyrë të varfër me të. *Quod licet Jovi non licet bovi.*³¹ Poshtë fratit të liberalit gjerman, gjendet një zemër që ende rreh për ritmin e ngathët të *Rajhut* të vjetër dhe një shpirt që vajton për realitetet e qytetërimit modern.

Këta liberalë kalemxhinj mbledhin e mbledhin literatura të ndryshme rreth “transhentalitetit” dhe “idealitetit” (diçka që në çdo libër paraqitet ndryshe) që pretendon t’i interpretojë fort idetë realiste angleze. Sigurisht që pa këto të fundit, këta popuj do të gjendeshin vërtet të pambrojtur nga idetë prusiane, të cilat janë sa të mprehta sa dhe joromantike.

³⁰ Borgjez. (Shënim i përkthyesit)

³¹ Ajo çfarë është e lejuar për Jupiterin, nuk është për lopët. Frazja nënkupton se ka disa njerëz të cilëve iu lejohet të kryejnë veprime apo të bëjnë gjëra të cilat për pjesën dërrmuese të njerëzve janë të ndaluara. (Shënim i përkthyesit)

Ata janë të paaftë për t'u organizuar, ndaj dhe politikisht të padëmshëm në vetvete, por janë mobilizuar në një parti ushtarake nga kasta tjetër e liberalëve gjermanë, nga grupi që ka përqafuar idealin e anglezëve pa e kuptuar rëndësinë themelore që ai ka në skemën angleze të gjërave: diktaturën ekonomike të pasurisë private.

Liberalët tanë “anglezë” e kanë shndërruar partinë e tyre në një opozitë vrastare që pak nga pak gërryen dhe dobëson kudo dhe kurdo idenë socialiste prusiane kur ajo iu pengon rrugën drejt biznesit të tyre të gjithëfuqishëm. Për ta mbyllur, ishte ky lloj i liberalizmit ai që mobilizoi “Anglinë e brendshme” të shumicës sonë që parti-adhuruese, për të depërtuar në revolucionin parlamentar të 1917-tës, duke siguruar kështu fitore për “Anglinë e jashtme” dhe Fuqitë Aleate, nëpërmjet rrëzimit të vetë shtetit.

Liberalët tanë kërkojnë një parlamentarizëm puro, jo sepse dëshirojnë një shtet të lirë, por sepse nuk duan kurrfarë shteti, ashtu si dhe për arsyen se ata janë po aq të vetëdijshëm sa edhe të ngjashmit e tyre anglezë se kjo veshje e huaj, mund ta shndërrojë në të paaftë për të vepruar një popull me prirje dhe brumë socialistësh. Ata i josh kozmopolitanizmi “përtej kombëtar” i Mikaelit gjerman.

Ndërkohë që nga njëra anë mund ta përqeshin si një qëllim politik, nga ana tjetër ia dinë vlerën si një instrument politik. Ata me vullnet të plotë iu japin profesorëve kozmopolitë postet e tyre akademike dhe rubrikat “kulturore” nëpër gazeta, ashtu si dhe

inkurajojnë diletantët parlamentarë që të përfshihen në politikë duke shkruar nëpër rubrikat editoriale dhe duke marrë pjesë sallat e asambleve. Nëpërmjet kësaj mënyre sjelljeje, me këmbënguljen më të madhe ata janë duke e shtyrë karron e tyre politike drejt anglezshmërisë më të përsosur.

Në Revolucionin Gjerman socializmi vuajti disfatën e tij më të hidhur; kundërshtarët e tij e detyruan që ai t'i kthente armët e tij kundër vetes. Por pavarësisht të gjithë kësaj, dy parimet e mëdha universale vazhdojnë të jenë në kundërvënie me njëri-tjetrin: diktatura e parave apo talenti i organizuar, bota si plaçkë apo si një shtet i vërtetë, pasuri apo autoritet politik, sukses apo vokacion.

Që të dyja partitë socialiste të Gjermanisë duhet të bashkohen kundër armikut të idesë që ato bashkëndajnë: kundër Anglisë sonë të brendshme, kapitalizmit dhe liberalizmit parlamentar.

Monarkia socialiste³² - kjo është një ide që është pjekur gradualisht në botën faustiane dhe që prej kohësh ka përgatitur protagonistët e saj njerëzorë. Socializmi autoritar është për definicion monarkik.

Posti me përgjegjësinë më të madhe në këtë organizëm gjigand, që me fjalët e Frederikut të Madh ishte roli i “shërbëtori i parë i shtetit,” nuk duhej të braktisej për ambicie private. Le të përfytyrojmë një komb të bashkuar ku gjithësecilit i akordohet një post në

³² Ishte Ferdinand Lassalle i cili, në vitin 1862, në librin e tij *Po tani?*, bëri thirrje për një bashkim të klasës punëtore dhe monarkisë prusiane, që t'i kundërviheshin liberalizmit dhe teorisë angleze të “rojtarit të natës” rreth shtetit të dobët.

përputhje me rangun e tij shoqëror, talentin për vetëdisiplinim vullnetar mbështetur te bindjet e brendshme, aftësive organizuese, potencialit në punë, vetëdijes dhe energjisë, ashtu si dhe në përputhje me gatishmërinë e tij të vullnetshme për t'i shërbyer kauzës së përbashkët.

Le të planifikojmë rekrutime njerëzish që do të vendosen nëpër vende të caktuara pune, që kryesisht konsistojnë në zeje profesionale që do të administrojnë dhe në të njëjtën kohë do të administrohen nga një këshill administrativ dhe jo nga një parlament. Një emër i përshtatshëm për këtë trupë administrative, në një shtet ku kushdo ka një punë, qoftë ai një oficer ushtarak, një nëpunës civil, një bujk apo minator, mundet fare mirë të jetë “këshilli i punës.”

Në kundërshtim me këtë ide qëndron vizioni i një Republike kapitaliste Botërore. Sepse Anglia *është* një “republikë,” edhe pse sot kjo fjalë ka kuptimin e qeverisjes përmes individëve të suksesshëm privatë, që mund të paguajnë për zgjedhjen e tyre, ashtu si dhe për ndikimin që mund të kenë. Republikanët botërorë ëndërrojnë rreth tokës si një terren gjuetie, në të cilën dëshirojnë që të pasurohen dhe ku kërkojnë për veten të drejtën për t'u përfshirë në dyluftime ballë për ballë. Eventualisht Torët dhe Vigët, dy partitë kapitaliste, do të bashkoheshin mes tyre kundër socializmit të “Prusisë së brendshme,” që në Angli as nuk mund ta pretendojë mbështetjen e pandarë të punëtorëve – me punën e cila, sigurisht që konceptohet si një fatkeqësi e ishujve britanikë.

Kjo do të thotë se sistemi parlamentar do t'i nënshtrohet një ndryshimi strukturor, sepse ai nuk mund të funksionojë me tre parti. Në Anglinë e hershme ishin të pasurit kundër të pasurve, një filozofi kundër tjetrës, *brenda* vetë klasës së lartë. Ndërsa tani do të kemi të bëjmë me të pasurit kundër të varfërve, pra kemi Anglinë kundër diçkaje tjetër.

Por kjo është e njëjta gjë sikur të themi se parlamentarizmi si një skemë politike është i dalë mode; për këtë nuk kemi kurrfarë dyshimi. Ai e kishte nisur rënien e tij që kur gjermanët budallenj na e sollën këtu. Epoka e tij më e mirë ishte përpara Bismarkut. Ajo ishte një metodë e vjetër, e pjekur, e shquar dhe tejet e rafinuar, dhe që të përsosej në mënyrë të plotë duhej i gjithë takti i “xhentëlmenit” aristokrat anglez.

Ai kërkonte një marrëveshje themelore mbi një numër të konsiderueshëm çështjesh, për t'u siguruar se “mirësjellja” nuk do të vihej në rrezik. Protokollin e debatit parlamentar i ngjante atij të një dueli fisnikësh. Njësoj si muzika e periudhës midis Bahut dhe Bet'hovenit, ai ishte mbështetur mbi mjeshtërinë e përsosur të parimeve formale.

Menjëherë sapo ky formalizëm u braktis, muzika u shndërrua në barbare. Sot askush nuk është i aftë të kompozojë një fugë të stilit të vjetër, siç ishin të aftë ta bënin kompozitorët klasikë. E njëjta gjë është edhe me taktikat parlamentare të ngjashme me fugën muzikore. Sa më të trashë që të jenë njerëzit, aq më të trasha janë dhe çështjet që ata parashirojnë – kjo është e gjitha. Kësisoj dueli bëhet grindavec. Institucionet, sensi i taktit

dhe vrojtimit të kujdesshëm të aftësive, janë duke u zhdukur me njerëzit e stilit të vjetër e të mirë. Luftën për ekzistencë, parlamentarizmi i ri do ta paraqesë në mënyrë pothuajse aspak të qytetëruar dhe me një sukses shumë më të varfër.

Marrëdhënia midis udhëheqësve të partisë dhe vetë partisë, midis partisë dhe masave, do të jetë më e ashpër, më transparente dhe më e pacipë. Ky është fillimi i çesarizmit.³³

Gjurmë të ardhjes së tij ishin të pranishme në zgjedhjet angleze të vitit 1918. As ne gjermanët nuk do t'i shpëtojmë dot atij. Ai është fati ynë, njësoj siç ishte fati i Romës dhe Kinës, në të vërtetë, i të gjitha kulturave të pjekura. Por, çfarë do të kemi – miliarderë apo gjeneralë, bankierë apo nëpunës civilë të cilësisë më të lartë? Kjo është pyetja e përrjetshme.

³³

Rënia e Perëndimit, II, fq. 431.

IV. Marksi

19

Lufta përfundimtare intensive e dy ideve gjermane, tani është fuqimisht e ndikuar nga një faktor tërësisht i ndryshëm, çështja e fuqisë punëtore. Nga njëra anë kemi një dikotomi filozofike e llojit më të brendshëm është duke shkuar drejt zgjidhjes, zgjidhje e cila do t'i japë ekzistencës së njeriut faustian strukturën e tij të bashkuar përfundimtare.

Nga ana tjetër kemi një gjendje fizike emergjence, që kërkon ndryshime në kushtet e jashtme të të jetuarit. E para pra, është një çështje e metafizikës, ndërsa e dyta e ekonomisë politike. Këto dallime themelore midis dy dukurive duhet t'i kemi parasysh në mënyrë të vazhdueshme.

Problemi i “pushtetit të katërt” u shfaq në çdo kulturë gjatë kalimit drejt qytetërimit.³⁴ Në Gjermani kjo nisi në shekullin e nëntëmbëdhjetë; befasisht Rusoi doli jashtë mode. Pushteti i tretë i përkiste qytetit, që e mbështeti fuqinë e tij gjithnjë e më shumë te tokat bujqësore; ndërsa pushteti i katërt ishte produkt i megalopolit, që i asgjësoi tokat bujqësore.

Si një dukuri shumë e vonë në çdo kulturë të mundshme, pushteti i katërt është i përbërë nga masa të ngjashme me ato të nomadëve të cilat, të paforma dhe ç'është e vërteta armiqësore karshi çdo forme, u zgjeruan nëpër labirintet e gurta, duke shkaktuar keqardhje nëpër mbetjet e njerëzimit të gjallë. Ai është një grup i pastrehë

³⁴

Rënia e Perëndimit, II, fq. 102 dhe 356.

dhe i frustruar, i mbushur me urrejtje ndaj shkallëve strikte të kulturës së vjetër që nuk ka kurrfarë vullneti për ta pranuar atë, e duke kërkuar për t'u çliruar nga gjendja e vështirë.

Qytetërimi perëndimor evropian, në të gjitha format dhe manifestimet e tij, dominohet nga industria e makinave.³⁵ Punëtori industrial nuk është aspak “pushteti i katërt” por megjithatë, ai në mënyrë të justifikueshme e konsideron veten një përfaqësues të atij grupi.

Ai është një simbol. Si lloj, origjinën e ka në këtë qytetërim dhe e ndjen thellë anomalinë e ekzistencës së tij. Nëse të tjerët janë skllavër të epokës së teknologjisë, si biznesmeni apo edhe inxhinieri, atëherë ai është *më* skllavi nga të gjithë.

Por për çështjen punëtore zgjidhja nuk mund të vijë vetëm për atë apo vetëm prej tij. Për të qenë sa më të drejtëpërdrejtë, pushteti i katërt është një fakt i thjeshtë, jo një ide. Dhe përballë fakteve mund të ketë vetëm kompromise materiale – jo si efekt i realizimit të një ideali, por si një rezultat strategjik i luftës pragmatike për avantazhe ndaj të tjerëve.

Tek e fundit, duke i ndjekur të gjitha aksidentet dhe tekat e konfliktit, mbërrimë në pikën sa na duhet ta pranojmë duke u dorëhequr atë që na vjen nga një bllokim që na mundëson një masë të caktuar mirëqenieje pasive – një lloj lumturie kineze, lumturinë e Romës Perandorake: *bukë dhe cirk*. Është e vështirë të përfytyrojmë se sot, ne qëndrojmë në pikën më të lartë të

³⁵

Rënia e Perëndimit, II, fq. 499.

eksitimit masiv të qyteteve të mëdha dhe, si rezultat i të gjitha sloganeve që qarkullojnë, vrojtuesit e kujdesshëm kanë qenë të prirur ta mbivlerësojnë perspektivën e egoizmit klasor. Por brenda një apo dy shekujsh, e gjithë kjo do të kalojë, përveç nëse lëvizja punëtore hyn në shërbim të një ideje të përgjithshme.

Çfarë ka mbetur nga pasioni i madh i Gracchit³⁶ gjatë mbretërimit të Augustit? Problemi nuk është zgjidhur, ai thjesht u zhduk.

Ky është momenti kur Marksi bëhet pjesë e problemit. Përmes një përlllogaritjeje të shkëlqyer intelektuale – më shumë imponuese sesa korrekte – ai u përpoq që faktet t’i ngrinte në nivelin e një ideje. Bazuar mbi antitezën midis parimeve vikinge dhe atyre kalorsiake, ai ravijëzoi një teori me një shtrirje jo shumë të gjerë por kohezive, nëpërmjet të cilës shpiku pikëpamjen popullore të historisë, që në të vërtetë është gjerësisht e pranuar edhe sot e kësaj dite.

Ai kishte lindur në atmosferën prusiane dhe më vonë u bë pjesë e asaj angleze, por e vërteta është që ai mbeti një i huaj karshi jetës shpirtërore të të dy popujve. Si një qytetar i shekullit të nëntëmbëdhjetë shkencor, ai ishte një materialist i mirë, por një psikolog i keq.

Prandaj dhe ai dështoi t’u jepte realiteteve të mëdha cilësinë e një ideje. Në vend të kësaj, idetë i reduktoi në koncepte dhe interesa të veçanta. Në vend të gjakut

³⁶ Bëhet fjalë për lëvizjen reformuese të Tiberius Sempronius Gracchus. Ai ishte një politikan romak që më së shumti njihet për reformën agrare, nëpërmjet të cilës, një pjesë të tokave të çifligarëve të mëdhenj, ua dha të varfërve. (Shënim i përkthyesit)

anglez që nuk e ndjente në dejet e tij, ai përqafoi vetëm gjëra dhe koncepte angleze. Ndërsa sa i përket Hegelit, i cili ishte ai që në përgjithësi e përfaqësonte më së miri Prusianizmin, Marksi i mori vetëm metodën.

Kështu ndodhi që, përmes një përllogaritjeje vërtet groteske, dikotominë instinktive midis dy racave gjermane, ai e transformoi në një dikotomi materiale midis dy niveleve klasore. “Proletariatit,” që për të ishte pushteti i katërt, ai i atribuoi idenë e socializmit, ndërsa “borgjezisë,” që për të ishte pushteti i tretë, i veshi idenë angleze të kapitalizmit.

Këto janë ekuacionet e rreme që i kanë hapur shtegun katër koncepteve, me kuptimin konkret të të cilave sot ne jemi që të gjithë të njohur. Me këto fjalë kyçe, aq të papërbalueshme në thjeshtësinë e tyre, ai arriti që fuqinë punëtore të pothuajse të gjithë vendeve, ta konsolidonte në një klasë që zotëronte një vetëdije të ndryshme klasore. Sot pushteti i katërt flet me gjuhën dhe mendon me konceptet e tij. Pas Marksit, “proletariati” nuk ishte më një emër por një sfidë. Duke filluar me Marksit, e ardhmja shihej nëpërmjet leximit të asaj që ishte e shkruar nëpër libra. Fuqia e sistemit fshihet në cektësinë e tij.

Ende ekziston një socializëm kishtar spanjoll, një socializëm kapitalist anglez dhe një socializëm autoritar prusian, përveç lëvizjeve proletare me natyrë pastërtisht anarkike, kapitaliste dhe socialiste, por askush nuk është në dijeni rreth tyre.

Besimi te natyra përbashkuese e qëllimit është me i fortë sesa realiteti dhe ky besim, siç ndodh gjithmonë në

botën perëndimore, buron nga një libër. Të hedhësh dyshim mbi vërtetësinë e tij absolute është një krim. Ishte fjala e shkruar dhe e botuar ajo që garantoj e para se shpirti faustian, ndikimin e tij do ta ushtronte përtej të gjitha kufijve të kohës dhe hapësirës.

Në Revolucionin Anglez ishte Bibla, në Revolucionin Francez, *Kontrata Shoqërore* e Rusoit, ndërsa në Revolucionin Gjerman, *Manifesti Komunist*. Nga riinterpretimi që ai i bëri konfliktit racor si konflikt midis klasave dhe instinkteve të vjetra gjermane si impulset e vona të popullatave të qyteteve të mëdha, Marksi nxorri konceptin e tij qendror rreth “konfliktit klasor.”

Strukturimi horizontal i forcave historike u shndërrua në vertikal; ky është kuptimi i pikëpamjes materialiste të historisë. Mendësia shkencore e kohës kërkonte që lënda dhe energjia të konsideroheshin si të kundërta. “Lënda” e “energjisë” politike ishin popujt dhe kombet; ajo e “energjisë” ekonomike ishin klasat. Dhe për rrjedhojë, fjala “klasë” mori një kuptim tërësisht të ri.

Me naivitetin psikologjik të një mendjeje të trajnuar shkencërisht të viteve 1850, Marksi nuk mundi ta kuptonte diferencën midis klasës dhe gjendjes pasurore.³⁷

Një gjendje pasurore është një koncept etik, është shprehje e një ideje. Pjesa e privilegjuar e shoqërisë në vitin 1789, ishte e ndarë nga borgjezia si një shtresë që

³⁷

Rënia e Perëndimit, II, fq. 327.

mishëronte idenë formale të *madhështisë*, *kortezisë* dhe fisnikërisë së brendshme dhe të jashtme, pavarësisht se sa ajo ishte kalbëzuar nga mënyra dekadente e të jetuarit. Ndodhi vetëm pasi borgjezia e kishte kundërshtuar superioritetin etik të mënyrave të vjetra aristokrate të sjelljes, që ajo i shndërroi në çështje privilegjet shoqërore.

Parizianët përdorën inteligjencën e tyre të shkolluar në Angli, për të zëvendësuar një ideal të vjetër me një të ri, ashtu si dhe instinktin e tyre francez që ishte produkt i këtij zëvendësimi, për të ndërtuar parimin e barazisë në kuptimin e tik të fjalës. Ky ishte kuptimi i ri i shprehjes “shoqëri njerëzore:” barazi për të gjithë njerëzit dhe forca universale imponuese e një ideali moral, mbështetur jo te gjaku dhe tradita, por te natyra dhe arsyeja.

“Klasa,” nga ana tjetër, është një koncept pastërtisht ekonomik dhe në vitet 1850, zuri vendin e konceptit etik dhe politik të “borgjezisë” së 1789-tës. Ideali i pushteteve³⁸ u bë interesi klasor. Ndodhi vetëm në Angli

³⁸ Këtu vlen të bëjmë një sqarim lidhur me termin “estate.” Estate në gjuhën angleze por dhe në tekstin tonë, vjen në dy kuptime. Së pari ka kuptimin e pushtetit, ku konkretisht përmendet ai i katërt, që në kohën e autorit përbëhej nga elitat e së ashtuquajturës shoqëri civile, ndërsa më vonë, pas Luftës së Dytë Botërore, është konsoliduar si media, pra një klasë e lirë individësh që përmes fjalës së shkruar dhe artikulluar në publik, fiton një territor të atillë sa meriton të konsiderohet pushtet i katërt, krahas tre pushteteve klasike, atij ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor. Krahas kësaj, përdoret edhe si gjendje pasurore ose si bollek i zotëruar nga një klasë e caktuar, ku në rastin tonë përmenden borgjezia dhe proletariati, dy koncepte marksiste. Prandaj dhe vende-vende duhen

që klasat kishin kohë që ishin shtresëzuar në përputhje me pasurinë e zotëruar. Klasa e mesme përbëhej nga ata të cilët mbaheshin nga puna e tyre, pa qenë të varfër. Klasa e lartë ishte e pasur pa punuar. Ndërsa klasa e ulët punonte dhe ishte e varfër. Por megjithatë, në Prusi ishte rangi, thënë ndryshe, shkalla më e madhe apo më e vogël e urdhërimit dhe bindjes, kriteri që bënte dallimin midis klasave.

Përveç fshatarësisë, në të ekzistonte edhe një klasë nëpunësish civilë, që do të thotë, më shumë kishte një përbashkësim funksionesh sesa një dallim ekonomik. Në kontrast me këtë, Franca moderne dallon si pasojë e mungesës së klasave të vërteta. Kombi francez është një masë e çrregullt ku mund të dallojmë individë të pasur dhe të varfër, në një kohë kur dy klasa të tilla ende nuk janë shfaqur. I gjithë kombi është një klasë e vetme, jo aq rigorozisht e shtresëzuar sa kombet gjermanike, por megjithatë unik dhe i bashkuar.

Kësisoj, Marksi ishte një mendimtar ekskluzivisht anglez. Sistemi i tij dy-klasor, buron nga situata e një populli tregtar, që bujqësinë e tij e sakrifikoi për biznesin e madh dhe që kurrë nuk kishte zotëruar një trupë kombëtare nëpunësish civilë, me një vetëdije të theksuar, thënë ndryshe prusiane, rreth gjendjes pasurore. Në Angli ishin vetëm “borgjezia” dhe “proletariati,” agjentë aktivë dhe pasivë në çështjet tregtare, hajdutë dhe të vjedhur – i gjithë sistemi ishte shumë i ngjashëm me

përkthyer ndryshe, ngase jo gjithmonë përçojnë të njëjtin kuptim. Por nëse në gjuhën angleze kuptimet dhe nuancat e ndryshme janë të qarta, në gjuhën shqipe druajmë se jo, ndaj e pamë të arsyeshme sqarimin në fjalë. (Shënim i përkthyesit)

botëkuptimin viking. Të transferuara në sferën e idealeve politike prusiane, këto koncepte nuk bartnin kurrfarë kuptimi.

Marksii asnjëherë nuk do të kishte qenë i aftë ta dallonte skllavërinë industriale britanike nga parimi që shfaqet nga ideja e “të gjithëve për të gjithë,” përmes së cilës çdo individ është një shërbëtor i shtetit total, pavarësisht rangut apo pozicionit që posedon. Ai kishte një përfytyrim tërësisht të jashtëm rreth Prusianizmit – organizim, disiplinë, bashkëpunim, që të gjitha gjëra që varen nga një klasë e vetme; një strukturë teknike, pra socializmi – dhe ua paraqiti punëtorëve të një “shoqërie” të llojit anglez si një armë dhe një qëllim, duke i nxitur të ishin vikingë të mirë dhe të shkëmbenin rolet e hajdutëve me të vjedhurit, që të shpronësonin shpronësuesit. Dhe të gjithë këtë e përmblodhi në një program egoist, i cili bënte thirrje për ndarjen e plaçkës pas fitores.

Përkufizimi më i mirë dy klasave ende është një siklet logjik. Brenda sistemit marksist, “borgjezia” do të thotë diçka tërësisht të ndryshme nga ajo çfarë ajo nënkuptonte për Rusoin. Është një gjë nëse termi përdoret në kontekstin e grupeve të privilegjuara në Epokën e Feudalizmit dhe një gjë tjetër nëse zbatohet për masat e punëtorëve urbanë.

Për rrjedhojë, nëse kemi parasysh tre pushtetet e 1789-tës, pushteti i katërt nuk ekziston, ndërsa nëse marrim në shqyrtim pushtetin e katërt sot, nuk ekziston i pari dhe i dyti. Sipas vlerësimit që bënte Sieyesi, kleri përbëhej nga një kontigjent prej 80.000 njerëzish, aristokracia prej 120.000, ndërsa pushteti apo shtresa e

tretë e shoqërisë, kishte në gjirin e saj rreth 25 milion banorë. Sipas këtij kuptimi, grupi i fundit përbënte “popullin.” “Borgjezia” donte të thoshte “të gjithë bashkë.” Madje edhe fshtari francez është një “borgjez.” Por megjithatë, pushteti apo shtresa e katërt, është një pakicë dhe është e vështirë ta veçosh nga të tjerët. Linjat dalluese janë të ndryshme, në varësi të zejtarëve, punëtorëve industrialë, proletarëve apo masave. Ka raste kur grupi në fjalë është i përcaktuar, por më shpesh ai edhe ndihet, që nuk ndryshon pothuajse fare nga “borgjezia.” Edhe një herë, kemi të bëjmë me konceptin e “të gjithëve bashkë,” me përjashtim të nëpunësve të biznesit.

Shtresa e tretë, në thelb ishte një koncept negativ.³⁹ Ajo u shpik për të shprehur idenë se nuk duhet të kemi më fare shtresa. Por shtresa e katërt e anulon këtë përlllogaritje. Një grupi profesional ajo i vesh rëndësinë më të madhe në jetën e shoqërisë. Zanafillën e ka që në 1789-tën dhe sot e paraqit veten si një shtresë e privilegjuar. Kjo është ajo çfarë nënkupton në thelb koncepti i diktaturës dhe proletariatit: dominimin e shoqërisë nga një klasë që nuk është aspak e sigurtë rreth superioritetit të saj numerik. Sigurisht që kjo do të thotë se qëllimi klasor marksist, në realitet është një karikaturë e idealit të vjetër shtresor. I gjithë konstrukti marksist nuk është asgjë më shumë sesa literaturë dhe nuk ka të bëjë aspak me gjakun apo racën. Por çmenduritë e Revolucionit Gjerman, “punëtorët e sovjetëve” si një dhomë e lartë, ngritja e punëtorëve në pozicionin e “zotërinjve” anglezë nëpërmjet një greve që garantonte

³⁹

Rënia e Perëndimit, II, fq. 354.

pagimin e vazhdueshëm të rrogës – e gjithë kjo ka demonstruar, si edhe në kohët e Kromuellit dhe Roberspirit, se letërsia mund të nxisë, së paku përkohësisht, një realitet grotesk.

Moraliteti marksist është gjithashtu i një origjine angleze. Në çdo fjali të mundshme, Marksizmi zbulon se proceset e të menduarit nga të cilët ai buron, ishin teologjike dhe jo politike. Teoria e tij ekonomike është produkt i një qëndrimi themelor moral, kurse pikëpamja materialiste e historisë është thjesht kapitulli përfundimtar i një filozofie që i ka rrënjët te Revolucioni Anglez, nuancat biblike të së cilës kanë mbetur dominuese në mendimin anglez.

Kjo është arsyeja se përse konceptet bazike të Marksit ndihen si alternativa morale. Fjalët “socializëm” dhe “kapitalizëm” janë terma për të mirën dhe të keqen e kësaj feje jofetare. “Borgjezia” është djalli, përftuesi i rrogës është engjëlli i një mitologjie të re dhe ne na mjafton të krahasojmë rrugët vulgare të *Manifestit Komunist* për të kuptuar prapa maskës letrare Krishtërimin e të Pavarurve. Evolucioni shoqëror është “vullneti i Zotit.” “Qëllimi përfundimtar,” në një epokë më të hershme, ishte shpëtimi i përjetshëm; ndërsa “kolapsi i qytetërimit borgjez” ishte traditë të quhej Dita e Gjykimit.

Marksia ia doli që të predikonte përbuzje për punën. Ndoshta këtë ai nuk e kuptoi as vetë. Puna – puna e gjatë, e vështirë, e mundimshme – për të është një fatkeqësi, ndërsa fitimi pa lodhje, një bekim. Prapa përçmimit tipik anglez për njeriun që punon nga puna e duarve të tij, mund të ndiejmë instinktin e Vikingut, profesioni i të cilit është pirateria dhe jo puna e shpatullave të veta. Për këtë arsye, punëtori i punës

fizike në Angli është një skllav më shumë se kudo tjetër. Dhe kjo skllavëri është morale; ai ndjen se profesioni i tij e përjashton që ai të jetë bartës i titullit të “zotërisë.” Konceptet e “borgjezisë” dhe “proletariatit” reflektojnë parapëlqimin tipik anglez për të bërë biznes dhe jo punë fizike.⁴⁰ I pari është një bekim, ndërsa e dyta një fatkeqësi; njëra fisnike, tjetra e ulët. Por me urrejtjen e tyre, fatkeqët thonë: “Biznesi është një profesion i keq, ndërsa puna fizike një profesion i mirë.”

Ky është shpjegimi për qëndrimin intelektual që i hapi shtegun kritikës shoqërore të Marksit dhe që e ka bërë atë kaq katastrofik për socializmin e vërtetë. Natyrën e punës ai e njihte vetëm nga perspektiva angleze, si një mënyrë përmes së cilës mund të pasurohesh, si një mjet të cilit i mungon çdo thellësi morale.

Vetëm suksesi dhe paraja, shenjat e dukshme dhe të prekshme të hijeshisë së Zotit, bartnin një kuptim etik. Anglezi nuk zotëron as përfytyrimin më të vogël të punës së vështirë. Për të, puna është diçka poshtëruese, një domosdoshmëri e shëmtuar. Mjerë ai shpirt i gjorë që nuk posedon asgjë tjetër përveç punës, që nuk zotëron asgjë përveçse punës e gjithnjë e më shumë punë, por që mbi të gjitha nuk do të zotërojë kurrë ndonjë pasuri në të ardhmen! Nëse Marksi do ta kishte kuptuar kuptimin e punës prusiane, e veprimtarisë për hir të vetvetes, e

⁴⁰ Por sigurisht jo për punën *mendore*. Meqenëse intelektual i anglez ishte për definicion ose një Tor ose një Vig, atij i ishte dashur të zgjidhte midis këtyre dy palëve të reja ekonomike. Duke qenë një “zotëri,” ai është natyrshëm i prirur të aspirojë për vepra të mëdha biznesi.

shërbimit në emër të totalitetit, për “të gjithë bashkë” dhe jo për veten e tij, e detyrës që fisnikëron pavarësisht llojit të punës së kryer – nëse pra do të kishte qenë i aftë t’i kuptonte këto gjëra, ndoshta Manifesti i tij nuk do të ishte shkruar kurrë.

Në këtë çështje ai u ndihmua nga instinkti i tij çifut, të cilin ai e përmend edhe vetë në esenë që shkroi për çështjen çifute. Mallkimi i punës fizike që përmendet në fillimin e Zanafillës, ndalesa e njollosjes së Sabatit nëpërmjet punës – këto gjëra e bënë atë që patosin e Testamentit të Vjetër ta perceptonte me ndjeshmërinë angleze.

Nga këtu lind dhe urrejtja që ai kishte për ata të cilëve nuk iu duhej të punonin. Socializmi i Fihthes, të tillë njerëz do t’i akuzonte për përtaci, do t’i konsideronte si të papërgjegjshëm, si bishtnues dhe parazitë të tepërt. Por instinkti marksist i ka *zili*. Ata janë shumë të pasur, ndaj dhe ndaj tyre duhet të revoltohemi. Proletariatit e tij Marks i kishte mbujtur me një përbuzje për punën.

Dishepujt e tij fanatikë dëshironin që ta shkatërronin të gjithë kulturën, me qëllim që ta ulnin sasinë e punës së domosdoshme. Martin Luteri veprimtarinë e punës fizike e vlerësonte si diçka që e kënaq Zotin; Gëte gjithashtu, shkroi për “detyrat e ditës.” E megjithatë Marksi ëndërronte për proletarin feak,⁴¹ i cili çdo gjë e siguronte

⁴¹ Në mitologjinë dhe kulturën homerike, feakët ishin banorë të ishullit të Korfuzit dhe ishin të shquar për Hedonizmin e tyre, term që në qytetërimin grek përkufizon një popull të dhënë pas

pa kurrfarë përpjekjeje. Ky është, tek e fundit, kuptimi i Shpronësimit të të Bekuarve. Dhe për sa i përket instinktit anglez, ai kishte të drejtë. Atë çfarë anglezi e quan lumturi – suksesin në biznes që të shpëton nga puna fizike dhe të bën zotëri – është diçka e mirë për të gjithë *anglezët*. Për ne është diçka e pahijshme, pa kurrfarë dallimi, si për turmat ashtu dhe për individët.

Ky lloj etike formësoi të menduarit e tij ekonomik. Është shkolla e Mançesterit ajo që del në pah ngado. Është ekzaktesisht si të menduarit e Cobdenit,⁴² i cili në të njëjtën kohë ishte duke udhëhequr drejt fitores teorinë vige mbi tregtinë e lirë. Marksi iu kundërvu formës së kapitalizmit që justifikimet e veta i nxirrte nga Bentami dhe Shaftesburi dhe që ishte formuluar nga Adam Smithi. Por duke qenë se ai ishte thjesht një kritik, për më tepër negativ dhe jokrijues, parimet e tij i nxorri nga e njëjta gjë që ishte duke luftuar.

Për të puna ishte një komoditet dhe jo një detyrim. Kjo është bërthama e ekonomisë së tij politike. Etika e tij ishte etika e biznesit të madh. Jo se biznesi në vetvete është joetik, por mund ta lexojmë fare qartë mendimin e tij se punëtori është një budalla që nuk përfshihet në të. Dhe punëtorët e kanë kuptuar në këtë opinion. Beteja për rroga më të larta u shndërrua në një investim spekulues: punëtori tani ishte tregtari që po shiste produktin e tij,

kënaqësive të prekshme dhe sensuale të kësaj bote. (Shënim i përkthyesit)

⁴² Riçard Kobden, politikan radikal dhe liberal anglez i shekullit të nëntëmbëdhjetë. Karrierën e tij e nisi si një prodhues i rëndësishëm dhe më pas u bë antar i parlamentit anglez, duke u reshtuar në radhët e partisë Vige.

pra punën. Hileja rreth tezës së famshme të “mbivlerës” së Marksit, është se ajo u konsiderua si plaçkë që mund të merrej nga tregtarët e suksesshëm prej dyqaneve të kundërshit. Ajo nuk do t’i paraqitej atij aspak. Kësisoj egoizmi klasor u shndërrua në një parim universal.

Punëtorët jo vetëm dëshironin të bënin biznes, por ata dëshironin një pjesë të mirë të të gjithë tregut. Marksisti i vërtetë është armiqësor ndaj shtetit dhe nisur nga të njëjtat arsye si edhe Vigët: ai e pengon atë në ushtrimin e pamëshirshëm të interesave private të biznesit. Marksizmi është kapitalizmi i klasës punëtore. Le të marrim për shembull në shqyrtim Darwinin, i cili për Marksian ishte po aq i rëndësishëm sa Maltuni dhe Kobdeni.

Në tërësi biznesi, apo më gjerësisht të themi tregtia, është konceptuar si lufta për ekzistencë. Në industri, punëdhënësi përfshihet në tregti përmes komoditetit të “parave,” ndërsa punëtori të njëjtën gjë e bën nëpërmjet komoditetit të “punës.” Marksi dëshironte që kapitalin ta privonte nga e drejta e fitimit privat, por e vetmja gjë që ai mund të mendonte se mund ta zëvendësonte këtë, ishte e drejta e punëtorit për të përfutur një fitim privat. Kjo mund të jetë josocialiste, por është tipike angleze.

Por Marksi u bë një anglez i mirëfilltë edhe në një tjetër kuptim: në mendjen e tij shteti nuk ekzistonte. Ai mendonte nga perspektiva e mungesës së një shteti, thënë ndryshe kur në themel të çdo gjëje ishte “shoqëria.” Njësoj si praktika parlamentare në Angli, edhe bota e tij ekonomike funksionon si një sistem dy-partiak me asnjë autoritet që qëndron sipër partive.

Brenda skemës së tij, mund të ekzistojnë vetëm dyluftime dhe jo arbitraritet, vetëm fitorja apo disfata, vetëm diktatura e njërës nga dy partitë. *Manifesti Komunist* bën thirrje për një diktaturë të partisë “së mirë” proletare mbi atë “të keqe” kapitaliste. Veç kësaj Marks si nuk shihte kurrfarë alternative tjetër.

Shteti socialist prusian ekzistonte përtej kësaj “të mire” dhe “të keqeje.” Në të është i gjithë populli, e përballë autoritetit të tij absolut dy partitë marksiste janë thjesht parti apo pakica që i shërbejnë mirëqenies së përbashkët. Nga një këndvështrim ngushtësisht teknik, socializmi është parimi i shërbimit publik. Në analizën përfundimtare, çdo punëtor nuk ka statusin e një biznesmeni, por të një nëpunësi publik, siç është çdo punëdhënës.

Në të ekzistojnë nëpunës publikë të sferës industriale, tregtare dhe ushtarake. Ky sistem u realizua në një mënyrë madhështore në kulturën egjiptiane dhe gjithashtu, paçka se krejt ndryshe, në Kinë. Ai paraqet formën e brendshme të qytetërimit politik perëndimor dhe tashmë ishte i dukshëm në qytetet gotike nëpërmjet bashkëpunimeve dhe zejeve profesionale. Një shprehje simbolike e këtij sistemi ishte katedralja gotike, në të cilën çdo element ishte një pjesë e domosdoshme e së tërës dinamike.

Marks si kishte të pamundur ta kuptonte këtë. Imagjinata dhe talenti i tij krijues shtrihej deri në shndërrimin e një “shoqërie” biznesmenësh privatë në një “shoqëri” punëtorësh privatë. Si një kritik ai ishte i jashtëzakonshëm, por u tregua i pafuqishëm në cilësinë e

natyrës krijuese. Kjo vërtetohet nga tërheqja e tij e vazhdueshme nga çështja se si ai e përfytyronte formën që qeveria do të merrte në këtë mekanizëm gjigand universal, ashtu si dhe nga lavdërimi diletant që i thurte “sistemit të këshillit” parizian të 1871-shit, i cili e kishte zanafillën në atmosferën e jashtëzakonshme të një qyteti nën rrethim, por që ishte gjithsesi i papushtet. Duke ndjekur Marks-in nuk mund të mësojmë kurrë se si të jemi kreativë.

Njeriu ose është ose nuk është i tillë. Demokracia Shoqërore e shekullit të nëntëmbëdhjetë prodhoi vetëm një personalitet krijues të një stili të madh, një politikan që nuk shkroi libra, por që dinte si të qeveriste: August Bebelin. Ai me siguri që nuk ishte antari më intelektual i partisë së tij, por nuk ka dyshim se ishte i vetmi organizator i saj.

Një drejtues i vërtetë ka më shumë nevojë të jetë i talentuar sesa të gëzojë një intelekt të madh, në kuptimin e drejtëpërdrejtë të kësaj fjale. Napoleoni nuk toleronte ndonjë “kalemxhi librash” në tarafin e tij.

Darvinizmi ekonomik i anglezëve, së bashku me sistemin marksist dypartiak, shpuri drejt përqafimit të armës natyrale për t’u përdorur në luftën midis tregtarëve të vërtetë dhe punëtorëve të tregtisë: grevës. Nëpërmjet kësaj të fundit, komoditeti i “punës” tërhiqet nga tregu dhe mundësia e blerësve.

Nëpërmjet grevës së kundërshtarit, pra përmes këtij bllokimi, komoditeti “i parave” gjithashtu tërhiqet. Një ushtri rezervë punëtorësh siguron tregun për blerësit e parave, ashtu siç një ushtri rezervë punëdhënësish

(mungesa e fuqisë punëtore) bën të njëjtën gjë për blerësit e punës. Greva është aspekti më josocialist i Marksizmit. Ajo është shenja klasike e origjinës së saj, në një filozofi të tregtisë në të cilën Marksi aderoi përmes instinktit dhe zakonisht.

Në shtetin *e vërtetë*, puna nuk është një komoditet por një detyrë kundrejt interesit të përbashkët dhe në të nuk ka kurrfarë përshkallëzimi – ky është stili prusian i demokratizimit – të vlerave etike në mesin e llojeve të ndryshme të punëve. Gjykatësi dhe dijetari “punën” e bëjnë njësoj si minatori dhe tornatori.

Në Revolucionin tonë Gjerman ishte të menduarit anglez ai që për punëtorin planifikoi të shpronësonte pjesën e mbetur të njerëzve, duke shtrydhur sa më shumë para të ishte e mundur nga një sasi sa më e vogël pune, ashtu si dhe duke e lëvduar këtë “komoditet” mbi të tjerët. Një ndër parakushtet e një greve është se popujt ekzistojnë vetëm në cilësinë e partive dhe jo të një shteti. Një tjetër ide marksiste, pra angleze, është ajo e negociatave të hapura për rritjen e rrogave, ashtu si dhe përcaktimi i paanshëm i hierarkisë së tyre, duke ndjekur suksesin e partisë proletare.

Sipas mënyrës prusiane të konceptimit dhe organizimit të gjërave, është shteti ai që përcakton pagat paanshmërisht për çdo lloj pune, duke e planifikuar kështu me shumë kujdes hierarkinë e të gjithë situatës ekonomike në çdo kohë të mundshme, në interes të të gjithë njerëzve dhe jo në interes të një profesioni të vetëm. Ky është parimi i hierarkisë së rrogave për nëpunësit civilë, i cili më pas zbatohet për të gjitha

profesionet. Ai përfshin ndalimin e grevës, sepse këtë të fundit ai e sheh si një instrument tregtar privat dhe armik ndaj interesave shtetërore. Pushteti për të përcaktuar hierarkinë e pagave i hiqet si punëdhënësit ashtu edhe punëtorit, duke u bërë kështu privilegj i këshillit të përgjithshëm ekonomik, e duke siguruar që çdo parti do të operojë brenda të njëjtave kufij të mirëpërcaktuar, njësoj siç duhet të vepronin në sfera të tjera të menaxhimit dhe praktikës së punës.⁴³

Për strukturat e lindura politike të njeriut prusian-socialist, Marksizmi është i pakuptimtë. Ky i fundit mund t'i mohojë apo ndoshta mund t'i dobësojë këto struktura, por si gjithçka tjetër është jetike dhe natyrale, ka për të rezultuar më e fortë se çdo teori. Skema e Marksit më së shumti familjare ndihet në Angli. Ajo është kuptuar më mirë sesa socializmi i vërtetë dhe fillimi aktual i armiqësive midis partive ekonomike e ka shpënë drejt fundit parlamentarizmin e stilit të vjetër.

Dy partitë e mirëqenies të themeluara nga klasa e lartë ishin të themeluara politikisht dhe në përgjithësi binin në ujdi sa i përket çështjeve ekonomike. Edhe kur në mesin e shekullit, gjatë etapave përfundimtare të parlamentarizmit klasik, konflikti u zhvillua mbi

⁴³ Mund të përfytyrojmë një sistem ku çdo punëtor, oficeri ushtarak dhe zyrtari administrative ashtu si dhe “punëtori,” mbajnë një llogari në një bankë shtetërore kursimesh, e cila përfton llogari të standardizuara nga institucionet e detyruara që të paguajnë rroga. Në këtë mënyrë, individi do të kishte në dispozicionin e tij një shumë të caktuar, e përcaktuar nga një shkallë standarde shpërndarjeje, bazuar në vitet e shërbimit dhe numrin e punëtorëve.

sistemin e tregtisë së lirë dhe Vigët dolën fitues, ndërluftuesit në të gjitha rastet llogaritë i bënë me vlerat dhe gjykimet tradicionale të drejtësisë.

Torët dhe Vigët dallonin vetëm në atë çfarë ata përkrahnin midis luftës etike apo infiltrimeve tregtare, midis kurajos apo dinakërisë piraterike. Por megjithatë, sot një antitezë ekonomike ka shkaktuar shfaqjen e dy partive të reja, ku njëra është e parasë dhe tjetra e punës, dhe kjo betejë nuk mund të zhvillohet më nëpërmjet metodave parlamentare. Çështja që shtrohet për zgjidhje nuk është më një formalitet; tashmë është diçka që ka të bëjë me gjëra konkrete. Dhe për aq kohë sa anglezët nuk kanë vullnetin për t'i dorëzohen parimit të huaj të shtetit në cilësinë e një autoriteti të paanshëm, rezultati i vetëm do të jetë shtypja e plotë e njëres partie politike nga tjetra.

Në veprën e tij Marks i kishte parasysh imazhin industrial të Anglisë, një imazh që ishte vërtet shumë skematik dhe që shihej nga një perspektivë vërtet e çuditshme, të cilin përmes një ndryshimi të shpejtë të fokusit e shtriu nëpër të gjithë historinë. Ai pretendoi se përllogaritjet e tij ekonomike ishin të vlefshme për të gjithë “shoqërinë njerëzore,” duke shtuar se në të vërtetë, ato ishin elementi i vetëm i rëndësishëm në të gjithë rrjedhën e historisë.

Duke vepruar kështu ai po i përngjante Darvinit, i cili nga ana e tij vijoi atë çfarë kishte bërë Maltusi dhe vlerësoi se teoritë e tij ishin të vlefshme për “të gjitha organizmat,” paçka se në realitet ato ishin zbatuar vetëm për antropoidët e zhvilluar në nivele të konsiderueshme. Sistemi i tij arriti absurditetin kur ai u përpoq që detaje të tilla si përzgjedhja, mimikrija dhe tipari i trashëgimisë, t’i shpjegonte në dritën e një përputhjeje që ato kishin me historinë e zhvillimit jetik të baktereve apo koraleve.

Pikëpamja materialiste e historisë, që kushtet ekonomike i përkufizon si “shkak” (në kuptimin fizik të fjalës) dhe fenë, ligjet, zakonet, artin dhe shkencën si “pasojë,” nuk ka dyshim se gëzonte aspektet e saj bindëse në këtë periudhë të vonë të kulturës perëndimore, ngase ajo tenton të joshë dhe t’i bëjë thirrje mendësisë jofetare dhe të patraditë të pjesës urbane të popullsisë. Dhe jo sepse kushtet ekonomike janë në fakt një “shkak,” por sepse arti dhe feja janë shndërruar në entitete të zbrazëta, të vdekura dhe të jashtme dhe se tashmë ekzistojnë në agoni e sipër si një hije e zbehtë e

formës së vetme të zhvilluar në mënyrë të fuqishme që identifikon epokën tonë. Që të jemi sa më të saktë, kjo gjendje është simptomatikusht angleze; nocioni i fesë si diçka “hipokrite, e pavlerë dhe e tepërt” dhe e artit si “komoditet” për klasën e lartë dhe si lëmshë për të ultën (“arti për masat”) e ka bashkëshoqëruar stilin anglez të jetesës gjatë depërtimeve që ai ka pasur nëpër vende të tjera.

Hegeli qëndron lart ndërsa Marksi poshtë nivelit të aktualitetit historik. Harrojeni për një moment metafizikën e Hegelit dhe keni për të zbuluar një mendimtar politik me një sens për realitetin që në filozofinë moderne nuk ka të ngjashëm. Si një “prusian” për nga zgjedhja intelektuale, shtetin ai e vendosi në qendër të vizionit të tij jashtëzakonisht të thellë dhe pothuajse Gëtean të zhvillimit ekonomik, kurse Marksi, anglezi i radhës sipas zgjedhjes që bëri, rolin qendror në teorinë e tij darviniste dhe mekanistike të “evolucionit” historik (këtë ai do ta quante “progres”) ia veshi jetës ekonomike.

Sipas Hegelit shteti është forca krijuese e historisë dhe kjo e fundit do të thotë politikë. Ai asnjëherë nuk e përdori termin “shoqëria njerëzore.” Zyrtarët e lartë shtetërorë të brezit të Bismarkut ishin kryesisht hegelianë. Marksi, nga ana tjetër, konceptoi historinë pa shtet, si një arenë për partitë ndërluftuese, si një konflikt i interesave ekonomike private. Koncepti materialist është koncepti anglez i historisë; ai pasqyron fytyrën e atij kombi të pavarur vikingësh dhe biznesmenësh.

Por parakushtet intelektuale dhe shpirtërore për këtë mënyrë të menduari nuk ekzistojnë më. Shekulli i nëntëmbëdhjetë ishte shekulli i shkencave natyrore; ndërsa shekulli i njëzet i përket psikologjisë. Ne nuk besojmë më në fuqinë e arsyes mbi jetën. Ne ndiejmë se është jeta ajo që e kontrollon arsyen. Familjariteti me mënyrat e qenieve njerëzore, për ne është më i rëndësishëm sesa idealet e përgjithshme dhe abstrakte.

Ne e kemi humbur optimizmin tonë dhe jemi bërë skeptikë. Ajo çfarë na shqetëson nuk është ajo çfarë *duhet* të jetë, por çfarë *do të jetë*. Në vend që të jemi skllëvër të idealeve, ne dëshirojmë që të jemi të aftë të kontrollojmë realitetin.

Logjika e shkencës natyrore, lidhja e shkakut me pasojën, ne na duket sipërfaqësore; e vetmja gjë që mund të testojë thellësinë e ndryshimit historik është logjika e ekzistencës organike: Fati dhe një Instinkt që mund të ndihet dhe shihet si një agjent i gjithëfuqishëm i procesit historik.

Marksizmi është një ideologji. Kjo është qartazi e dukshme nga mënyra se si ai ndan historinë, një teknikë kjo e përqafuar nga materialistët pasi ishte zbehur forca e besimit të krishterë. Për ta, udha evolucionare kalon nga antikiteti në Mesjetë dhe më pas drejt kohëve moderne, ndërsa në fund kemi për t'u përballur me idealin e përsosur marksist, me Parajsën tokësore.

Është e pakuptimtë të përpiqemi ta kundërshtojmë këtë përfytyrim. Detyra jonë është që njeriut modern t'i japim një perspektivë të re, e cila domosdoshmërisht ka për të prodhuar një përfytyrim të ri. Jeta nuk ka

“qëllime.” Njerëzimi nuk ka “qëllime.” Ekzistenca e këtij universi, në të cilin ne njerëzit luajmë vetëm një episod të papërfillshëm në këtë planetin tonë të vogël, është një gjë tejet madhështore për t’u shpjeguar nga sloganë aq të shpëlarë si ai i “lumturisë për pjesën më të madhe të njerëzve.” Madhështia e dramës universale fshihet në paqëllimshmërinë e saj. Gëte ishte i vetëdijshëm për këtë. Ajo çfarë ne kemi detyrë të bëjmë, është që kësaj jete që na është dhënë t’i japim kuptimin më madhështor të mundshëm, ashtu siç duhet të mbushim me kuptim edhe realitetin që na rrethon dhe Fatin që na ka vendosur këtu. Duhet të jetojmë në një të atillë mënyrë që të na bëjë krenarë për çfarë jemi. Duhet të veprojmë në një mënyrë që disa prej nesh të mund të jetojnë në procesin e realitetit që po përparon drejt përfundimit eventual. Ne nuk jemi “qenie njerëzore *an sich*.”⁴⁴

Ky ishte një faktor në ideologjinë e së djeshmes. “Kozmopolitanizmi” është një fjalë e mjerë. Ne jemi persona të një shekulli të caktuar, një kombi të caktuar, një qarku të caktuar, një lloji të veçantë. Këto janë kushtet e domosdoshme nën të cilat mund t’i japim kuptim dhe thellësi ekzistencës sonë, duke qenë pra *veprues*, edhe nëse *veprojmë* qoftë dhe me fjalë. Sa më shumë që e mbushim sferën brenda këtyre kufijve të dhënë, aq më i madh ka për të qenë ndikimi ynë. Platoni ishte një athinas, Çezari një romak, Gëte një gjerman. Ajo çfarë ata ishin është *para së gjithash* arsyeja e rëndësisë së tyre universale dhe akohore.

⁴⁴ Siç kjo kuptohet apo merret e mirëqenë. (Shënim i përkthyesit)

Është duke qenë të vetëdijshëm rreth zotërimit të kësaj diturie që sot, në mesin e Revolucionit Gjerman, ne mund të dalim në përfundimin se Marksizmi dhe socializmi janë dy forca në kundërvënie me njëra-tjetrën. Socializmi, thënë ndryshe, Prusianizmi siç ai ende nuk është kuptuar, është një njësi reale e rendit më të lartë.

Ndërsa Marksizmi është letërsi.

Letërsia mund të dalë mode; realiteti ose pushton ose vdes. Kritikën socialiste siç ajo dëgjohej nëpër konventat ndërkombëtare, mund ta krahasojmë vetëm me një fakt të vetëm socialist, me partinë e August Bebelit. Shprehja popullore rreth ideve që bëjnë historinë, kur ato kuptohen siç duhet, nuk është asgjë përveç përgjërimit të veçantë që shprehin thashethemet letrare. Idetë nuk mund të shprehen. Ato një artist mund t'i shohë, një mendimtar mund t'i ndiejë, një burrështetas apo një ushtar mund t'i bëjë reale.

Te njeriu idetë vetëdijësohen vetëm përmes gjakut – në mënyrë instinktive, jo përmes një përsiatjeje abstrakte. Ekzistencën e tyre ato e bëjnë të njohur nga mënyra e të jetuarit të popujve, që është simbolizmi i veprave dhe arritjeve. Dhe nëse popujt janë apo jo të vetëdijshëm rreth tyre, në mënyrë të saktë apo të rreme, kjo është një gjë pa ndonjë rëndësi të madhe. *Jeta* është e para dhe e fundit për nga rëndësia dhe ajo nuk ka as sistem, as program dhe as arsye.

Ekziston për dhe në vetvete dhe rregullsia e thellë përmes së cilës ajo manifestohet mundet vetëm të ndihet ose përfytyrohet – dhe më pas ndoshta edhe të përshkruhet, por jo të analizohet sipas logjikës së të

mirës dhe të keqes, të drejtës dhe të padrejtës, të dëshirueshmes dhe të padëshirueshmes.

Për këtë arsye Marksizmi nuk është një ide e vërtetë. Në një formë racionale, thënë ndryshe arbitrare, ai kombinon strukturat dhe simbolet e dukshme të dy ideve. E gjithë metoda e mendimit marksist është një gjë e momentit. Është efikase sepse çdo popull konceptet e tij i ka përdorur si armë. Nëse janë kuptuar saktë apo jo, kjo nuk ka rëndësi. Ato janë efikase për shkak të tingullit të fjalëve dhe forcës së oratorisë që i kanë bërë njerëzit të besojnë në *diçka*. Edhe një herë pra, ajo në çfarë ata kanë besuar është ideja e pandryshueshme e vetë jetëve dhe gjakut të tyre. Sot Marksizmi është duke u shembur në mes të orgjisë të zhurmshme të përpjekjes së vet për t'u bërë realitet. Me vitin 1918 *Manifesti Komunist* ka zënë vend si një kureshtje letrare, njësoj si *Kontrata Shoqërore* pas 1793-shit. Socializmi instinktiv, shprehja e mënyrës së Vjetër Prusiane të jetesës, ia doli edhe një herë që në një qëndrim letrar në Angli të zbehej në një teori anti-angleze; ndërsa tani është në kthim e sipër drejt vetëdijësimit rreth origjinave dhe kuptimit të saj të plotë.

V. Internacionalja

22

Në kohët që do të vijnë, njerëzit do ta shohin duke u zbavitur atë gjë që quhet “socializëm ndërkombëtar” dhe që dominon imazhin politik të botës sot që po flasim. Ajo çfarë ne jemi duke dëshmuar në të vërtetë, është një Internationale e koncepteve, thënë ndryshe është Marksizmi si një paketë sloganesh të zbrazëta.

Ndjenjat e solidaritetit midis punëtorëve të të gjithë kombeve ata do të jenë të aftë t’i ngjallin vetëm për disa dekada dhe me shumë më pak intensitet sesa kuvendet e zhurmshme socialiste dhe thirrjet publike të karakterizuara nga një vetëbesim i tepruar. Në të vërtetë ky solidaritet kufizohet vetëm në bindjen se ai ekziston dhe në faktin se një lëvizje në një shtet të caktuar shpesh i bën thirrje një lëvizjeje të një shteti tjetër.

Por është karakteristikë e një qytetërimi kaq të tejngopur me literaturë si ky yni, që udhëheqësit e masave, të cilët jetojnë në një mjegull të përhershme teorike, mund të shndërrohen gjithsesi në instrumente të realiteteve të fuqishme. Përfaqësuesit e mënyrave angleze, franceze, gjermane dhe ruse të jetës, mbledhen së bashku nëpër kuvendet pseudo-politike pa i kuptuar aspak ndjenjat dhe dëshirat e njëri-tjetrit, dhe përpiqen të bien në ujdë për një numër minimal parimesh, të cilat ata i gjykojnë si mbështetëse të së njëjtës kauzë.

Se sa hollësisht është shtresëzuar instinkti ynë kombëtar nga këto realitete intelektuale, u bë e qartë në gushtin e vitit 1914, kur ato befasisht avulluan në

rrjedhën e një dite të vetme nën nxehtësinë e pasioneve natyrale dhe jointelektuale. Socializmi është diçka e ndryshme në çdo vend. Ekzistojnë po aq lëvizje punëtore sa edhe raca jetësore në kuptimin shpirtëror të fjalës, dhe menjëherë sapo e kanë përfunduar kërkimin e tyre për gjërat që i urrejnë bashkarisht, këto lëvizje kuptojnë se njëra-tjetrën e urrejnë në mënyrë po aq të pamëshirshme sa urrejnë dhe njerëzit që përfaqësojnë. Ekzistojnë Jakobinë të Kuq dhe Puritanë të Kuq; ekziston Versaja e Kuqe dhe Potsdami i Kuq. I njëjti hendek që ndan Shoun dhe Bebelin, ndan dhe Rodin dhe Bismarkun. Që të gjithë këta i kanë qepur kostumet e tyre nga i njëjti stof i vjetër teorik.

Në Luftën Botërore nuk ishin vetëm Aleatët që luftuan kundër Gjermanisë, por gjithashtu edhe pseudo-socialistët e kombeve Aleate që iu kundërvunë socializmit të vërtetë prusian të Gjermanisë. Duke tradhtuar personin e Kajserit, socializmi i vërtetë tradhtoi veten, origjinat, kuptimin dhe pozicionin e tij në botën socialiste. August Bebeli me siguri që do t'i kishte paraprirë dhe do ta kishte parandaluar këtë; pasardhësit e tij më të dobët, thjesht nuk e kuptuan këtë.

Tani ata udhëtojnë drejt kuvendeve të rreme dhe praktikisht nënshkruajnë Traktate Versaje nëpër të gjithë fjalimet e tyre. Armiku më i rrezikshëm i socializmit prusiano-gjerman nuk është kapitalizmi gjerman, i cili një herë e një kohë bartte tiparet e shpallura socialiste dhe që vetë socializmi i ka imponuar në sferën angleze që prej 1917-tës.

Anglicizimi ndoshta më gjerësisht u nxit nga dobësimi i sindikatave tona të organizuara mjeshtrërisht, ashtu si dhe nga prezantimi i këshilleve lokale të administrimit, të cilat në të vërtetë janë një front për mësimet parlamentare liberale të socialistëve tanë shumicë-adhurues.

Jo, armiku më i keq i socializmit prusian nuk është kapitalizmi gjerman; është ajo çfarë po bëhet në emër të socializmit në atdheun e kapitalizmit. Vizioni i qartë i Fridrih Engelsit zbuloi se socializmi i vetëm i vërtetë është socializmi gjerman. Zëdhënësit e vërtetë të socializmit e kanë harruar këtë dhe janë duke u përpjekur t'ia vërtetojnë këtë socialistëve Aleatë nëpërmjet një mospërfilljeje të ngjashme me atë të Mikaelit gjerman.

Socializmi i kryengritësve dhe sabotatorëve francezë, në realitet është thjesht një emocion i *revanshit* shoqëror që gjeti Klemensonë e vet që në fillimet e kryengritjeve të Komunës së Parisit. Socializmi i Anglisë është një version i rishikuar i kapitalizmit.

Një *Weltanschauung*⁴⁵ socializmi ka qenë vetëm në Gjermani. Francezi mbetet një anarkist, ndërsa anglezi një liberal. Punëtorët francezë dhe anglezë, para së gjithash veten e shohin si francezë dhe anglezë, dhe vetëm pas një rishqyrtimi, si mbështetës të Internacionales. Kurse punëtori prusian, i vetmi socialist i lindur,⁴⁶ në sytë e të tjerëve gjithmonë ka luajtur rolin e

⁴⁵ Botëkuptim, vizion, mënyrë jetese. E kemi sqaruar edhe më sipër në një tjetër shënim. (Shënim i përkthyesit)

⁴⁶ Në deklaratën e August Bebelit se Mynihu është qyteti i marsheve i lëvizjes Social-Demokrate gjermane, fshihet një kuptim i

budallait. Ai është i vetmi që e ka marrë seriozisht gjuhën pseudo-socialiste, njesoj siç profesorët gjermanë besonin në fjalimet e *Paulskirches*.⁴⁷ Punëtori prusian, i vetmi që mund t'i drejtohet partisë së tij si një krijim i mrekullueshëm, u bë dëgjuesi i nderuar i dërdëllisjeve të të tjerëve dhe ndihmoi në pagimin e grevave të tyre.

Një Internacionale e vërtetë është e mundshme vetëm si fitore e idesë së një race të vetme mbi gjithë të tjerat dhe jo si një përzjerje e të gjitha opinioneve të veçanta në një masë të pangjyrë. Le të kemi kurajon e skepticizmit tonë dhe ta flakim tutje ideologjinë e vjetër. Në histori e vërteta është që nuk mund të ketë kurrë pajtime.

Kushdo beson se mund të vuajë nga një terror kronik në mënyrat absurde se si gjërat ndodhin dhe është thjesht duke mashtruar veten nëse mendon se rrjedhën në fjalë mund ta kontrollojë nëpërmjet traktateve. Të gjitha konfliktet kanë vetëm një qëllim dhe ai është vdekja – vdekja e individëve, e popujve, e kulturave.

Vetë vdekja jonë ende shtrihet përpara nesh, në mugëtirën e errët të një mijë viteve të ardhshme. Ne gjermanët, të pozicionuar siç jemi në këtë shekull, të lidhur nga instinktet tona të lindura me fatin e

thellë. Konfirmimin e mendimit të tij ai do ta kishte dëshmuar edhe vetë, nëse do të kishte jetuar derisa të shihte karnavalin e “sovjetëve punëtorë dhe ushtarë” të 1918-tës.

⁴⁷ Kisha e Shën Palit është një ish kishë protestante në qytetin e Frankfurtit, që ka shërbyer si salla e kuvendit kombëtar. Simbolizmi i saj i rëndësishëm politik daton që në vitin 1848, kur Parlamenti i Frankfurtit mblodhi në të organin e parë të lirë dhe të zgjedhur legjislativ. (Shënim i përkthyesit)

qytetërimin faustian, brenda vetes kemi burime të pasura dhe të pashfrytëzuara, por gjithashtu edhe detyrime të jashtëzakonshme.

Për Internacionalen e re që sot gjendet në një proces të pakthyeshem përgatitjeje, ne mund të kontribuojmë me idetë e organizimit të përbotshëm dhe shtetit botëror; anglezët mund të sugjerojnë idenë e shfrytëzimit dhe trusteve të përbotshme; ndërsa francezët nuk mund të ofrojnë asgjë. Ne mund të japim garanci për idetë tona, jo me fjalime por me të gjithë ekzistencën tonë.

Ideja fisnike e socializmit të vërtetë qëndron apo bie me Prusianizmin. Kisha është e vetmja që ende mishëron idenë e vjetër spanjolle të universalitetit, si përkujdesësja dhe ndihmuesja e të gjitha kombeve nën krahun e Katolicizmit.

Që nga koha e perandorëve Hahonstaufenë, ne mund të dëgjojmë jehonat kërcënuese të një konflikti të jashtëzakonshëm midis një ideje universale politike dhe fetare. Por për momentin jemi duke dëshmuar triumfin e një ideje të tretë, atë të idesë vikinge: idenë e botës as si një shtet dhe as si një Kishë, por si një plaçkë lufte për piratët.

Internacionalja e vërtetë është imperializëm, është dominim i qytetërimin faustian, thënë ndryshe, i të gjithë tokës, nga ana e një parimi të vetëm formues, jo përmes paqes dhe kompromisit, por përmes pushtimit dhe asgjësimit. Prapa dhe kundër vetes, socializmi ka

kapitalizmin dhe ultramontanizmin,⁴⁸ ndaj dhe kemi tre forma të ndryshme të vullnetit socialist për pushtet: nëpërmjet shtetit, parave dhe Kishës. Ndikimi i tyre shtrihet nëpër të gjithë vetëdijen politike, ekonomike dhe fetare të botës perëndimore dhe secila kërkon që t'i nënshtrojë të tjerat nën vullnetin e saj.

Ato përfaqësojnë instinktin krijues të njeriut prusian, anglez dhe spanjoll, që daton që prej lartësive të ftohta të vetë kohëve tona primitive, nga njerëzit impulsivë të epokës gotike që pushtuan kënetat e tokave lindore me shpata dhe parmenda, kaluan Detin e Veriut me varkat e tyre të brishta dhe drejtuan kryqëzatat kundrejt moëve në jug të Pirenejve. Manifestimet gotike të tokave të Prusisë Lindore, Anglisë dhe Spanjës, karakterizohen nga një shpirt totalisht i ndryshëm krahasuar me atë të Francës. Këto instinkte janë më të fuqishme se çdo gjë tjetër dhe mund të mbijetojnë edhe pas popujve për të cilët kanë qenë simbolet e tyre të dukshme.

Shpirti romak ende mbizotëroi edhe në kohën kur romakët nuk ekzistonin më. Si një popull, shpirti i spanjës është i pafuqishëm, por si një Kishë ajo ende qëndron në këmbë duke gëzuar një forcë të pathyeshme. Këto pra janë realitetet që kuvendet që shpresojnë Internacionalen mendojnë se mund t'i lënë në hije nëpërmjet sloganeve të Karl Marksit.

⁴⁸ Ultramontanizmi është një konceptim politik brenda Kishës Katolike që e vë theksin mbi të drejtat e posaçme dhe fuqitë e Papës. (Shënim i përkthyesit)

Më i keqi nga këto slogane është komunizmi. Kritika e tij preku një çështje të një rëndësie të dorës së parë: pronën. Ky nuk është vendi për të diskutuar, qoftë edhe përciptazi, domethënien e jashtëzakonshme simbolike të një çështjeje aq të vështirë si ajo e marrëdhënieve midis pronës dhe martesës, pronës dhe idesë politike apo pronës dhe botëkuptimit. Mbi këto çështje, gjithashtu, secila nga këto kultura të mëdha ka folur me gjuhën e saj. Koncepti perëndimor i pronës është shumë i largët me atë të antikitetit, Indisë dhe Kinës. Prona është pushtet.

Njeriu faustian i kushton pak vëmendje zotërimeve të patundshme dhe jodinamike, si një “vlerë” në vetvete. Përkundrazi, ai e vendos theksin mbi pronën “prodhuese.” Kënaqësia sensuale e botës së vjetër që arrihej përmes grumbullimit të thesareve në mesin tonë është diçka e rrallë. Krenaria e pushtuesit modern, e tregtarit dhe kumarxhiut, madje edhe i grumbulluesit të veprave të artit, mbështetet mbi idenë se duke përfutur plaçkën e tij, ai ka fituar pushtet. Etja e spanjollëve për ar dhe uria e anglezëve për territore të reja, nxiteshin nga ideja se ata po synonin një pronë që krijonte akoma dhe më shumë prona dhe zotërime.

Në kontrast me këtë koncept dinamik të pronës, gjatë Rilindjes dhe në Paris mbizotëroi edhe një tjetër pikëpamje: ideali i pensionistit. Qëllimi i kësaj forme lakmie nuk ishte potenciali dinamik por thjesht kënaqësia; jo “gjithçka” por “mjaftueshëm;” jo vepra por “jetë.” *Contottierët*^{49,50} principatat dhe thesaret e

⁴⁹

Të mos harrojmë që Borxhiat ishin spanjollë.

oborreve i dëshironin me qëllim që ta shijonin sa më shumë kulturën e kohës së lirë të shekullit të tyre. Shtëpia bankare e familjes Medici, një ndër të parat në Evropë, nuk e kishte as për qëllim që të kontrollonte tregun botëror. Luigji i XIV-të gjeneralët dhe taksambledhësit e tij i shpinte nëpër popullsi për të siguruar mbështetje materiale për ekzistencën e tij olimpike si “Mbreti Diell.” Aristokratët francezë në Versajë ishin tërësisht të ngopur me botëkuptimin e Rilindjes. Kultura e tyre nuk ishte asgjë përveçse dinamike. Anglezët udhëtarë si Youngu, u habitën kur kuptuan, pikërisht përpara Revolucionit, se sa keq e menaxhonin pasurinë e tyre. Ata ishin të lumtur nëse thjesht e “kishin” atë dhe nëse *intendant-i*⁵¹ e shihte grumbullimin e shumave të domosdoshme për jetën pariziene.

Kjo aristokraci e shekullit të tetëmbëdhjetë paraqiste kontrastin më të mprehtë të aristokracive aktive, përvetësuese dhe ndërluftuese të Anglisë dhe Prusisë. Klasa e pasur në Francë motivohej vetëm nga dëshira për vetëruajtje, e madje edhe momentet e mëdha të historisë franceze, ishte e pamundur ta kontrollonte tregun botëror apo të përfshihej në një kolonizim të mirëfilltë.

Por *grandseigneur-i*⁵² i 1750-tës, si lloj, është pothuajse paraardhësi i *borgjezit* të 1850-tës, pensionisti

⁵⁰ Ishin udhëheqësit e një trupe mercenarësh, veçanërisht në Itali. (Shënim i përkthyesit)

⁵¹ Titull i dhënë një administratori apo zyrtari të lartë, veçanërisht në Francë, Spanjë, Portugali apo vende të tjera koloniale. (Shënim i përkthyesit)

⁵² Fisniku. (Shënim i përkthyesit)

i padëmshëm që ishte një kërcënim vetëm kur frymëzohej nga mendjemadhësia kombëtare dhe që emrin e të cilit Marksi nuk do ta kishte zgjedhur kurrë për të etiketuar shoqërinë kapitaliste.

“Kapitali” është shprehja e madhe që përshkruan pikëpamjen *angleze* mbi pronën. “Kapital” do të thotë energji ekonomike; ai është parzmorja që njeriu vesh përpara sesa të përfshihet në betejën për sukses. Në vend të fisnikut dhe pensionistit francez, ai çfarë ne shohim këtu është manjati i bursës, i naftës apo çelikut, kënaqësia e të cilit konsiston në ndjenjën e gjithëfuqishmërisë ekonomike.

Pronën ai e kupton si një pronë ekskluzivisht *private*. Ashtu siç ai e sheh atë, psherëtima e një njeriu të vetëm është e mjaftueshme për t’i shkaktuar tregut të zhytet në të gjithë botën; një telegram me tre fjalë mund të nxisë katastrofa në anën tjetër të planetit; dhe tregtia dhe industria e të gjithë kombeve janë një funksion i pasurisë së tij personale. Prona “private” – është e rëndësishme që këtë term ta kuptojmë në të gjithë kuptimin e tij dramatik.

Miliarderi kërkon liri absolute për të organizuar çështjet botërore nisur nga vendimet e tij private, duke mos pasur në mendjen e tij asnjë standard tjetër etik përveç suksesit. Kundërshtarët e tij ai i mund duke përdosur si armë të vetat pasurinë dhe spekulimet. Shteti dhe ushtria e tij janë trusti që ai zotëron dhe shteti politik është pak më shumë sesa agjenti që ai autorizon me luftra si ato në Spanjë apo Afrikën e Jugut, apo me traktate dhe negociata për paqe.

Qëllimi përfundimtar i këtyre mjeshtërive të vërteta është kthimi i të gjithë botës në një trust të madh. Për aq sa atij i intereson, e drejta formale e qytetarit mesatar ndaj pronës mund të mbetet e paprekur; ai mund të gëzojë liri të plotë që zotërimet e veta t'i dhurojë, shesë apo t'i lërë trashëgim siç e gjykon vetë të përshtatshme.

Por vlera ekonomike e zotërimeve të tij si kapital tregtar, është bërë për të lëvizur në disa drejtime të caktuara, nga një agjenci e largët qendrore që është tërësisht jashtë kontrollit të tij. Kësisoj manjati i parave është një zotërues pronash në një kuptim vërtet të veçantë. Popuj dhe kombe të tërë mund të jenë të detyruar të funksionojnë në përputhje me urdhrin e fshehtë dhe vullnetin e tij të gjithëfuqishëm.

Ky koncept i pronës, një demaskim për liberalizmin e biznesmenëve, është diametralisht në kundërvënie me pikëpamjen prusiane. Prusiani pronën nuk e sheh si një plaçkë private, por si pjesë të mirëqenies së përbashkët; jo si një mjet apo shprehje të fuqisë personale, por si begati të dhëna në mirëbesim, për administrimin e të cilave ai, si zotëruesi i tyre, është përgjegjës përpara shtetit.

Pasurinë kombëtare ai nuk e sheh si shumën e pasurive individuale private; përkundrazi, pasuritë private ai i sheh si funksione të potencialit total ekonomik të kombit të tij. Ne duhet t'i përsërisim në mënyrë të vazhdueshme fjalët e Frederikut të Madh: "Unë jam shërbëtori i parë i shtetit tim." Menjëherë pasi çdo individ qëndrimin e tij e konsideron të vetin, socializmi shndërrohet në një fakt. Nuk ka kontrast më të

mprehtë ndaj kësaj ideje sesa ajo e Luigjit të XIV-të, e shprehur në thënien e tij *faktike*: “Unë jam shteti.” Qoftë në fron apo nëpër rrugë, bota perëndimore nuk mund të konceptojë dot një kontrast më të potershëm sesa ai midis Prusianizmit dhe Jakobinizmit, midis instinktit socialist dhe atij anarkist. Kjo është baza për armiqësinë e pazhdukshme midis dy popujve tanë. Napoleoni e theksoi edhe në Shën Helenë: “Për Francën Prusia ka qenë një pengesë që nga koha e Frederikut dhe do të vazhdojë të jetë e tillë. Ajo ka qenë pengesa më e madhe e planeve që unë kisha për Francën.”

Sepse vërtet, mënyra në të cilën punëtori francez dëshirën e tij për hakmarrje e drejton ndaj klasës së pasur, është pikërisht e kundërta e socializmit; është komunizmi në kuptimin e tij të mirëfilltë. Edhe punëtori francez dëshiron të jetë një pensionist. Ai përçmon kohën e lirë të të tjerëve që nuk siguron për veten. Qëllimi i tij është një barazi e kënaqësisë, pra mundësi të barabarta e të përhershme si një pensionist.

Kjo është ideja që fshihet pas ekuacionit të famshëm dhe tipikisht francez të sajuar nga Prudhoni: “Prona është vjedhje.” Në Francë prona nuk do të thotë pushtet, do të thotë mundësi të përftuara për kënaqësi. Zotërimi të përbashkëta të të mirave dhe jo ndarje e mjeteve të prodhimit nëpër korporata, shpërndarje e pasurisë (“Gjithçka i përket të gjithëve”) dhe jo përdorim i forcave vlerëformuese për të krijuar truste – ky është ideali francez që qëndron në kundërvënien me atë anglez.

Ai është i mishëruar në utopinë socialiste të Fourierit: shpërbërje e shtetit në shumë njësi komunale

apo “falansteri,” qëllimi i të cilave është arritja e kënaqësisë më të madhe të mundshme me sasinë më të vogël të punës.

Robert Owen u përpoq ta formulonte si një lloj reforme të kapitalit dëshirën e klasës së ulët angleze për të përqaftuar për veten e saj idealin e pronës së klasës së lartë. Por do të ishte një nënvlerësim i madh i instinktit viking të mendonim se kapitali anglo-amerikan do të bëjë një hap pas në rrugën drejt dominimit ekonomik absolut të botës. Liria e pakufizuar personale dhe pabarazia natyrore e njeriut, bazuar mbi shkallë të ndryshme të talentit individual, janë bindjet themelore të besimit anglo-sakson.

Në vend të socializmit autoritar, miliarderi anglez apo amerikan aderon në një formë impresionuese të socializmit privat, në një program mirëqenieje të një shkalle të gjerë, i cili pushtetin personal e kthen në kënaqësi dhe nga pikëpamja morale e mposht përfituesin e burimeve të mirëqenies. Teknikat e dukshme për shpërndarjen e këtyre milionave janë një mbulim efikas i metodave të përdorura para së gjithash për t'i përftuar ato.

Ky është i njëjti qëndrim me atë të piratëve të vjetër të cilët, ndërkohë që darkonte në kështjellën e sapopushtuar, mbetjet e ushqimit ua hidhte të burgosurve: i dorëzuar i vullnetshëm i pronës e rrit vlerën e asaj çfarë mbetet. Çështja nëse akte të vullnetshme duhet të shndërrohen apo jo në një detyrë ligjore, është pika kryesore e mospajtimit midis partive ekonomike të së ardhmes në Angli dhe Amerikë.

Sot disa njerëz janë të përgatitur që zona të gjera ekonomike që janë më pak të ekspozueshme ndaj spekulimeve, t'i transferojnë në situatën e një pseudo-shteti, të tilla si industrinë e minierave dhe hekurudhave.

Por sigurisht që ata kanë për qëllim që ta ruanin prerogativën e prapaskenës për ta bërë këtë “shtet” një organ ekzekutiv të interesave personale të biznesit, duke përdorur format demokratike të parlamentarizmit, thënë ndryshe, duke paguar për fushata elektorale dhe gazeta, në mënyrë që të kontrollonin opinionet e votuesve dhe të lexuesve.

Pikërisht këtu fshihet rreziku i frikshëm i një skllavërimi të botës nga biznesi i madh. Vegla e tij sot quhet Liga e Kombeve, gjasme një sistem kombesh që gëzon një “vetëqeverisje” sipas modelit anglez, por që në realitet është një sistem provincash dhe protektoratesh, popullsitë e të cilave po shfrytëzohen nga oligarkia e biznesit, me ndihmën e parlamenteve të korruptuara dhe ligjeve të blera, njësoj siç bota romake u shfrytëzua nga ryshfeti i senatorëve, guvernatorëve dhe gjykatave popullore.

Marksii pati nuhatjen ta pikaste këtë sistem që po zinte fill, duke e shndërruar kështu në shenjestrën e kritikës së tij shoqërore. Ai dëshiroi që ta rrëzonte idenë angleze të pronës së gjithëfuqishme private, por edhe një herë pati aftësinë të formulonte vetëm një mohim: shpronësim të shpronësuesve, vjedhje e hajdutëve.

Por megjithatë, ky parim i vjetër anglez përmban diçka nga imperativi prusian:

Ruaje respektin e plotë gjermanik për pronën, por mirënjohjen ndaj pushtetit që ajo të jep shfaqe ndaj shtetit dhe tërësisë dhe jo ndaj individit. Ky është kuptimi i socializimit. Ai u ndoq sistematikisht nga qeveritë prusiane që funksionuan mbi instinktin e papenguar nga teoria, që prej kabineteve civile dhe luftarake të Frederik Vilhelmit të I-rë, deri në institucionet e mirëqenies shoqërore të Bismarkut.

Por marksistët ortodoksë dhe heterodoksë të Revolucionit Gjerman janë përpjekur ta mposhtin njëri-tjetrin duke e zhvatur dhe dëmtuar. Socializimi *nuk* do të thotë kombëtarizim përmes shpronësimit apo vjedhjes. Ai jo gjithmonë ka të bëjë me pronën formale, por përkundrazi, ka të bëjë me teknikat e administrimit. Të blesh industri poshtë e përpjetë, vetëm për hir të disa sloganeve dhe t'i lësh në dorë të disa trupave administrative që janë të paditura rreth mënyrës se si administrohen sipërmarrjet e mëdha, në vend që përgjegjësinë dhe iniciativën ta lësh në dorë të pronarëve të tyre, është rruga më e sigurtë për ta zbehur dhe dëmtuar socializmin e vërtetë.

Metoda e vjetër prusiane ishte ligjësimi i strukturës formale të potencialit prodhues total, duke e ruajtur me kujdes të drejtën për pronë dhe trashëgimi, ashtu si dhe duke i dhënë liri të plotë talentit personal, energjisë, iniciativës dhe intelektit, njësoj siç duhet lënë i lirë një mjeshtër shahu që i ka zotëruar plotësisht të gjitha rregullat e lojës.

Kjo është pak a shumë mënyra se si është vepruar me sindikatat dhe kartelet e vjetra, dhe ne nuk shohim

asnjë arsye se përse kjo mund të mos shtrihet sistematikisht edhe në zakonet e punës, vlerësimin e saj, shpërndarjen e fitimit dhe marrëdhënien e brendshme midis planifikuesve dhe personelit ekzekutiv.

Socializim do të thotë transformim i ngadaltë dhe i shtrirë në dekada të tëra i punëtorit në një nëpunës civil ekonomik, transformim i punëdhënësit në një zyrtar të përgjegjshëm administrativ që gëzon një autoritet me një pushtet të gjerë, ashtu siç do të thotë edhe transformim i pronës në një lloj çifligu të trashëgueshëm të llojit të vjetër, të cilit i janë bashkëngjitur një numër të drejtash dhe privilegjesh.

Në socializëm vullneti ekonomik mbetet po aq i lirë sa edhe lojtari i shahut; vetëm efekti përfundimtar është ai që i nënshtrohet një rrjedhe të përcaktuar.

Hohenzollernët krijuan llojin prusian të nëpunësit civil, që ishte i pari në botë në llojin e tij. Për arsye të aftësive të tij të trashëguara socialistike, ky lloj garanton mundësinë e një socializimi të ri. Për dyqind vjet, në metodat e tij ai ka simbolizuar atë çfarë socializmi simbolizon për ne sot si një detyrë që duhet bërë.

Nëse punëtori gjerman mund të heqë dorë nga marksizmi dhe fillon të mendojë si socialist, ai do ta ketë shumë të lehtë që të shndërrohet në llojin prusian të sapopërshkruar. “Shteti i së ardhmes” është shteti i përbërë nga nëpunësit civilë.

Ky është një ndër kushtet e pashmangshme përfundimtare drejt të cilit qytetërimi ynë po shkon në mënyrë të qëndrueshme. Edhe socializmi i një miliarderi,

mundet që në mënyrë të padukshme, një komb ta transformojë në një ushtri “zyrtarësh” privatë. Trustet e mëdha praktikisht tashmë janë shndërruar në shtete private, që ushtrojnë protektorat mbi shtetin zyrtar. Por megjithatë, socializmi prusian nënkupton përfshirjen e këtyre “shteteve” të interesit profesional në një shtet në cilësinë e një tërësie dhe totaliteti.

Pika e mosmarrëveshjes midis konservatorëve dhe proletarëve, në të vërtetë nuk është aspak domosdoshmëria e sistemit autoritar socialist, që mund të shmanget duke përqafuar sistemin amerikan (kjo është shpresa e liberalëve gjermanë), por çështja e komandës supreme.

Mund të duket sikur sot ekzistojnë dy alternativa socialiste, njëra nga lart dhe tjetra nga poshtë, dhe që të dyja nga një kastë diktatoriale. Edhe pse në realitet, të dyja mund të shkrihen në të njëjtën formë përfundimtare.

Tani që po flasim njerëzit janë të pavetëdijshëm rreth këtij fakti, aq sa të dyja partitë Kushtetutën e konsiderojnë si faktorin vendimtar. Por kjo nuk është një çështje ligjesh, është një çështje personalitetesh. Nëse udhëheqësit e punëtorëve tregojnë se nuk janë të aftë ta demonstrojnë shumë shpejt aftësinë superiore të ngjashme me atë të burrshtetasve që kërkohet prej tyre, vendin e tyre do ta zënë të tjerë.

Në një sistem politik që e mjegullon qëllimisht dallimin midis punëtorëve dhe administratorëve, duke i siguruar një karrierë të sigurtë çdo individ të kualifikuar, duke filluar që nga shkalla më e ulët e punëtorëve, për të kaluar te ajo më e larta e për të

përfunduar në kreun e grupit – një sistem të tillë një burrështetas i lindur mund ta shohë se qëllimet e konservatorëve dhe proletarëve dhe kombëtarizimi i plotë i jetës ekonomike nëpërmjet legjislacionit dhe jo shpronësimit, më në fund janë shkrirë në një qëllim të vetëm.

Lidershipi i një sistemi të tillë nuk mund të jetë “republikan.” Duke i lënë mënjanë të gjitha iluzionet, sot “republika” nënkupton korrupsion i pushtetit ekzekutiv përmes kapitalit privat.

Një princ do t’i nënshtrohet traditës së derës së tij dhe filozofisë së kushtrimit të saj. Nuk ka rëndësi se cili do të jetë mendimi ynë, ajo që ka rëndësi është se kjo e largon prej tij interesin e veçantë politik të partive, të tilla siç ne i njohim ato sot.

Ai vepron si arbitri i tyre. Dhe nëse, në një shtet të strukturuar nga pikëpamja socialiste, antarësia në këshillet profesionale, përfshirë dhe vetë Këshillin Shtetëror, përcaktohet në perspektivën e talenteve praktike, princi në këtë rast mund ta ngushtojë përzgjedhjen, nëpërmjet përdorimit të kriterit etik dhe moral.

Një president, një kryeministër apo një përfaqësues popullor, është pengu i një partie dhe kjo e fundit nga ana tjetër është pengu i atyre që paguajnë për të. Princi sot është mbrojtja e vetme e qeverisë kundër biznesit të madh.

Fuqia e kapitalit privat është duke imponuar një bashkim të parimeve socialiste dhe monarkiste. Ideali

individualistik i pronës private do të thotë nënshtrim i shtetit nga forca të reja ekonomike, thënë ndryshe, demokraci, apo akoma më ndryshe, korrupsion i qeverisë përmes pasurisë private. Në një demokraci moderne, udhëheqësit e masave nuk e shohin veten në kundërvënien me kapitalistët, por me paratë dhe pushtetin anonim që këto të fundit ushtrojnë. Pyetja është se sa prej këtyre udhëheqësve mund t'i rezistojnë një pushteti të tillë. Nëse dikush dëshiron ta dijë diferencën midis një demokracie abstrakte teorike dhe asaj që ka ekzistuar për njëfarë kohe dhe është e bindur për shkëlqimin që gëzon, le të lexojë çfarë Salusti⁵³ ka shkruar mbi Katilinën dhe Jugurthën. Nuk mund të ketë dyshim se kushtet romake thuajse i kemi prekur, por një rend monarkiko-socialist mund t'i neutralizojë ato.

Këta janë tre idealet e pronës që janë bllokuar sot në konflikt: ideali komunist i shpërndarjes së barabartë të të mirave botërore, ideali individualistik i përdorimit të tyre për të krijuar truste biznesi dhe ideali socialistik i administrimit të tyre në emër të totalitetit dhe së tërës.

⁵³ Gaius Sallustius Crispus ka qenë një historiak romak i shekullit të parë përpara Erës Sonë. Nga lexuesi shqiptar ai njihet nëpërmjet librit “Komploti i Katilinës,” që bën fjalë për një përpjekje të dështuar të një politikani romak për të rrëzuar Republikën Romake. Një tjetër vepër e tij është ajo mbi Luftrat Jugurthine, që u zhvilluan midis Republikës Romake dhe mbretit Jugurtha të Numidias, gjatë viteve 112-106 përpara Erës Sonë. (Shënim i përkthyesit)

Deri më tani jam përmbajtur së përmenduri Rusinë⁵⁴ dhe këtë e kam bërë qëllimisht, sepse nëse në diskutimin tonë sjellim Rusinë, atëherë nuk kemi të bëjmë më me një çështje popujsh të ndryshëm por *botësh* të ndryshme. Rusët janë pa asnjë dyshim një popull si gjermanët dhe anglezët. Si fiset gjermane të epokës karolinge ata bartin brenda tyre potencialet e shumë popujve të së ardhmes. “Rusianizmi” është një premtim i një kulture të së ardhmes, teksa muzgu i mbrëmjes shtrihet gjithnjë e më shumë mbi botën perëndimore. Dallimi midis shpirtit rus dhe atij perëndimor nuk mund të përshkruhet me ndonjë qartësi të madhe. Nëse nga njëra anë dallimet në shpirtin, fenë, politikën dhe ekonominë e Anglisë, Gjermanisë, Amerikës dhe Francës janë vërtet të thella, kur krahasohen me Rusinë, befasisht që të gjitha këto vende shfaqen si një botë e përbashkuar.

Është e lehtë të mashtrohemi nga disa banorë të Ruisë që reflektojnë një ndikim të fortë perëndimor. Rusi i vërtetë për ne nuk është thjesht përbrendësisht i huaj sa do të na dukeshin një romak i Epokës së Mbretërve apo një kinez i kohës përpara Konfucit. Rusët kanë qënë gjithmonë të vetëdijshëm rreth kësaj, çdo herë që kanë hequr një vijë ndarëse midis “Nënës Rusi” dhe “Evropës.”

Për ne, shpirti primitiv i Ruisë është diçka e pashpjegueshme që fshihet pas pisllekut, muzikës, vodkës, butësisë dhe një melankolie të çuditshme.

⁵⁴ Rënia e Perëndimit, II, veçanërisht në faqet 192, 278, 295 dhe 495.

Gjykimet tona ne natyrshëm i formojmë në mënyrë subjektive, thënë ndryshe, si antarë të vonë, urbanë dhe intelektualisht të pjekur të një kulture tërësisht të ndryshme.

Ajo çfarë ne “shohim” në Rusi nuk është pra thjesht një shpirt që tani po zgjohet, të cilin edhe Dostojevski u ndje i pafuqishëm për ta përshkruar, por vetë tabloja jonë mendore e saj, që është formuar nga imazhi ynë sipërfaqësor i jetës dhe historisë ruse, por sikur mos të mjaftonte kjo, është falsifikuar akoma dhe më shumë nga përdorimi i të tilla fjalëve “evropiane” si vullnet, arsye dhe *Gemut*.⁵⁵

E megjithatë, disa prej nesh janë të aftë të marrin një përshtypje praktikisht të papërshekrueshme të atij vendi, që nuk lë kurrfarë dyshimi rreth hendekut të madh që na ndan.

Ky popull fëminor, i paqartë dhe i frikshëm është ngatërruar, plagosur, torturuar dhe helmuar, duke pranuar t’i imponohet një kulturë e huaj, autoritare, mashkullore dhe e pjekur “evropiane.” Mishi i tij është shpuar nga ambiciet e qendrave urbane të stilit evropian, me vetëdijën e tij të pazhvilluar, e infektuar nga qëndrimet filozofitë, idetë politike dhe parimet e tejpjekura shkencore.

Në vitin 1700, Pjetri i Madh imponoi mbi popullin e tij stilin barok të politikës, i plotësuar me një kabinet diplomatik, ndikim dinastik, administrim dhe flotë, që të gjitha këto të një stili perëndimor. Njëqind vjet më vonë,

⁵⁵

Ndjenjë, zemër, shpirt. (Shënim i përkthyesit)

më 1800-tën, idetë angleze, në thelb të pakuptueshme nga këta popuj, u bënë të njohura përmes autorëve francezë, të cilët ia dolën t'i ngatërronin mendjet e një pakice të vogël intelektuale. Sikur të mos mjaftonte kjo, inteligjenca e lexuar ruse popullit të saj Marksian ia prezantoi që përpara viteve 1900, një produkt i ndërlikuar ky i dialektikës evropiane perëndimore, rreth origjinës së të cilës ata ishin tërësisht të paditur. Pjetri i Madh shtetin carist e transformoi në një fuqi të madh brenda sistemit perëndimor, duke e dëmtuar kështu zhvillimin e tij të natyrshëm.

Dhe “inteligjenca,” që edhe vetë ishte produkt i shpirtit rus pasi ai tashmë ishte korrumpuar nga qytetet e stilit perëndimor, hyri në skenë me dëshirën e zyrtarëve për institucione vendase që do të lindnin në të ardhmen e largët, duke e shtrembëruar kështu mendimin primitiv të vendit të tyre në një teorizim shterpë dhe fëminor, sipas metodës së revolucionarëve profesionistë francezë.

Duke u bazuar te modestia dhe vullneti i lartë për të sakrifikuar i rusëve, Pjetrinizmi dhe bolshevizmi kanë arritur disa gjëra të prekshme, në imitimin e pakuptimtë dhe shkatërrimtar të krijimeve të tilla perëndimore siç ishin Oborri i Versajës dhe Komuna e Parisit. Por këto institucione kanë ndikuar vetëm në sipërfaqe të ekzistencës ruse; secili prej tyre mund të zhduket dhe të rishfaqet me një shpejtësi të paparashikueshme.

E megjithatë, Rusia ka pasur vetëm përvoja fetare dhe jo shoqërore apo politike. Dostojevski, në realitet një shenjtor që është bërë të shfaqet në maskën e pakuptimtë dhe qesharake perëndimore të *romancierit*, keqkuptohet

nëse “problemet” e tij shoqërore shqyrtohen veç formës së tij romanore. Thelbi i tij i vërtetë shumë shpejt do të gjendet midis rreshtave dhe të *Vëllezërit Karamazov* ai arrin një intensitet fetar që është i krahasueshëm vetëm me atë të Dantes.

Politika e tij revolucionare, nga ana tjetër, e kishte zanafillën brenda një rrethi metropolitan papërfillshmërisht të vogël, i cili nuk zotëronte më ndjeshmëritë e përkufizuara ruse dhe që, sa i përket origjinës familjare, vështirë se mund të quhen ruse. Për pasojë, mendimi politik i Dostojevskit vërtitej midis ekstremeve të dogmatizmit të imponuar dhe refuzimit instinktiv.

Nga këtu buron urrejtja e thellë, e frikshme dhe atavike ndaj Perëndimit, ndaj helmit të vetë trupit të saj. Ajo mund të ndihet në vuajtjet e brendshme të Dostojevskit, në shpërthimet e dhunshme të Tolstojit dhe në mendimet e heshtura të njeriut të zakonshëm.

Është një urrejtje e papërmbajtshme, shpesh e pavetëdijshme e nganjëherë e fshehur nën një prirje të sinqertë kah dashurisë dhe të kuptuarit, një urrejtje themelore ndaj të gjitha simboleve të vullnetit faustian: ndaj qyteteve (Peterburgut në veçanti) që janë pararojë e imponimit të këtij vullneti ndaj fushave rurale dhe stepave të pafundme; ndaj arteve dhe shkencave, mendimit dhe emocionit perëndimor, shtetit, jurisprudencës, strukturës administrative, parave, industrisë, arsimit dhe “shoqërisë” – në fakt, ndaj gjithçkaje.

Është urrejtja e hershme apokaliptike që dallon kulturën e antikitetit. I gjithë bolshevizmi përmban diçka nga hidhërimi i zymtë i mekabeanëve,⁵⁶ ashtu si dhe shumëçka nga kryengritja e vonë që shpuri drejt shkatërrimit të Jeruzalemit. Dogmatizmi i tij i ngurtë nuk do t'ia kishte dalë kurrë që i vetëm të nxiste përkrahjen që mbështet lëvizjen në fjalë edhe sot e kësaj dite. Instinktet e pavetëdijshme e të thella anti-perëndimore të Ruisë, së pari të drejtuara kundër Pjetrinizmit, i kanë dhënë forcë bolshevizmit. Por duke qenë se bolshevizmi në vetvete është një produkt i Pjetrinizmit, me kalimin e kohës ai do të shkatërrohet, me qëllim që të plotësohet çlirimi i Ruisë nga “Evropa.”

Proletari i Perëndimit dëshiron që ta riformësojë qytetërimin perëndimor që të përmbushë dëshirat e tij të veçanta; ndërsa inteligjenca ruse, në mënyrë instinktive, në mos gjithmonë të vetëdijshme, dëshiron ta shkatërrojë atë. Ky është kuptimi i nihilizmit lindor. Qytetërimi ynë perëndimor ka kohë që është bërë pastërtisht urban; në Rusi koncepti i “masave” nuk ekziston dhe ai që njihet është vetëm “populli.”

Çdo rus i vërtetë, qoftë profesioni i tij ai i studiuesit apo nëpunësit civil, në thelb është një fshatar. Ai nuk është aspak i interesuar në qytetet e dorës së dytë, të mbushura nga masat dhe ideologjitë e dorës së dytë. Përveç Marksizmit, problemet e vetme ekonomike që ai vend ka janë ato rurale. “Punëtori” rus është një

⁵⁶ Pasardhës të një prijësi fetar dhe politik, i cili në vitin 168 përpara Erës Sonë organizoi një revoltë kundër Helenizmit dhe sundimit sirian, e që më vonë sunduan mbi Palestinën gjatë viteve 142-63. (Shënim i përkthyesit)

keqkuptim. I vetmi realitet është toka e paprekur dhe e padëmtuar, njësoj si në Evropën Karoline. Nëpër këtë fazë ne kaluam njëmijë vjet më parë, prandaj dhe nuk e kuptojmë njëri-tjetrin.

Ne evropianët perëndimorë nuk jemi më të aftë të jetojmë në harmoni me tokën e virgjër. Kurdoherë që shkojmë “në fshat” ne marrim me vete qytetin me të gjithë aspektet e tij shpirtërore; dhe atë e kemi futur në gjakun tonë, jo thjesht në kokë si pjesëtarët e *inteligjencës* ruse. Rusi bën të kundërtën, fshatin e tij ai e transporton mendërisht drejt qyteteve ruse.

Nëse dëshirojmë ta kuptojmë këtë çarje të pariparueshme midis “socializmit” lindor dhe perëndimor, duhet që ta bëjmë gjithmonë dallimin midis shpirtit dhe sistemit politik rus, ashtu si dhe midis mendësisë së udhëheqësve dhe instinktit të atyre që ata udhëheqin. Sepse çfarë tjetër është pansllavizmi përveçse një maskë politike e llojit perëndimor që mbulon një kuptim të fortë të misionit fetar?

Pavarësisht të gjithave sloganeve industriale si “teprica” dhe “shpronësimi,” punëtori rus nuk është një punëtor urban dhe jo një njeri i masave si punëtorët e Mançesterit, Esenit apo Pitsburgut. Në të vërtetë ai është një lëruës dhe korrës toke që ka braktisur shtëpinë, i mbushur me një urrejtje për fuqitë e huaja që kanë dëmtuar prirjet që shpirti vazhdon ta thërrasë për të ndjekur.

Edhe nëse programi që ka në kokë do të ndryshonte, misioni i tij i pavetëdijshëm për zgjimin e Rusisë do të mbetej i njëjti: nihilizmi.

Megjithatë, bolshevizmi fsheh një joshje të jashtëzakonshme për intelektualët nxitës të qyteteve *tona*. Ai është shndërruar në një hobi për mendjet e lodhura dhe të turbullta, një armë për shpirtrat e kalbur megapolitanë dhe një shprehje e gjakut të kalbur.

Spartakizmi i salloneve hyn në të njëjtën kategori me teozofinë dhe okultizmin; për ne ai është e njëjta gjë siç kulti i Isisit ishte jo për skllëverit lindorë të Romës, por për vetë romakët dekadentë. Fakti që ai hyri në Berlin ka të bëjë me turpin e madh të këtij Revolucionit.

Është relativisht e parëndësishme që budallenjtë mendjebrazur nisën të themelonin “këshillet fshatare” në Berlin, duke imituar ato të modelit sovjetik, apo se askush nuk e vuri re se çështjet rurale janë problemi kryesor në Rusi, në një kohë që kokëdhembjet i kemi ngushtësisht urbane. Përballë socializmit, në Gjermani Spartakizmi nuk ka të ardhme.

Por bolshevizmi është e sigurtë që ka për ta pushtuar Parisin, sepse kur shkrihet me sindikalizmin anarkik, ai mund ta kënaqë shpirtin francez të lodhur dhe të uritur për ndjenja. Ai ka për të qenë forma e duhur e shprehjes së *taedium vitae*⁵⁷ e atij qyteti të stërmadh që është kaq i kënaqur me jetën që bën. Si një helm i rrezikshëm për intelektet e rafinuara perëndimore, atje ai ka një të ardhme më të madhe sesa në Lindje.

⁵⁷ Një gjendje e thellë mjerimi, dëshpërimi dhe melankolie, kryesisht kur buron nga mospasja e asnjë veprimtarie për të kryer. (Shënim i përkthyesit)

Në Rusi ai do të zëvendësohet nga ndonjë formë e re e carizmit, që është sistemi i vetëm i mundshëm për një popull që jeton nën ato kushte. Me shumë gjasa ky carizëm do t'i ngjajë më shumë sistemit socialist prusian sesa atij të parlamentarizmit kapitalist.

E megjithatë e ardhmja e forcave të pavetëdijshme të Ruisë nuk fshihet në zgjedhjen e problemeve të vështira politike dhe shoqërore, por në lindjen e pashmangshme dhe të afërt të një feje të re, që do të jetë e treta që do të shfaqet nga matrica e Krishtërit, njësoj siç kultura perëndimore-gjermanike në mënyrë të pavetëdijshme mori formën e saj të dytë të Krishtërit rreth vitit 100 të Erës Sonë.

Dostojevski është një ndër profetët e kësaj feje të re; ajo ende nuk ka ndonjë emër të posaçëm, por tashmë ka filluar të imponohet me një fuqi të njëtrajtshme dhe pafundësisht të butë.

Për ne qytetarët e botës perëndimore, feja ka marrë fund. Në shpirtat tanë urbanë, ajo çfarë një herë e një kohë ishte religjiozitet, ka kohë që është intelektualizuar në termin “problematikë.” Plotësimin e saj Kisha e arriti në Këshillin e Trentos.

Puritanizmi është kthyer në kapitalizëm, kurse Pietizmi sot është socializëm. Sektet anglo-amerikane përfaqësojnë thjesht nevojën nervore të biznesmenit për zbavitje teologjike. Nuk ka një spektakël më neveritës sesa ai i tentuar nga disa grupe të caktuara protestante për të rigjallëruar kufomën e fesë, duke e lyer atë me mbeturina bolshevike.

E njëjta gjë është tentuar edhe me okultizmin dhe teozofinë. Dhe asgjë nuk është më mashtruese sesa shpresa se feja e ardhme e rusëve mund të stimulojë rigjallërimin e fesë në Perëndim.

Në këtë pikë nuk duhet të kemi më kurrfarë keqkuptimi: me urrejtjen e tij ndaj shtetit, shkencës dhe artit, nihilizmi rus është drejtuar edhe ndaj Romës dhe Vitenbergut, shpirti i të cilëve është i pranishëm në të gjitha format e kulturës perëndimore dhe kësaj është pjesë integrale e asaj që ky nihilizëm ka për qëllim të shkatërrojë. Rusia ka për ta lënë mënjanë këtë zhvillim dhe të lidhet edhe një herë, përmes Bizantit, drejtëpërsëdrejti me Jeruzalemin.

Bolshevizmi është një karikaturë e përgjakshme e problemeve perëndimore që e kishin origjinën në ndjeshmëritë fetare perëndimore.

Tani duhet të jetë e qartë se sa e pakuptimtë dhe sipërfaqësore është që për këtë lëvizje ruse, problemi i madh universal është ai me të cilin ajo po njihet tani që po përballet me Perëndimin: zgjidhja midis ideve prusiane dhe angleze, midis socializmit dhe kapitalizmit, midis shtetit dhe parlamentit.

Më lejoni që ta përmbledh këtë.

Është dëshira ime që ky shpjegim i shkurtër që kam bërë në këtë trajtesë, atyre nga populli ynë që për arsye të iniciativës, vetëdisiplinës dhe superioritetit janë të destinuar të udhëheqin brezin e ardhshëm, do t'u japë një tablo të qartë të kohëve që po jetojmë dhe drejtimit kah të cilit jemi të destinuar të shkojmë. Ne tashmë e dimë se

çfarë është në rrezik: nuk është vetëm fati i Gjermanisë, por i të gjithë qytetërimit. Pyetja kritike që parashtrohet jo vetëm për Gjermaninë por për të gjithë botën – por që në emër të të gjithë botës asaj duhet t’i përgjigjemi në Gjermani – është kjo: Në të ardhmen do të jetë biznesi ai që do të sundojë mbi shtetin apo do të jetë shteti ai që do të sundojë mbi biznesin?

Për sa i përket këtij momenti kaq vendimtar, Prusianizmi dhe socializmi janë e njëjta gjë. Deri më tani nuk e kemi kuptuar këtë, madje edhe sot e kësaj dite nuk e kemi fort të qartë. Mësimet e Marksit, së bashku me egoizmin klasor, janë fajtores që si fuqia punëtore socialiste ashtu dhe elementet konservatore e keqkuptojnë njëra-tjetrën, e duke keqkuptuar njëra-tjetrën, keqkuptojnë edhe socializmin.

Por sot nuk ka kurrfarë dyshimi që ata kanë të njëjtat qëllime identike. Prusianizmi dhe socializmi qëndrojnë në kundërvënie me “Anglinë tonë të brendshme,” ashtu si dhe me një tërësi qëndrimesh që e ka gjymtuar dhe shpirtërisht e ka dobësuar të gjithë popullin tonë. Rreziku është shumë i madh. Mjerë ata të cilët i fshihen kësaj sfide për shkak të egoizmit apo paditurisë! Kësisoj kanë për të shkatërruar veten dhe të tjerët. Solidariteti ka për të pasur kuptimin e idesë së Hohenzollernëve dhe në të njëjtën kohë shëlbimin e punës. Shpëtimi ose do të jetë për të dy palët, konservatorë e punëtorë bashkë, ose për asnjërin.

Punëtorët duhet t’i largojnë nga koka iluzionet marksiste. Marksi ka vdekur. Si një formë ekzistence, socializmi sapo ka filluar; si një lëvizje e veçantë brenda

proletariatit gjerman ai ka marrë fund. Për punëtorin ekziston ose socializmi prusian, ose asgjë. Ndërsa konservatori duhet të largojë nga vetja egoizmin që dikur, gjatë mbretërimit të Zgjedhësit të Madh,⁵⁸ i kushtoi me jetë kapitenit von Kalckstein.⁵⁹ Pavarësisht asaj se çfarë ne mund të mendojmë rreth demokracisë, ajo është forma politike që do të mbijetojë e këtij shekulli. Për shtetin do të ketë ose demokratizim ose asgjë tjetër. Kësisoj, për konservatorët mund të ketë ose një socializim të vetëdijshëm ose asgjëzim. Por ama duhet të çlirohemi nga format angleze dhe franceze të demokracisë. Na mjafton jona.

Kuptimi i socializmit është se jeta dominohet jo nga kontrasti i të pasurve me të varfrit, por nga rangu që përcaktohet nga arritjet dhe aftësitë. Ky është lloji *ynë* i lirisë: liri nga kapriçot ekonomike të individit.

Shpresa ime e zjarrtë është se ai që ka lindur për të komanduar nuk do të qëndrojë i fshehur dhe se askujt që i mungon aftësia dhe talenti i lindur për të komanduar nuk do të marrë përsipër këtë mision. Socializëm do të thotë aftësi dhe jo dëshirë. Nuk është barazia e qëllimeve ajo që është vendimtare, por barazia e arritjeve. Marr guximin t'i drejtohem rinisë sonë. I bëj thirrje kujtdo që ka palcë në kocka dhe gjak në deje. Stërvituni! Bëhuni burra! Nuk kemi më nevojë për ideologë dhe as për dërdëllitjet rreth *romanit të fomimit* dhe

⁵⁸ Është një ndër etiketimet e Frederik Vilhelmit të Madh të Prusisë, që sundoi nga viti 1640 në vitin 1688, të cilin tashmë e kemi përmendur më sipër. (Shënim i përkthyesit)

⁵⁹ Kristian Ludvig von Kalkstein, 1630-1672, ka qenë një politikan prusian që u ekzekutua për tradhti. (Shënim i përkthyesit)

kozmpolitanizmit, e aq më pak rreth misionit intelektual të Gjermanisë. Kemi nevojë për fortësi, për një skepticizëm plot kurajo, për një klasë mjeshtërore njerëzitet që kanë përqaftuar botëkuptimin socialist. Edhe një herë po e përsëris: Socializmi do të thotë pushtet, pushtet dhe më shumë pushtet. Pa pushtetin, mendimet dhe skemat janë një hiç. Rruga drejt pushtetit tashmë është hartuar: elementet e vlefshme të fuqisë punëtore gjermane janë bashkuar me përfaqësuesit më të mirë të idesë së shtetit të vjetër prusian, grupe këta që janë të vendosur të ndërtojnë një shtet të mirëfilltë socialist, për ta demokratizuar kombin tonë në mënyrën prusiane; që të dy këta grupe janë farkëtuar në një njësi që bashkëndan të njëjtin sens detyre, të karakterizuar nga vetëdija e një obligimi të madh, ashtu si dhe nga vullneti për t'u bindur me qëllim për të sunduar, për të vdekur me qëllim për të jetuar, dhe të frymëzuar nga fuqia për të bërë sakrifica të jashtëzakonshme me qëllim përmbushjen e atij qëllimi për të cilin kemi lindur, për të kuptuar çfarë jemi dhe çfarë mund të mos ishte pa ne.

Ne jemi socialistë. Le të shpresojmë s'do mbetemi pa u shpërblyer.